

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**TITULLI ORIGINAL**  
**GENÇLER SORUYOR**

**PËRKTHEU**  
Ilir Hoxha

**REDAKTOI**  
Albert Halili

**FAQOSI**  
Bledar Xama

**BOTIMI I**  
Shkodër, 2023

**PROGRESI BOTIME**  
Sheshi "2 Prilli", Rr: Studenti  
Shkodër, Shqipëri  
Mob: +355 67 340 6182

# Të Rinjtë Pyesin

Osman Nuri Topbash



## PËRMBAJTJA

- 1) Si duhet t'i qaset një i ri musliman mjedisit që e rrethon, ngjarjeve dhe fenomeneve me të cilat përballlet? ..... 9
- 2) Përballë perëndimit një pjesë e shoqërisë tonë është e kompleksuar. Ata mendojnë se të gjitha zbulimet shkencore janë të perëndimit. Si mund t'u përgjigjemi atyre? Dhe si ka arritur perëndimi deri këtu? ..... 14
- 3) Në ditët e sotme, ateistët dhe deistët, me sloganin "Feja apo shkenca?", po përpiqen të mbjellin një farë të re të së keqes në mendjet dhe zemrat e brezave të rinj. Çfarë përgjigje mund të kemi për ta? ..... 18
- 4) Në ditët tona, ka nga ata që thonë se relaksohen dhe gjejnë paqe duke bërë disa praktika si joga dhe meditimi që vijnë nga fetë dhe filozofitë jashtë Islamit. A mundet një mysliman të praktikojë joga apo meditim? A mund ta çlodhin vërtet shpirtin praktika të tilla? Çfarë na rekomandoni në lidhje me këtë çështje? ..... 23
- 5) Si mund ta bëjmë namazin më shumë pjesë të jetës sonë? Çfarë mund të thoni në lidhje me rëndësinë e namazit? ..... 30
- 6) Komunizmi, kapitalizmi dhe liberalizmi janë sisteme njerëzore ndikuese në botë. Çfarë sistemi ofron feja Islame përballë

tyre? Cila është pikëpamja botërore e Islamit në menaxhimin e individit dhe shoqërive? .....	36
7) Sot në botë, termi “islamofobi” po përhapet qëllimisht. Përse thuhet pikërisht “islamofobi” ndërkohë, që për fetë e tjera nuk përdoret termi “fobi-frikë”? .....	45
8) Si duhet të sillen njeriu me krijesat e tjera? Si ishte sjellje e Pejgamberit ﷺ me gjallesat?.....	53
9) Perceptimi i historicit të Kuranit dhe Islamit, në krye të të cilit vjen Fazllurrahmani në shkallë botërore, në ditët e fundit ka filluar të shtjellohet edhe nga disa teologë në Turqi. Madje në këtë kontekst është thënë se Kurani i ka zbritur Pejgamberit si kuptim. Ndërsa ai e ka shndërruar në koncepte dhe fjalë të asaj kohe. Nisur nga ky aspekt, si duhet ta kuptojmë dhe shpjegojmë të qenët e Kuranit mbi historinë dhe mesazhin universal të tij? .....	56
10) Në ditët e sotme, të mjaftuarit vetëm me Kuran për të kuptuar dhe jetuar Islamin duke përdorur shprehje të tilla si: “Ne na mjafton Kurani”, po bëhen ndikuese në disa qarqe. Ç’mendoni në lidhje me rëndësinë e Hadithit dhe Sunetit?.....	64
11) Si duhet të jetë marrëdhënia jonë me librin e Allahut, Kuranin Famëlartë?.....	71
12) Cilat janë synimet e historive që përmenden në Kuran?.....	76
13) Çfarë rinie jetoi Resulullahu ﷺ? .....	80
14) A është e mundur që një njeri të jetë model për të gjitha shtresat shoqërore? Si është realizuar personaliteti shembullor i Pejgamberit ﷺ?.....	84
15) Cila është rëndësia që ka bërja e slavateve për Profetin tonë ﷺ? Sa i kujdesshëm duhet të jetë një mysliman në këtë çështje? .....	90

- 16) Çfarë mund të na thoni në lidhje me modestinë e Pejgamberit ﷺ? ..... 95
- 17) Cili është qëllimi i krijimit të njeriut? ..... 100
- 18) Cili është qëllimi i Tasavvufit? ..... 105
- 19) Në cilat periudha të Historisë islame është ndjerë nevoja e Tasavvufit?  
A kemi sot nevojë për Tasavvufin? A mund të rrugëtohet pa të? ..... 109
- 20) Cila është urtësia e ekzistencës së nefsit? Si mund të  
kapërcehet pengesa e nefsit? ..... 115
- 21) Përse është i rëndësishëm pastrimi i zemrës? Dhe si arrihet ajo? ..... 120
- 22) Cili është qëllimi i namazit të natës? ..... 131
- 23) Cila është natyra e dashurisë së vërtetë? Si duhet të  
orientohet dashuria jonë? ..... 135
- 24) Çfarë është lidhja shpirtërore? ..... 143
- 25) Përse është i rëndësishëm qëndrimi me njerëz të mirë? ..... 148
- 26) Si mund ta mbrojmë veten një mysliman nëpër vende të huaja?  
Ndaj cilave gjëra duhet të bëjmë kujdes në marrëdhëniet me  
jomuslimanët? ..... 151
- 27) Çfarë solli dhe çfarë mori me vete jeta moderne dhe zhvillimi  
teknologjik i këtij shekulli? Pjesa më e madhe e rinisë sonë  
janë përdorues aktivë të rrjeteve sociale. Për çfarë duhet  
të bëjmë kujdes kur përdorim teknologjinë dhe veçanërisht  
internetin, në mënyrë që të mos përhumbemi në rrugët e  
pakuptimit të internetit dhe të mos devijojmë drejtimin tonë? ..... 156
- 28) Një i ri i ndërgjegjshëm, i rritur me edukim dhe frymë fetare, i  
cili pas shkollimit hidhet në jetë dhe në raporte pune, familjare,  
shoqërore, herë pas here mund të bëjë lëshime sa i takon disa  
parimeve islame. Pikërisht në këto rrethana, si mund të mbahet  
qëndrueshmëria në fe, si mund të kujdesemi për ruajtjen e  
ndjeshmërisë dhe parimeve islame? Si i këshilloni të rinjtë? ..... 164

- 29) Cilat janë direktivat e fesë islame në një periudhë ku nën emrin e lirësë kanë humbur nderi dhe edukata?..... 171
- 30) Çfarë duhet të na kujtojë "ndjenjat e nderit" në një shoqëri ku po abuzohet çdo ditë që kalon me konceptet si "edukata, turpi dhe namusi". Në cilat situata mund të takohen gruaja dhe burri pa qenë të martuar? Çfarë na sugjeroni në lidhje me këtë çështje? ..... 177
- 31) Burri dhe gruaja, ndërtojnë një çerdhe dhe duke bashkuar jetët e tyre, vendosin të ndajnë së bashku çdo gjë që mund t'u vijë në jetë. Por, cilat janë çështjet që të dyja palët duhet të kenë kujdes njëkohësisht gjatë jetës martesore?..... 180
- 32) Cilat janë vetitë më të rëndësishme që i japin kuptim dhe vlerë jetës?..... 185
- 33) Si duhet ta kuptojmë ekuilibrin midis frikës dhe shpresës? ..... 193
- 34) Në çfarë prespektive duhet t'i qaset besimtari situatave dhe ngjarjeve me të cilat përballlet gjatë jetës? ..... 197
- 35) Mënyra për të ndërtuar një individ dhe shoqëri të mirëfilltë është një edukim i mirëfilltë brenda ekuilibrit materialo-shpirtëror. Mirë, por si mund të edukohet një edukues i mirëfilltë që ta japë këtë edukim? Cilat atribute duhet të gjenden te një edukues ideal?.....205



## **1) Si duhet t'i qaset një i ri musliman mjedisit që e rrethon, ngjarjeve dhe fenomeneve me të cilat përballet?**

Allahu i Plotfuqishëm dhuroi gjithçka që krijoi në tokë dhe në qiell, në gjithësi dhe në brendësi, në njeriun dhe në gjithësi, në kuptimin e njerëzimit si një shenjë e ekzistencës, unitetit dhe fuqisë së esencës së Tij, si një material për përsiatje.

Çdo gjë që ka krijuar Allahu, në tokë apo në qiell, në jashtë apo brenda njeriut është tregues i ekzistencës dhe plotfuqisë së Tij dhe njëkohësisht si shenja për të medituar mbi to.

Urdhri i parë i Kuranit është:

**Lexo me emrin e Zotit të i cili të krijoj!** (Alak,1)

Njeriu duhet ta lexojë Kuranin me syrin e zemrës. Krijimin e vet dhe të universit duhet ta lexojë me meditim dhe reflektim. Ai duhet të lexojë krijimin me syrin e urtësisë. Duhet të meditojë për përkohshmërinë e kësaj bote. Libri i cili do t'i jepet në ditën e gjyqimit për ta lexuar duhet ta lexojë qysh në këtë botë.

Është e pamundur të meditosh mbi universin dhe të mos mbetesh i mahnitur nga krijimi i përsosur. Për shembull:

Ujë përbëhet nga dy molekula hidrogjen dhe një molekulë oksigjen. Të dyja substanca djegëse. Por nga bashkimi janë burim jetë për gjithë krijesat e gjalla.

Uji që mbetet mbi tokë, u shërben njerëzve, përdoret në ushqimin, pijen, pastrimin dhe plotësimin e nevojave të ndryshme të tyre dhe nganjëherë ndotet për këtë arsye. Por ai ujë i ndotur ngrihet përsëri drejt qiellit duke avulluar për shkak të nxehtësisë së diellit, pastaj gjen një re, i bashkohet asaj dhe përsëri zbrit në sipërfaqen e tokës si mëshirë.

Sa herë ka avulluar dhe është ngritur në qiell që nga dita që ka ardhur në ekzistencë një gotë ujë që e pimë? Pastaj sa herë ka zbritur si mëshirë në sipërfaqen e tokës? Për cilat farëra është bërë ushqim? Në cilat vende ka shëtitur dhe ka qëndruar brenda tyre? Këtej e tutje kush e di se çfarë mund të ndodhë?!. Nëse do të tentohet për t'u shkruar kjo aventurë, që në fakt është e pamundur ta njohim plotësisht, do të shkruheshin libra me shumë vëllime, por prapë se prapë nuk do të kishte fund.

Uji është vetëm një nga mirësitë që shfrytëzojmë. Ujë që pimë, ajri që thithim dhe ushqimi që hamë dhe shumë mirësi të tjera për të cilat jemi të pavetëdijshëm, duhet të na ndërgegjësojnë sa të pafuqishëm jemi për ta falënderuar Allahun.

Një njeri që arrin të reflektojë si duhet mbi urtësitë e pafundme në univers i cili është një art i përsosur hyjnor, e kupton menjëherë që çdo gjallesë ka nevojë për një ndihmë të madhe për të përballuar jetën. Ai e kupton menjëherë dobësinë dhe pranon se është një vepër e përsosur hyjnorë në këtë botë...

Njeriu duhet të pyes veten:

Nga kemi ardhur dhe për ku jemi nisur? Cili është qëllimi i ardhjes dhe largimit tonë nga kjo botë? Në pronën e kujt jetojmë? Kush na i

ka dhënë gjithë këto mirësi që i shfrytëzojmë? Gjithë këto mirësi nga vijnë dhe për çfarë qëllimi janë? A mund të jenë të rastësishme të gjithë këto?..

Duke i bërë vetes pyetje të tilla njeriu e kupton se sa nevojë ka për Allahun!..

Kur hedhim shikimin në univers vërejmë se çdo gjë është në lëvizje dhe aktivitet të vazhdueshëm. Dielli, Hëna, qielli, toka, dhe të gjitha gjallesat kryejnë me rigorozitetin më të madh funksionin për të cilin janë krijuar. E njëjta gjë ndodh edhe në mikrobotën; brenda një atomi lëvizin me një shpejtë si të madhe grimca më të vogla si protonet, elektronet dhe kuarket. Pra vazhdimisht janë në një lëvizje.

Të qëndrosh indiferent, joaktiv dhe larg veprave të mirë përballë një dizajni të tillë të përkryer është një shkarje shumë e rëndë.

Në univers gjithçka është në gjendje aktiviteti duke filluar nga makro universi deri tek mikro universi:

Miliarda galaktika janë vazhdimisht në lëvizje. Dielli, Hëna dhe yjet nuk pushojnë së lëvizuri për asnjë moment.

Zemra nuk kërkon pushim vjetor për punën që bën.

Në bërthamën e atomit lëvizin me një shpejtë si marramendëse elektronet, protonet dhe neutronet. Një elektron i atomit të hidrogjenit sillet rreth bërthamës me një shpejtësi 2000 km për sekondë...

Të gjitha këto janë një mesazh për jetën tonë shpirtërore dhe për të treguar vendosmëri dhe qëndrueshmëri në rrugën drejt Zotit.

Në univers nuk ekziston asgjë pa urtësi. Universi është një libër meditimi, urtësitë hyjnore të cilit mund të lexohen përmes syrit të zemrës. Leximi i tij është i lidhur ngushtë nga gjendja shpirtërore.

Një person që arrin pjekurinë shpirtërore kur vjen pranvera, stina në të cilën çelin lulet, toka fillon të gjallërohet dhe lumenjtë rrjedhin vrullshëm, kur e shikon këtë panoramë fillon të meditojë dhe nxjerrë mësim për saj. Ai përballë kësaj gjallëri fillon të mendojë se edhe ai duhet të jetë më i gjallë dhe të tregojë më shumë përpjekje në realizimin e adhurimeve.

Po ashtu edhe stinën e vjeshtës ai e lexon me syrin e zemrës dhe duke nxjerrë mësim dhe mesazhe prej saj. Rënia e gjetheve në stinën e vjeshtës i kujton atij kohën e kufizuar në këtë botë. Perëndimi i diellit i kujton vdekjen. Të gjitha këto e nxitin atë të veprojë në bamirësi dhe vepra të mira pa humbur kohë...

Dituria, madhështia dhe urtësia që shfaqet në krijim i kujton njeriut dobësinë e vet para madhësisë hyjnore.

Një dele ushqehet me barë dhe ujë për të prodhuar qumësht. Kurse njeriu me gjithë zhvillimin e madh teknologjik nuk ka arritur që përmes një fabrike që përdor si lëndë të parë barin dhe ujin të prodhojë qumësht.

Qëkur është krijuar bota e deri më sot, janë shtruar sofra të pa-numërta hyjnore dhe vazhdojnë të shtrohen çdo moment, duke mos u neglizhuar furnizimi i asnjë krijese. Nëse mendojmë për një çast; tre të katërtat e tokës janë të mbuluara me ujë. Ndërsa një e katërta e tokës përbëhet nga shkëmbinj ose shkretëtira, ku bimët nuk mund të zhvillohen. Një pjesë e vogël që mbetet është tokë e përdorshme. Mirëpo, fuqia madhështore e Allahut, ka bërë që toka me anë të një lloji metamorfoze (ndryshimi i stinëve), të jetë burim ushqimi për të gjitha gjallesat.

Një numër i madh organizmash në trupin tonë që punojnë si fabrika ku kryhet një numër i pafund procesesh bio-kimike. Të gjitha këto në një rend të caktuar dhe të mrekullueshëm, pa e ditur ne. Nëse do

të na ishte lënë në dorë për një ditë programi hyjnor i trupit të njeriut, që punon me një rregull të mahnitshëm, i ndonjë organi ose edhe i një qelize të vetme, ku zhvillohen me qindra reaksione kimike, nuk do të kishim duruar qoftë edhe disa minuta. Kushedi se sa dëme mund të shkaktonim!?

Edhe kjo tregon pafuqinë dhe nevojën e njeriut, prandaj mjafton të thuhet se bindja, nënshtrimi dhe mirënjohja ndaj Allahut janë thelbësore.

**O Zot! Na bëj të mundur t'i shikojmë me syrin e zemrës mesazhet Tuaja në Kuran dhe univers. O Zot! Na e bëj të mundur të mbërrijmë tek Ti me besim dhe vepra të mira!**

**Amin!..**

**2) Përballë perëndimit një pjesë e shoqërisë tonë është e kompleksuar. Ata mendojnë se të gjitha zbulimet shkencore janë të perëndimit. Si mund t'u përgjigjemi atyre? Dhe si ka arritur perëndimi deri këtu?**

Përparimin që ka arritur në ditët e sotme, perëndimi ia ka borxh pasurisë shkencore që kanë nxjerrë në pah myslimanët. Perëndimorët janë njohur me zhvillimet shkencore përgjatë kryqëzatave ose në universitetet e Andaluzisë dhe vetëm pas kësaj kanë arritur ta zhvillojnë veten.

Po ju jap disa shembuj:

- Shkenca e algjebërës, zeroja dhe numrat janë gjetur prej myslimanëve dhe në Evropë kanë kaluar nëpërmjet myslimanëve.

- Gjatësia e ekuatorit është caktuar si 39 mijë kilometra me një diferencë gabimi 2.5% në fund të matjeve dhe llogaritjeve që bënë në Sinxhan dhe Kufe Ahmed ibn Musa dhe vëllezërit e tij në periudhën e kalifit abbasit, Me'munit (786-833). Nga e merrnin dijen ata? Nga shenjat në Kuranin Fisnik...

Shumë gjeni myslimanë si,

- **Harizmi** në matematikë,
- **Xhabir ibn Hajjani** në kimi,
- **Ebu'l-Izz Ismail el-Xhezeri** në mekanikë,
- **Fergani** dhe **Battani** në Atsronomi,
- **Ibn Sina** në mjekësi, kanë bërë zbulimet më të rëndësishme të historisë së shkencës.

Për shembull:

- Ata që mundësua shndërrimin e gjeografisë në një shkencë, ishin myslimanët. Vepra *Sejihatname* e **Evlija Çelebiut** (1611-1682) i cili shëtiti në shumë shtete të botës dhe *Sejihatname* e **Ibn Battutës** (1304-1369) i cili udhëtoi pa reshtur për 29 vjet radhazi duke shkuar nga një kontinent në tjetrin, janë thesare historie dhe gjeografie.

- **Kristofor Kolombi** (1446-1506) shënon se e ka mësuar nga myslimanët, veçanërisht nga librat e Ibn Rushdit ekzistencën e kontinentit të Amerikës.

- **Biruni** (973-1048) para shumë shekujsh ka folur për ekzistencën e Amerikës.

- **Piri Reis** (1465-1554) në veprën e tij me titull *Kitabi Bahrije* ka vizatuar hartën e Evropës. Përveç të tjerash harta e botës që ka bërë Piri Reisi është një prej gjërave që edhe sot nuk e zgjidh dot shkencë e historisë. Në këtë hartë "Ishulli i Gruenlandës" jepet në tri pjesë në përputhje me gjendjen origjinale.

Ndërkohë kjo është një e vërtetë e zbuluar vetëm pasi njeriu ka shkelur në hënë.

- **Idrisi** (1100-1166) rreth 800 vjet më parë ka arritur të bëjë harta të ngjashme me hartat e botës së kohës sonë.

- Nuk duhet të harrojmë se; Kristof Kolombi, Macellani, Amerigo Vespucci, etj., shfaqen si zbulues perëndimorë. Ndërkohë këta nuk janë zbulues. Shumica e tyre kanë qenë njerëz banditë. Me të vërtetë këta kanë qenë hajdutë, banditë dhe kriminelë që mbartnin skllëvër me anije nga Afrika, i hidhnin nga anija në mes të oqeanit ata që bënë rezistencë dhe që kolonizuan, skllavëruan dhe vranë njerëzit autoktonë të Amerikës për vite me radhë.

Ndërsa personalitetet myslimane si Ibn Battuta, Evlija Çelebiu dhe të tjerë si ata e kanë njoftuar botën në formën më efikase për çdo vend ku kanë shkuar.

- Në një lëmi tjetër shkencore **Ibn Halduni** (1332-1406) i cili ishte prej figurave më të zgjedhura të filozofisë historike, njihet si themeluesi i shkencës së sociologjisë. Ai edhe në ditët e sotme e ndriçon botën e shkencës me veprën e tij Mukaddime.

- Ndërsa kur flitet për arkitekturën, i pari që vjen në mendje në rang botëror është **Arkitekt Sinani** (1489-1588) i cili akoma jeton në zemrat tona me veprat e tij madhështore. Madje sot konsiderohet arkitekt i madh një njeri që mund ta imitojë Sinanin.

- Observatorët që ndërtuan **Ulug Beu** e **Ali Kushçu** dhe hartat e qiellit që bënë ata në astronomi, janë vepra që prijnë në historinë e shkencës.

Nëpër veprat që janë shkruar për perëndimin në ditët e sotme me kompleksin e përçmimit (ndaj të tjerëve), nuk flitet për zbulimet, shpikjet dhe gjetjet shkencore që kanë bërë myslimanët. Gjithmonë nxirren në pah shpikjet e evropianëve. Ky mohim në të njëjtën kohë është edhe një shfaqje e mosmirënjohjes së perëndimit... Ndërkohë perëndimi ia ka borxh civilizimit Islam përparimin teknik të ditëve të sotme.

Profesor **Fuat Sezgini**, i cili ka ndërruar jetë në një kohë të afërt, ishte një dijetar që ia kishte dedikuar jetën e tij vërtetimit të këtij fakti. Ai me punimet që bëri, tregoi se;



Në ditët e sotme me një qasje në qendër Evropën, përdorimi për herë të parë i matematikës në shkencat natyrore i atribuohet **Roger Baconit** (1219-1292), ndërsa shpikja e “dhomës së errët” e cila është baza e shkencës optike dhe e aparatit fotografik i atribuohet **Levi ben Gersonit** (1288-1344). Ndërkohë për të dyja përparësia i përket **Ibn Hejthemit** (v. 1041).

Ndërtimi i trigonometrisë si një shkencë më vete i atribuohet **Regiomontanusit** (v. 1476). Ndërkohë kjo i përket **Nasiruddin Tusit** (v. 1274).

Përshkrimi i botës me në qendër diellin së pari u atribuohet **Kopernikut** dhe **Keplerit**. Ndërkohë këta dijetarë kanë qenë të ndikuar nga dijetarët si **ez-Zerkali** (shekulli i 11-të) nga Andaluzia. Në çdo fushë mund të jap me qindra shembuj.

Tashmë dëshiroj të jap një shembull në lidhje me fanatizmin e perëndimit kundrejt të vërtetave shkencore që nga shekulli i 16-të.

Falë veprave që u përkthyen nga dijetarët myslimanë në Evropë, filluan të përhapeshin të vërtetat në lidhje me astronominë. Galileo, sikundër asaj që pohonte kisha, tha se Toka rrotullohej. Për këtë arsye u dërgua në gjykatën e inkuizicionit. Ai u dënua me burgim të përjetshëm. **Galileo** e ndryshoi deklaratën e tij për të shpëtuar nga ndëshkimi, por kur po dilte nga dera nuk e mbajti dot veten dhe tha përsëri:

“Edhe pse unë them nuk rrotullohet, Toka rrotullohet!”

Ja edhe një shembull tjetër: Kur mendimtarët e rëndësishëm të Evropës si **Thomas Aquinasi**, **Pascali**, **Descartesi** dhe **David Hume** po formonin sistemet e mendimit, përfituan prej veprave të **Imam Gazaliut**.

Për fat të keq myslimanët e sotëm, siç nuk i kanë dalë për zot civilizimit tonë, janë edhe të painformuar siç duhet në lidhje me të!

### 3) Në ditët e sotme, ateistët dhe deistët, me sloganin “Feja apo shkenca?”, po përpiqen të mbjellin një farë të re të së keqes në mendjet dhe zemrat e brezave të rinj. Çfarë përgjigje mund të kemi për ta?

Përgjigja për këtë është mjaft e thjeshtë:

Para së gjithash, feja dhe shkenca nuk janë alternativa për njëra-tjetrën. Ajo që ne e quajmë shkencë konsiston në përcaktimin e rregullave që Allahu i Madhëruar ka vendosur në univers.

Nëse Zoti i Madhëruar nuk do t'i kishte vendosur këto rregulla në univers dhe nuk do t'i kishte dhënë njeriut aftësitë njohëse për t'i zbuluar ato, si do ta zbulonte njeriu një gjë të tillë si “shkenca”?! Për rrjedhojë, Allahu i Plotfuqishëm nuk ua ka dhënë aftësinë për t'u angazhuar në dituri krijesave të tjera të cilave Ai nuk ua ka ngarkuar as përgjegjësinë e të qenit robër të Tij. Ai ia ka dhëruar këtë aftësi vetëm njeriut. Në një ajet, Allahu urdhëron: **“...juve nuk ju është dhënë veçse pak dije!”** (Isra, 85.)

Prandaj, ta kthesh shkencën në një idhull kundër Zotit të Plotfuqishëm, i Cili është Pronar i dijes së pafundme dhe absolute, me këto

thërrime dijeje, është vetëm një tregues se në çfarë grope të thellë shkujdesjeje dhe budallallëku kanë rënë ateistët dhe deistët.

Allahu i Plotfuqishëm i ka dhënë njerëzimit fenë dhe po Ai ia ka dhuruar dijen dhe shkencën. Ato nuk janë të ndara nga njëra-tjetra. Islami e ka inkurajuar shkencën gjatë historisë, dhe ndërsa bota perëndimore ishte në errësirën e injorancës dhe besëtytnive, bota islame arriti një nivel magjepës në shkencë dhe qytetërim. Kjo, sepse vetë ajetet e Kuranit hedhin dritë mbi shkencën. Zbulimet shkencore të bëra nuk mundën të kundërshtonin asnjë ajet të Kuranit, përkundrazi, e vërtetuan atë.

Islami, feja e vetme e vërtetë, nuk ka probleme me shkencën. Përkundrazi, Kurani shkon i pari dhe shkenca e ndjek atë duke e konfirmuar.

Në fakt, faktet rreth krijimit të njeriut, qumështit të nënës, daktiloskopisë, dermatologjisë, gjenetikës, mjekësisë parandaluese, botanikës, astronomisë, gjeologjisë, fizikës, gjeografisë, historisë dhe shkencave të ngjashme të shpallura në Kuran 14 shekuj më parë, janë zbuluar vetëm kohët e fundit nga qarqet shkencore dhe është vërtetuar vazhdimisht se sot, Kurani është i vetmi libër i vërtetë.

Në Perëndim, duke qenë se feja është shtrembëruar, ajo ka rënë në konflikt me zbulimet shkencore dhe autoriteti kishtar, i cili dominon shoqërinë dhe udhëheqjen, e ka penguar shkencën për të mbuluar këtë situatë. Prandaj, kundërshtimi i fesë duke mbrojtur shkencën është një qëndrim i popullarizuar në Perëndim dhe që prej andej u përhap në botë. Megjithatë, në botën islame, nuk ka asnjë bazë të saktë ku mund të reflektohet ky qëndrim.

Pra, pyetja; "Feja apo shkenca?", është një nga helmet e injektuara nga qarqet dashakeqe që duan të mbjellin farën e dyshimit dhe të mohimit në mendjet e pastra të brezave të rinj, gjoksi i të cilëve është

plot besim. Prandaj, është detyrë e çdo muslimani që të jetë jashtëzakonisht i kujdesshëm dhe vigilent ndaj viruseve të tilla.

Rumi u gjendjen e personit që përfshihet nga mendjemadhësia dhe murrja e përshkruan përmes tregimit të milingonës:

“Një milingonë e cila kishte hipur mbi një fije bari në një pellg të vockël uji, e pandeh veten në një pozitë të lartë dhe midis një deti të madh.

Thotë me veten: unë e njoh më mirë se të gjithë detin dhe jap komandanti më i aftë.

O ti njeri që e shikon veten dhe mjedisin me syrin e kësaj milingone a ke menduar çfarë do të ndodhë kur Azraili të tërheqë fijen e barit?!”

Allahu i Madhëruar e fton njeriun të njohë mundësitë e veta.

**“A nuk sheh njeriu se si Ne e krijuam atë prej pikës së farës e megjithatë, ai bëhet kundërshtar i hapët?!”** (Ja-Sin, 77)

Të shkujdesurit që kanë harruar se natyra e tyre e vërtetë është “hiçi dhe mosekzistimi”, nuk mund të shpëtojnë nga vorbulla e egos, krenarisë dhe mendjemadhësisë, të cilat janë fatkeqësitë më të mëdha shpirtërore.

Për shkak të egos së tij, Iblisi guxoi të debatojë me Allahun, duke thënë për Ademin r, “unë jam më i lartë se ai” dhe në fund u shkatërrua.

Karuni, i cili u mbyt në thesare si provë hyjnore, e kundërshtoi Musain ﷺ, që i llogariti zekatin dhe dëshiroi t’ia marrë. Ai mbajti qëndrim të ashpër dhe me arrogancë të madhe tha: “Këto thesare i fitova me dijen time”. Por në të vërtetë ai harroi se ato ishin mirësia dhe sprovë e Allahut Teala. Prandaj dhe u varros në fund të dheut bashkë me thesaret e tij.

Ndërsa Bel'ambin Baura ia atribuoi vetes suksesin shpirtëror që arriti dhe me mendjemadhësi anoi nga dëshira e tij. Por Allahu Teala e shkatërroi, duke e çmendur si një qen që merr frymë duke nxjerrë gjuhën jashtë.

Në vitin 1912, kur anija gjigande Titanik doli në udhëtimin e saj të parë, me krenari dhe mburrje u tha: "Këtë anije nuk mund ta fundosë asnjë forcë". Por që në udhëtimin e parë, anija u përplas me një ajsberg dhe humbi në thellësitë e oqeanit së bashku me ata që kishte brenda.

Në vitin 1986 anija kozmike "Challenger", që do të thotë "Sfiduesja", shpërtheu 73 sekonda pas lëshimit dhe i gjithë ekuipazhi i saj vdiq.

Në 18 Mars të vitit 1915, luftanija e madhe franceze "Inflexible" që do të thotë "e papërthyeshme, e papërkulshme", u dëmtua rëndë dhe ngeli jashtë luftimi në luftën legjendare të Çanakalesë. Në të njëjtën ditë, edhe luftanija "Irresistible" që do të thotë "e papërballueshme", u përplas dhe u mbyt.

Edhe luftanija e madhe e flotës së Shteteve Aleate, e quajtur "Goliath", emër i frymëzuar nga Xhaluti, i cili u vra nga profeti Daud عليه السلام, u fundos në ujërat e Ngushticës së Dardaneleve, më 13 Maj të 1915 nga fregata Muavenet-i Millije, e cila dukej shumë më e vogël dhe më e pafuqishme në krahasim me të.

Historia dëshmon se shembuj të tillë janë të panumërt. Ata që guxuan të sfidojnë Allahun në cilësinë e Madhështisë, zullumqarët që thanë "unë" përpara Hakut, popujt e fuqishëm si Adi dhe Themudi, të cilët u mburrën duke thënë: "Kush është më i fuqishëm se ne?" dhe ata që me mburrje e mendjemadhësi u mbështetën në mjetet të cilat i ndërtuan me aftësitë mendore që u kishte falur Allahu, gjithmonë u bënë shembujt më të këqinj të hakmarrjes hyjnore, duke u shkatërruar nën kamxhikët e dënimit.

Si përfundim, kur besimtari arrin një mirësi, gjithmonë duhet të thotë: **“Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim”** dhe duke ia atribuar atë mirësi pronarit të vërtetë, duhet të falënderojë i përlur. Në vend që të biem pre e nefsit tonë duke thënë: “E fitova me forcat e mia, apo e arrita me dijet dhe aftësitë e mia”, duhet synuar arritja e majës të ndjenjës së “hiç”it, duke thënë: “Të gjitha mirësitë janë prej Teje, o Zot!”.

**4) Në ditët tona, ka nga ata që thonë se relaksohen dhe gjejnë paqe duke bërë disa praktika si joga dhe meditimi që vijnë nga fetë dhe filozofitë jashtë Islamit. A mundet një mysliman të praktikojë joga apo meditim? A mund ta çlodhin vërtet shpirtin praktika të tilla? Çfarë na rekomandoni në lidhje me këtë çështje?**

Fillimisht, duhet të pohojmë se; Joga dhe meditimi, të cilat janë të përhapura në fetë dhe filozofitë e Lindjes së Largët, nuk mund t'i japin një personi paqe të vërtetë dhe kënaqësi shpirtërore.

E vërteta që shqetëson më shumë shpirtin e njeriut janë të panjohurat për vdekjen dhe pas saj. Adhurimi ose terapia e feve jo Islame nuk mund të kurojë vdekjen dhe as të përgatisë një rrugë shpëtimi për njerëzit pas vdekjes. Prandaj, këto nuk mund t'i japin shpirtit të njeriut paqe dhe ngushëllim. Këto mund të ofrojnë vetëm lehtësim të përkohshëm për shpirtin, si një lloj narkoze e dhënë para një operacioni.

Për rrjedhojë, Imam Rabbani shprehet se meditimi rrit kënaqësinë e nefsit të njeriut. Kjo pikë është e rëndësishme! Ajo rrit kënaqësinë e nefsit/egos, jo të shpirtit.

Mirëpo, Islami dëshiron pastërtinë e shpirtit. Në fakt, qetësia që i dhuron zemrës adhurimi i kryer me përkushtim, është diçka krejt ndryshe. Një përsiatje e pjekur me një përkushtim zemre, është burimi i qetësisë së shpirtit dhe paqes së zemrës. Ajo që këshillon Islami; pra si rezultat i vetëkontrollit të realizuar me dhikër, meditim dhe përkushtim, njeriu gjen paqen e vërtetë që kërkon. Njeriu i afrohet edhe më tepër Zotit të tij, i Cili është streha e vetme për të. Ai strehohet në fuqinë më të madhe dhe kështu, ai arrin paqen e botës së përtejme dhe të kësaj bote.

Një mysliman, nuk mund të thotë, siç thonë disa injorantë: “Ne praktikojmë jogën për sport, hobi ose kurim. Kjo s’ka të bëjë fare me aspektin fetar.”

Kjo, sepse është e papranueshme për një mysliman që duhet të ketë personalitetin dhe karakterin e Islamit, të imitojë atë që hindusët dhe budistët bëjnë si adhurim.

*“Kushdo që përpiqet të imitojë një popull, ai është prej tyre.”* (Ebu Daud, Libas, 4/4031).

Nga ana tjetër, edhe në përsiatje/tefekkur ekziston një situatë e ngjashme. Meditim, në fakt do të thotë “përsiatje e thellë.” Po atëherë pse quhet “meditim” në vend të “tefekkur”? Sepse me emrin që mban të kujton një klasë dhe një sistem të caktuar. Atëherë, ne duhet të qëndrojmë larg këtij produkti të huaj kulturor të praktikës së ngjashme me adhurimin.

Sot, jobesimtarët, ateistët, jomyslimanët, hebrenjtë, të krishterët, budistët, etj., teoritë, terapitë dhe kurat shpirtërore të hedhura nga pseudo studiues, i paketojnë sikur të ishin produkt i shkencës objektive - për të tërhequr të rinjtë tanë- dhe ua prezantojnë ato fëmijëve tanë.

Ndonjëherë, i pyes njerëzit që thonë: “Studioj psikologji”:

“-A ka ndonjë informacion në plan programin tuaj nga Mevlana? Ne kemi shumë dijetarë të mëdhenj, si Imam Gazaliu, mistikë të tjerë,



teologë, muhadithë, juristë dhe edukatorë; a ka ndonjë njohuri apo përvojë prej tyre?”

“Jo!” - thonë ata.

Mirëpo, “Mesnevia” e Rumiut, është plot me propozime të shkëlqyera diagnostikimi dhe trajtimi të nefsit dhe shpirtit njerëzor. Dhe që të gjitha janë zgjidhjet më të përshtatshme dhe më të sakta për realitetin njerëzor. Të tilla janë edhe vepra si “Ihja’u Ulumi’d-Din” dhe të ngjashme. Ato janë vepra shpirtërore që kanë dalë nga zemrat e devotshme.

Nuk është e mundur që një besimtar të gjejë qetësinë shpirtërore me disa kuptime të praruara dhe të korruptuara që politeistët, jomyslimanët, madje edhe pasuesit e feve më primitive të Lindjes së Largët i kanë nxjerrë nga pellgjet e tyre kulturore dhe i kanë stolisur.

Pra, preokupimi me gjëra si joga dhe meditacioni, është një lloj ryshfeti për nefsën. Edhe nëse duket sikur ato ndikojnë, ky është një mashtrim i përkohshëm.

Mjetet e spiritualitetit në kulturën dhe qytetërimin tonë, janë namazi, agjërimi, këndimi i Kuranit, përsiatja dhe dhikri. Këto adhurime janë shërim për trupin e zemrën dhe ushqim për shpirtin aq sa ato kryhen siç duhet dhe me devotshmëri.

Ashtu siç sapo e shprehëm, joga dhe meditacioni mund të përmbajnë disa lëvizje, fjalë dhe praktika nga fetë e Lindjes së Largët. Kjo është jashtëzakonisht e rrezikshme për sa i përket akides/besimit. Kjo, sepse kryerja e adhurimit të një feje tjetër nga myslimani, jo vetëm që është e ndaluar, por e nxjerr njeriun nga feja. Në librat tanë të fikhut, pjesëmarrja në ritet e feve të tjera, imitimi i asaj që ata bënin në Krishtlindjet dhe festat dhe ditët fetare të ngjashme, konsiderohen si shenja blasfemie.

Na vjen keq kur dëgjojmë se tendenca të tilla kanë filluar të përhapen në shoqërinë tonë. Dëgjojmë se ka njerëz që shkojnë në këto lloj terapie dhe thonë: "Ndihe mi të lehtësuar." Por ky nuk është aspak lehtësim; është një mashtrim shpirtëror, sepse në një hadith fisnik thuhet:

*"Nuk ka shërim në diçka që Allahu e ka ndaluar."* (Shih. Ebu Daud, Tib, 2; Tirmidhi, Tib, 7.)

Ashtu si pijanecët mashtrojnë veten duke thënë: "heqim mendjen nga hallet..." për të justifikuar pirjen e tyre, edhe këto terapi të huaja dhe jo islame, i japin besimtarit vetëm një ndjenjë lehtësimi të përkohshëm dhe të rremë. Ndërsa rezultati i kësaj është edhe më i keq, sepse nuk mund të gjendet lumturia në pazari i mjerimit.

Origjina e këtyre lloj praktikave, janë zakonisht fetë më primitive indiane. Duhet të mendohet se; sa u kanë bërë dobi këto fe pasuesve të tyre, që të mund t'u japin qytetërimeve të tjera?

Muslimanit i mjafton Islami, sepse Islami është madhështor dhe i përsosur; nuk ka nevojë për ndonjë sistem tjetër. Nuk ka nevojë për fe apo besime supersticioze që e kanë humbur ndikimin për shkak të prishjes që kanë pësuar.

E vetmja fe e vërtetë në tokë, që do të vazhdojë deri në Ditën e Kiametit është Islami.

Njerëzit gjysmë të egër dhe të prishur të epokës së injorancës, pasi u nderuan me besim dhe Islam, fituan virtyte të atilla shpirtërore nën edukimin Kuranor të të Dërguarit të Allahut, sa që me gjithë vuajtjet, varfërinë, mundimet, telashtet dhe persekutimet që përjetuan, nuk pësuan probleme psikologjike, por përkundrazi u bënë shërim për të gjithë botën.

Mirëpo, mes tyre kishte edhe të varfër, edhe të pasur. Kishte edhe

të sëmurë, edhe të shëndetshëm. Kishte të veja, jetimë, të shtypur dhe të persekutuar. E megjithatë, askush nuk kishte askush që të zhytej në depresion shpirtëror dhe të vuante nga çrregullime psikologjike. Kjo, sepse adhurimi i kryer me përkushtim të plotë e përforconte shpirtin e tyre –si vitaminat që i jepen trupit– . Paqja që sjell ndjenja e afërsisë me Allahun dhe vetëdija se jeta e vërtetë është ajo e ahiretit, i bën të parëndësishme në sytë dhe zemrat e tyre vuajtjet dhe mundimet e përkohshme të dynjasë.

Feja jonë e lartë, Islami, ka ofruar të gjitha recetat shëruese të nevojshme për paqen dhe lumturinë njerëzore. T'u kthesh shpinën dhe të kërkosh shërim nga praktikat besëtyte të Lindjes së Largët është e ngjashme me gjendjen e njerëzve fatkeq që lypin dhe vdesin nga uria, pa e ditur se janë ulur mbi thesar.

Namazi, dhikri, përsiatja, lutja, shërbimi, dhurimet, fitimi i zemrave të të vetmuarve, gëzimi me lumturimin e të vuajturve, etj., janë burimet më të mëdha të qetësisë shpirtërore për një besimtar. Kjo, sepse vetëm Zoti i Plotfuqishëm mund t'i japë paqe shpirtit të njeriut. Shembulli më i mirë për këtë është gjendja e sahabëve dhe besimtarëve të devotshëm.

Prandaj, nëse një mysliman kërkon paqe, do ta gjejë atë në Islam. Ai e gjen atë në namaz, në agjërim, në namazin e natës, në dhikër dhe në dua. E gjen në xhami, në sexhade dhe në rahlen e Kuranit.

Nëse kërkon kuptime dhe urtësi të thella, do t'i gjejë në Kuran, në Sunet dhe në librat e dijes. Çfarëdo që të kërkojë, ne e kemi; do t'i mjaftojnë qytetërimi dhe kultura jonë. Prandaj, ne duhet ta kuptojmë drejtë deklaratën dhe dëshminë që na këshillon ky hadith fisnik:

*"Jam i kënaqur me Allahun si Zot, Islamin si fe dhe Muhamedin ﷺ. si Profet."* (Tirmidhi, Deauat, 13/3389.)

Me pak fjalë, nëse na ngushtohet shpirti:

- Duhet të shoqërohemi me të drejtët.

- Të qëndrojmë me ata, të cilët nuk duan asgjë prej nesh në këtë botë, na kujtojnë Allahun dhe ahiretin dhe na ngrenë gjendjen tonë shpirtëroren në grada më të larta.

- Në vend që të rendim pas grupeve të terapive, le të formojmë kuvende bisedash fetare.

Ashtu si sahabët e Profetit ﷺ, të cilët uleshin së bashku duke thënë: “Ejani të ripërtërijmë besimin tonë për një çast, të forcojmë besimin tonë...”, edhe ne duhet të formojmë kuvende në të cilat do të forcojmë besimin.

Kur Abdullah bin Rauaha takonte ndonjë nga sahabët, i thoshte:

“Eja (vëllai im!) Le të ulemi pak për Allahun dhe të rifreskojmë besimin tonë në Zotin tonë (le ta përkujtojmë Atë)”.

Kjo, sepse edhe ushqimi i zemrës, edhe ushqimi i shpirtit është të në përmendjen e Allahut. Kështu, në një ajet urdhërohet:

**“..Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”** (Rad, 28.)

Vazhdimi i përmendjes së Allahut, bën që në zemër të gjelbërojë dashuria për Allahun dhe ta mbush atë me dashuri dhe përkushtim duke e larguar atë nga punët e kota të kësaj bote.

Prandaj, paqja e shpirtrave tanë, mund të arrihet nëpërmjet lidhjes sonë me Allahun e Plotfuqishëm dhe unitetit tonë me Të. Dhe mënyra për ta bërë këtë, është përmendja e Allahut t Plotfuqishëm. Qëndrimi larg dhikrit e vë njeriun përballë këtij paralajmërimi hyjnor:

**“Kush mbyll sytë para këshillave të Zotit, atij ia shoqërojmë një djall që nuk i ndahet kurrë.”** (Zuhruf, 36.)

Kjo sepse për sa kohë njeriu është vetëm, ai bëhet lodër e shejtanit. Duke i fryrë lehtë në vesh, shejtani e bën atë të humbasë besimin. Allahu na ruajt!..

## 5) Si mund ta bëjmë namazin më shumë pjesë të jetës sonë? Çfarë mund të thoni në lidhje me rëndësinë e namazit?

Së pari duhet të shohim ndjeshmërinë që kishte Resulullahu ﷺ, ndaj namazit. I Nderuari ynë ﷺ, ka thënë:

*“Nuk ka mirësi në një fe pa ruku (pa namaz).”* (Ebu Davud, Haraxh, 25-26.)

Gjithashtu në një hadith tjetër fisnik jemi lajmëruar se pyetja e parë që do të bëhet në lidhje me ibadetet në ditën e gjykimit, do të jetë për “namazin” dhe se robi do të shpëtojë nëse i ka falur namazet në atë formë që Allahu është i kënaqur dhe se do të humbë nëse ka ndodhur e kundërta. Po ashtu i Nderuari ynë ﷺ, kur po jepte frymën e fundit, ka thënë tri herë: *“Kini frikë prej Allahut në lidhje me çështjen e namazit!”*

Pastaj ia dorëzoi Zotit (xh.xh.), shpirtin e tij fisnik duke u shprehur përsëri: *“Namazi, namazi!..”*, pasi dha edhe disa këshilla të tjera.

Kur Omeri ﷺ, u plagos rëndë nga atentati që i ndodhi, i binte të fikët nga hemorragjia dhe nuk mund të vinte dot në vete në asnjë mënyrë. Por kur hynte koha e namazit dhe dikush i përkulej te veshi e i thoshte:

“Namazi o Omer, namazi!”, vinte në vete me një vullnet mahnitës dhe me atë gjendje e falte namazin. Pastaj thoshte: *“Ai që s’ka namaz, s’ka vend në Islam!”* – dhe e humbte përsëri vetëdijen.

Tregon **Rebia ibn Ka’bi** (Ebu Firasi), i cili e kalonte natën te dera e të Dërguarit të Allahut ﷺ, që i përgatiste atij ujin e abdestit dhe që i sillte gjërat për të cilat kishte nevojë :

Një ditë Resulullahu ﷺ, më tha: *“Kërko prej meje, që të të jap.”* Unë i thashë: *“O i Dërguari i Allahut! Më jepni kohë që të mendohem dhe ta shoh gjendjen time.”*

I Nderuari ynë ﷺ, më tha: *“Në rregull, mendo dhe shihe gjendjen.”*

Mendova dhe me vete thashë: *“Interesat që i përkasin kësaj bote harxhohen dhe mbarojnë shpejt. Nuk shoh gjë më të mirë për veten time, sesa të zgjedh diçka të dobishme në lidhje me ahiretin.”* Pastaj shkova në audiencën fisnike të të Dërguarit të Allahut ﷺ. Ai me tha:

*“Çfarë nevoje ke?”* Unë i thashë:

*“O i Dërguari i Allahut! Ndërmjetëso për mua, në mënyrë që Zoti (xh. xh.), të më lirojë nga xhehenemi!”*

Resulullahu ﷺ, më tha:

*“Kush të mësoi që ta thuash këtë?”* Unë i thashë:

*“Pasha Allahun, o i Dërguari i Allahut, askush nuk më mësoi. Por pas shë gjendjen time dhe vura re se kjo botë nuk qëndron në duart e atyre që e duan. Ajo zhduket menjëherë. Për këtë arsye preferova të kërkoja diçka për ahiretin.”*

Resulullahu ﷺ, më tha:

*“Atëherë më ndihmo për veten tënde duke bërë shumë sexhde!”* (Ahmed, IV, 59; Shik. Muslim, Salat, 226.)



Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik flet për **“namazin”** në 99 vende, duke u bazuar në rëndësinë e tij. Allahu Teala është Ai që na fton për të falur namazin duke thënë: **“...Bëj sexhde dhe afrohu.”** (Alak, 19)

Për këtë arsye, dëshira e zjarrtë ndaj namazit është një shfaqje e dashurisë në zemër ndaj Allahut (xh.xh.). Ai që e do Allahun, e zbaton edhe urdhrin e Tij me dashuri, sepse namazi është një takim dhe bisedë me Allahun e Lartësuar. Le të përpiqemi të bëjmë vepra që i do Allahu, në mënyrë që edhe Allahu të na dojë, sepse, kur Allahu e do robin e Tij, i dhuron edhe dashurinë për të kryer veprat që Ai i do. Pra, ia mundëson atij t'i kryejë ato duke ndjerë një kënaqësi të papërshkrueshme. Meqë ra fjala, këtu dëshiroj të transmetoj një kujtim:

Një ditë më erdhi pranë një nxënës afrikan dhe më tha:

“Hoxhë, lutuni për mua!” I thashë: “Bir, çfarë dëshiron? Për cilin problem kërkon lutje?” Ia bëra këtë pyetje, sepse prej të rinjve në shumicën rasteve më vinin kërkesa për lutje në lidhje me çështjet si kalimi me sukses i ndonjë provimi, përfundimi i universitetit, gjetja e ndonjë pune ose çështja e martesës. Ndërsa kërkesa për lutje e atij të riu ishte shumë e rrallë. Ai më tha:

“Hoxhë! Lutjuni Allahut që të ma bëjë namazin shumë të dashur!” Me të vërtetë dashuria ndaj namazit duhet të jetë një ideal i rëndësishëm për çdo besimtar. Ky ishte edhe i gjithë halli i **Ibrahimit**. Edhe ai i lutej kështu Zotit (xh.sh.): **“O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi ta kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet!”** (Ibrahim, 40)

Domethënë se, të qenët vetë dhe pasardhësit prej atyre që e falin namazin me devotshmëri, ka qenë një njëra prej çështjeve që i preokuponte më së shumti edhe vetë pejgamberët. Përgjërimi ndaj Allahut, në mënyrë që ta na e mbushë zemrën me dashuri për namazin, është një domosdoshmëri e besimit të vërtetë. Nëse një prind i do fëmijët e tij,



nëse është i mëshirshëm ndaj tyre, atëherë duhet t'i ushtrojë ata me namazin që në moshë të vogël. Allahu na ruajt, sepse është shumë e dhimbshme, kur njeriut i vdes më i afërmi, ai mërzitet shumë për atë ndarje. Pastaj me kalimin e kohës i pakësohet mërzitja. Por pikëllimi i ndarjes më të madhe do të përjetohet në ditën e gjykimit. Robërve të devotshëm që janë prej banorëve të xhenetit, do t'u thuhet me një nderim dhe lavdërim të madh:

"Urdhëroni në xhenet!", bazuar në ajetin fisnik në të cilin thuhet:

سَلَّمَ قَوْلٌ مِنْ رَبِّ رَحِيمٍ


**"Paqe!" - do të jetë fjala prej një Zoti Mëshirëplotë.**" (Jasin, 58)

Por sikundër kësaj, mëkatarëve që janë banorë të xhehenemit, do t'u thuhet:

وَأَمْتَاذُوا الْيَوْمَ أَيُّهَا الْمُجْرِمُونَ

"(Ndërsa keqbërësve Ai do t'u thotë): **"Veçohuni sot ju, o kriminelë!"** (Jasin, 59) Ndoshta atje do të ndahen nga njëri-tjetri shumë bashkëshortë e bashkëshorte. Shumë fëmijë dhe prindër do të shkojnë në rrugë të ndryshme. Një pjesë e të afërmeve që kanë jetuar bashkë në këtë botë, do të shkojë në një anë dhe një pjesë do të shkojë në anën tjetër.

Ajo do të jetë një ditë në të cilën do të përjetohet një pikëllim i jashtëzakonshëm!.. Ja pra, për të mos u bërë prej të pikëlluarve atë ditë, sot duhet të kemi kujdes për orientimin tonë dhe t'i pranojmë fëmijët, të cilët janë zemra jonë, si amanet i Allahut Teala e të preokupohemi me edukimin shpirtëror të tyre që në moshë të vogël.

**Imam Maliku** , thotë: "Kur mësoja një hadith, babai më jepte një dhuratë. Erdhi një kohë e tillë që, edhe nëse nuk më jepte dhurata babai, mësimi i hadithit u shndërrua në një kënaqësi për mua."

Ja pra, edhe ne kështu duhet t'i inkurajojmë fëmijët tanë për namazin. Duhet t'i marrim përdore dhe t'i çojmë në xhami. Duhet t'ua bëjmë të dashur namazin dhe t'i ushtrojmë me të duke u dhënë shpërblime, në mënyrë që edhe pas nesh të vazhdojnë ta falin namazin duke marrë kënaqësi, shije dhe përsjirtshmëri prej tij. Në lidhje me këtë çështje edhe ne duhet t'i lutemi Zotit siç iu lut Ibrahim i عليه السلام, në mënyrë që fëmijët tanë të bëhen prej atyre që e falin namazin, inshallah.

Allahu i Lartësuar i ka dhënë aq shumë rëndësi namazit, saqë ka thënë:

**“O bijtë e Ademit, vishuni bukur (përshtatshëm) kudo dhe kurdo që të faleni!..”** (A'raf, 31) Domethënë se në namaz duhet të jemi të vetëdijshëm se gjendemi në audiencën hyjnore. Andaj nuk duhet ta falim namazin me rroba të papërshtatshme dhe të papastra. Namazin duhet ta falim duke qenë të rregullt (në veshje).

Që kur isha i vogël, i shihja me kujdes të mëdhenjtë tanë që tashmë kanë kaluar në mëshirën e Zotit. Kur kishin për të falur namazin, ata i rregullonin edhe fijet anash sixhadesë nëse ishin të çrregullta dhe më pas fillonin faljen.

Ja pra, çfarë ndodh për shkak të këtij përkushtimi që shfaqet ndaj namazit? Namazi e mbron njeriun nga shthurja dhe çdo vepër e shëmtuar.

Njeriu në këtë mënyrë mund ta kuptojë gradën e pranimit të namazit:

Ai namaz që fal;

-A ia mbron sytë që të mos shikojnë haram?

-A ia mbron veshët që të mos dëgjojnë zëra dhe fjalë të gabuara?

-A ia mbron gjuhën nga përgojimi, thashethemet, gënjeshtra, shpifja dhe bisedat boshe?

-A ndjen hushu (frikërespekt ndaj Zotit) përgjatë namazit?

-A i mbushet zemra me përshpirtshmëri pasi e fal namazin?

Ja pra, një namaz i pranuar e mbron njeriun nga shthurja dhe çdo vepër e shëmtuar. Ai ia mbush njeriut botën e brendshme me frymëzim dhe përshpirtshmërinë e afrimit me Zotin (xh.xh.). Çdo njeri mund ta vërtetojë gradën e pranimit të namazit që ka falur, duke parë se sa i posedon ai këto gjendje.

Ndërsa për një namaz të dobët që falet larg një përkushtimi të tillë, në një formë të thatë gjeometrike dhe për shtirje, syefaçësi, etj., Allahu i Madhëruar shpreh:

فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ . الَّذِينَ هُمْ . عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ

**“Mjerë për ata, të cilët falen! Të cilët janë të pakujdesshëm për namazet!”** (Maun, 4-5)

Përfundimisht, në lidhje me çështjen e namazit duhet t'i përgjehemi shumë Zotit (xh.xh.). Duhet të përpiqemi që ta falim namazin me përkushtim dhe frikërespekt ndaj Allahut, sepse namazi është një ibadet i domosdoshëm. Namazi është i domosdoshëm edhe në luftë dhe udhëtim. Përgjatë gjithë historisë islame ushtarët myslimanë i kanë falur namazet në grupe dhe nuk e kanë lënë asnjëherë pas dorë këtë ibadet të rëndësishëm, edhe nëpër beteja.

Për këtë arsye, një besimtar duhet ta konsiderojë lënien e namazit si një fatkeqësi të madhe siç është rënia në zjarr. Andaj, kur në ajetin fisnik flitet për mëkatet e mëdha që i kanë shpjerë banorët e xhehenemit në zjarr, njoftohemi se ata do të thonë:

**“Nuk ishim prej atyre që e falnin namazin!”** (Muddeththir, 43)

Zoti (xh.xh.), na e bëftë të gjithëve shumë të dashur namazin! E bëftë namazin dritë të syve tanë dhe miraxh të zemrave tona!..

**6) Komunizmi, kapitalizmi dhe liberalizmi janë sisteme njerëzore ndikuese në botë. Çfarë sistemi ofron feja Islame përballë tyre? Cila është pikëpamja botërore e Islamit në menaxhimin e individit dhe shoqërive?**

Ashtu siç e kam sqaruar edhe më parë në shembullin e Garaudi-t, sistemet njerëzore asnjëherë nuk kanë arritur të përmbushin nevojat e shpirtit të njeriut.

Kur u shfaqën komunizmi dhe socializmi, pretendonin se "Pasuria është e popullit". Por një grup i ashtuquajtur "elita", të cilët shtireshin sikur përfaqësonin popullin, zunë vendin e të pasurve dhe kështu pasuria nuk ishte më e popullit por e "partiakëve". Partiakët vepruan sipas nismave të tyre. Papritmas u bënë të pasur edhe pse më parë nuk zotëronin asgjë. Populli u varfërua. Ndërsa për ata, trageti, treni e gjithçka tjetër, ishin të gjitha falas.

Komunizmi u shfaq me pretendimin se gjoja të gjithë do të jenë të barabartë, në këtë mënyrë do të ketë drejtësi, balancë e paqe në shoqëri. Por, si ai që punoi, si ai që nuk punoi, u trajtuan njëllëj. Si ai që e theu broken, si ai që e mbarti pa e thyer, ishin të barabartë. Këto sjellje

u bënë shkak i paralizimit të prirjeve. Për shembull, në një garë, ai që vrapon më shpejt, shpallet i pari. Por nëse i pari dhe i fundit trajtohen në të njëjtën mënyrë, kjo nuk e motivon personin që mund të vrapojë shpejt. Kjo praktikë e ndalon zhvillimin në tërësi.

Komunizmi, për shkak të këtij qëndrimi kundër natyrshmërisë dhe realitetit njerëzor, u kthye në një sistem abuzimi nga i cili përfituan vetëm partiakët...

Përkundër kësaj mizorie dhe padrejtësie të komunizmit, Kapitalizmi u shfaq me shprehjen tunduese: "Pasuria është e individit". Mirëpo e tërë pasuria u grumbullua në duart e trusteve dhe karteleve. I pasuri u pasurua edhe më shumë. Njerëzit u armiqësuan ndaj klasës sunduese dhe borgjezisë. U përjetuan shumë drama.

Liberalizmi kishte moton: "Njerëzimi do të konkurrojë në liri". Askush të mos e ndalë kapitalin;

"Laissez faire, laissez passer!"

Pra: "Le ta bëjnë, le të kalojnë! Fitoni atë që fitoni!"

Do të dilnin mallra me cilësi më të mirë gjoja si rezultat i konkurrencës, prodhimi do bëhej më i lirë, çmimet do uleshin, pra të gjithë do fitonin. Por ndodhi e kundërta. Kartelet dhe trustet ranë në ujdi për çmimet. Kështu u mblodhën të gjitha fabrikat që prodhonin një laps, vlera e të cilit nuk kalonte 10 kurush, por ata e hodhën në treg me një çmim shumë më të lartë se vlera reale. Kështu u hap rruga e një abuzimi të ri. Me inflacionin e nxitur nga përqindja e interesit, të varfrit u varfëruan edhe me shumë.

Pra kuptimi i: «Le ta bëjnë, le të kalojnë! Fitoni atë që fitoni!», mori trajtën: "Të moliset shtresa e ulët".

Meqë mëshira dhe solidariteti as që ishin pjesë e jetës, pati shkatërrime dhe kriza sociale. E gjitha u shndërrua në një garë mes të fortëve për të shtypur të dobëtit.

Të gjitha sistemet shfaqeshin me mashtrim. Kapitalistët dhe komunistët u bashkuan në çështjen e pronës për të shfuqizuar dispozitat e pronarit të vërtetë të pasurive, Allahut të Plotfuqishëm. Në fakt ata ishin njëlloj. Pra, materialistë dhe femohues...

Komunizmi dhe kapitalizmi u ndanë në çështjen e përkatësisë së pronës. Komunistët deklamuan që "prona është e popullit", ndërsa kapitalistët pretenduan se "prona është e individit".

Ndërsa sipas Islamit prona nuk është as e popullit as e individit, ajo është vetëm e Allahut. Gjykimi i vullnetit hyjnor është përcaktues në përdorimin e pasurisë.

Islami mësoi se e gjithë pasuria është -me terminologjinë e sotme- një lloj prone e përkohshme (devre mullk). I mësoi njeriut se pasuria i është dorëzuar atij si amanet për një kohë të përcaktuar. Pra, njeriu nuk është pronari i vërtetë i pronës, por një përdorues i përkohshëm i pasurisë së tij.

Prandaj në Islam ndalohet rreptësishtë shfrytëzimi i njeriut dhe shoqërisë, dhe anashkalimi i kufijve hyjnorë për të përfituar disa të mira materiale prej të cilave një ditë do të largohemi.

Para së gjithash fitimet jo të lejuara si "*gabn-i fahish*", pra fitimi i tepërt duke mashtruar, interesi, spekulimi, stoqet, janë të ndaluara. Po ashtu, janë të ndaluara edhe shpërdorimi dhe koprancia.

Shpërdorimi është përpjekja për të mbuluar ndjenjën e inferioritetit përmes shfaqjes së forcës.

Ndërsa koprancia është akumulimi i pasurisë vetëm për vete dhe mosdhënia (shtrëngimi, ruajtja) e saj nga frika e rënies në varfëri, si një ndjesi e nxitur nga shejtani. Kjo është një dobësi që vjen si rezultat i frikës dhe mungesës së mbështetjes tek Allahu. Pra, në vend që të kërkojë strehim tek Allahu, njeriu kërkon strehim dhe mbrojtje tek paraja.

Si shpërdorimi, ashtu edhe koprracia janë një lloj rebelimi ndaj pronarit absolut të pasurisë, Allahut të Plotfuqishëm.

Njeriu, në çështjet materiale është një amanetqar që duhet ta përdorë pasurinë sipas dispozitave të Allahut.

Sistemet njerëzore e konsiderojnë njeriun si mekanizëm i rrotullës së ekonomisë dhe e shfrytëzojnë atë. Madje të vjetrit kishin një shprehje: “Më parë kishte puse në kopshte. Për të nxjerrë ujin nga këto puse, një kalë me sy të lidhur sillej rreth tyre nën trysinë e kamxhikut. Në këtë mënyrë nxirrej uji”. Komunizmi solli pikërisht këtë metodë prodhimi.

Kapitalizmi, nga ana tjetër, i tregon kalit qesen me bar, sapo ai afrohet, qesja tërhiqet dhe kështu e përdor kalin për të nxjerrë ujë nga pusi. Pra, të dy sistemet janë shfrytëzuese.

Nga ana tjetër ekonomia islame synon të zgjidhë problemin njerëzor. Kështu në Islam mundësitë duhet të ndahen me të tjerët, duke u bërë i dobishëm për ta.

Në ajetin fisnik thuhet:

وَفِي أَمْوَالِهِمْ حَقٌّ لِّلسَّائِلِ وَالْمَحْرُومِ

**“Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët...”**

(Dharijat, 19)

Nëse dikush ka një nevojë dhe e ndan me ju, ju duhet t’ia plotësoni. Por nëse nuk e shpreh si rrjedhojë e turpit dhe sedit, duhet të jeni ju ata që interesoheni për zgjidhjen e hallit të tij.

Krijuesi i Gjithësisë thotë: **“...Do t’i njohësh nga pamja e tyre...”**

(Bekare, 273)

Me fjalë të tjera, Islami e ngarkon të zotin e pasurisë me një detyrë. E edukon atë si ta përdorë pasurinë e tij, në mënyrë që ajo të bëhet shkak i afrimit të zemrave.

Si në çdo fushë të jetës, Islami ka vendosur një rend edhe në aktivitetin tregtar dhe atë ekonomik. Ka vendosur kufirin midis të lejuarës dhe të ndaluarës. Islami e konsideron besimtarin përgjegjës për vëllain e tij besimtar, duke urdhëruar mëshirë dhe butësi. Fitimin e ka brumosur me parimin e "hakut", "drejtësisë" dhe "mëshirës".

Islami ndalon fitimin që vjen si pasojë e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe haramit. Madje ka bërë me dije se adhurimet e kryera duke shkelur të drejtën e njeriut, janë të papranuara.

Në një hadith fisnik thuhet: *"Nuk i është bindur Allahut ai që e viziton këtë shtëpi (Qaben) me para të fituara në rrugë të ndaluar. Nëse një njeri i tillë, kur bën nijet për haxh, vishet me ihram, hip mbi yzengji dhe pasi fillon të ecë, thotë: "Lebbejk Allahume lebbejk", një lajmëtar nga qielli thërret:*

*«Për ty nuk ka as lebbejk as sa'dejk! Sepse të ardhurat tuaja, ushqimet tuaja, kafsha mbi të cilën kalëron, janë të gjitha të fituara përmes rrugëve të ndaluara. Kthehu si gjynahqar pa fituar asnjë sevap! Mërzitu, sepse do të përballesh me diçka që nuk ka për të të pëlqyer!»*

*Ndërsa nëse një njeri që nisat për haxh me para të fituara në rrugë të lejuar, hip mbi kafshën e tij dhe thotë: Lebbejk Allahume lebbejk, një lajmëtar nga qielli thërret: «Lebbejk dhe Sa'dejk. Ty t'u përgjigja. Sepse të ardhurat tuaja, ushqimet tuaja, kafsha mbi të cilën kalëron janë të gjitha nga burime të lejuara. Kthehu me sevape shumë të mëdha dhe pa asnjë gjynah. Gëzohu, sepse do të përballesh me gjëra që do të të gëzojnë dhe do të të lumturojnë!"* (Hajthemi, III, 209-210.)

Islami u ka kushtuar rëndësi zekatit, dhurimit dhe bamirësisë dhe ka penguar rritjen e pasurisë në mënyrë të pakontrolluar.



Zekati i detyrueshëm jepet veçanërisht për "pasurinë e grumbulluar». Zekati nuk është fakultativ, or i detyrueshëm. Është e drejta personale e të varfrit. Pra Islami, në një farë kuptimi, të varfrin e ka bërë ortak në pasurinë e të pasurit. Mosdhënia e zekatit është vjedhja më e keqe, është vjedhje e pasurisë (të drejtës) së të varfërve.

Islami siguron një solidarizim të vërtetë me shtresën e ulët sa i takon aspektit material.

Krijuesi i Gjithësisë i vë në provë njerëzit dhe shoqërinë përmes ndarjes së pasurisë dhe rriskut në mënyrë jo të barabartë. Si rrjedhojë e kësaj sprove:

- I pasuri është përgjegjës për të varfrin. Pra i varfri ka të drejta ndaj të pasurit. Në këtë botë i varfri është nevojtar i të pasurit. Në botën tjetër i pasuri do të ketë nevojë për duanë e të varfrit, do të ketë nevojë për shpërblimin e lëmoshës që i ka dhënë të varfrit.

- Personat me gjendje të mirë ekonomike, janë përgjegjës për të mjerët dhe vetmitarët.

- I fuqishmi është përgjegjës për të dobtin.

- I shëndoshi është përgjegjës për të sëmurin. Në këtë botë, të sëmurët kanë nevojë për ndihmën e atyre që janë të shëndoshë. Në Ditën e Gjykimit, në atë ditë të vështirë, njerëzit e shëndoshë do të kenë nevojë për duanë e të sëmurëve.

- I dituri ka përgjegjësi për të paditurin. Me pak fjalë, ai që zotëron një mundësi të caktuar, është përgjegjës për atë që është i privuar nga ajo mundësi. Pra, secili ka përgjegjësi për njeri-tjetrin. Çdo qytetërim formon modelin e vet njerëzor. Në Islam, tiparet dalluese të këtij modeli njerëzor, janë bujaria dhe sakrifica. Kështu:

**Zekati** (Është një përgjegjësi minimale. Është një e drejtë e të varfrit, është e drejta e tij mbi pasurinë e të pasurit.)

**Sadakaja** (Është një lëmoshë vullnetare që i mbron njerëzit nga problemet dhe fatkeqësitë.)

**Infaku** (Nuk ka fund, është pa kufi.) Allahu Fuqiptotë thotë:

لَنْ تَنَالُوا الْبِرَّ حَتَّى تُنْفِقُوا مِمَّا تَحِبُّونَ

**“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...”** (Al-i Imran, 92)

Ky nivel i bujarisë dhe sakrificës, e afron më tepër njeriun me Zotin.

Natyrisht gjatë dhurimit, Islami kërkon edukatën, delikatesën dhe ndjeshmërinë e vetëdijes se lëmosha nuk mbërrin në duart e të varfërve apo nevojtarëve, por në dorën e fuqishme të Krijuesit të Gjithësisë në përputhje me ajetin kuranor:

وَيَأْخُذُ الصَّدَقَاتِ

**“...Lëmoshën e merr (Allahu)...”** (Teube, 104)

Përveç kësaj, e ndalon njeriun nga mbartja e qëllimeve egoiste, si: syfaqësia, dukja, krenaria, mendjemadhësia dhe vetëkënaqësia. Sepse besimi monoteist nuk pranon asnjë lloj ortakërie. Prandaj duhet të dhurohet fshehurazi. Me pak fjalë, Islami e ka ringjallur shoqërinë me vlera shpirtërore, si: mëshira, sakrifica, altruizmi dhe bujaria. Tek të parët tanë Osmanët, janë regjistruar rreth 26.600 vakufe. Ka shumë të tjera që ende nuk njihen. Këto institucione të mëshirës e dhembshurisë u shtrinë në të gjithë shoqërinë. Për këtë arsye, në shoqëri të tilla nuk janë përjetuar kriza ekonomike, trazira apo rebelime. Të tilla probleme nuk kishte as në Epokën e Lumturisë. Përse? Sepse ekzistonte zekati, infaku (dhurimi), sadakaja, agjërimi... Gjithashtu nuk përjetohej ndonjë shqetësim psikologjik si (për shembull) depresioni, sepse namazi i ruante njerëzit. Krijuesi i Gjithësisë shprehet:

**"...bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!"** (Alak, 19)

**"O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit!"** (Bekare, 153)

**"Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!"** (Rra'd, 28)

Kjo është pikëpamja botërore e qytetërimit tonë...

Komunizmi solli një model njerëzor të ngurtë, të pashpirt, mizor.

Edhe kapitalizmi solli një rrënim të njeriut që u kthye në qenie brutale, arrogante dhe të devijuar nga natyrshmëria. Të dy bashkë sollën modelin e njeriut të pamëshirshëm, të pandjeshëm, të pandërgjegjshëm, materialist.

Të gjithë jeni dëshmitarë të vendeve të shfrytëzuara historikisht dhe në mënyrë të veçantë po shihni Sirinë e sotme: Kapitalizmi i egër vjen nga mijëra kilometra larg, bombardon, djeg dhe shkatërron...!

Po shfrytëzon burimet e tyre nëntokësore dhe mbitokësore duke shtypur edhe më tepër shtresën e dobët. Sistemi kapitalist mendon vetëm për interesin material dhe përfitimin. Për këtë arsye e shfrytëzon njeriun në mënyrë të pamëshirshme. E konsideron të lejuar çdo rrugë me qëllim që të arrijë suksesin e tij.

Ndërsa Islami përkundër kapitalizmit dhe komunizmit, zgjon ndër-gjegjen duke pyetur:

"Ku e fitove pasurinë? Si e fitove? Ku dhe si do ta përdorësh?" I përkujton njeriut se do japë llogari në mënyrë të hollësishme para gjykimit hyjnor. Megjithatë një besimtar i devotshëm e nis ditën duke u pyetur nga ndër-gjegjja: *"Allahu i plotfuqishëm sot hapi një fletë të re nga kalendari i jetës tënde. Sa kohë do të punosh sot për veten dhe sa kohë për të tjerët? Allahu të dhuroi ty plot nga begatitë e Tij, por filanit nuk i dha. Do të thotë që ai ka të drejta mbi ty..."*

Në ajetin fisnik Krijuesi i Gjithësisë thotë: **“Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu.”** (Kasas, 77)

Për këtë arsye, një besimtar i vërtetë, me një zemër altruiste, e konsideron veten vazhdimisht përgjegjës në përbushjen e nevojave dhe mangësive të krijesave, duke dhuruar dhembshuri dhe mëshirë.

Shmangia e shpërdorimit dhe jetesa në mënyrë të moderuar, e afruan të pasurin me të varfrin.

Kultura e zekatit, infakut dhe vakufeve, parandaloi përjetimin e dramave në shoqëri.

Secili e konsideroi veten përgjegjës për vëllain e tij, përmes ndjenjës së vëllazërisë. Besimtarët ishin si dy duar që lanin njëra-tjetrën. Ata ndanë me njeri-tjetrin problemet e veta, jo vetëm në planin material por edhe në atë shpirtëror. Në këtë mënyrë u ndërtua një shoqëri e fortë si muret e kalasë, e mbërthyer me dashuri, si një trup i vetëm. Mirëpo, në periudhën e Lales (tulipanëve) shoqëria jonë filloi të jepej pas luksit dhe shpërdorimit. Ndërsa në periudhën e Tanzimatit filloi të shfaqej admirimi për Perëndimin dhe euforia evropiane. Ana materiale zuri vendin e anës shpirtërore.

Historia jonë e kohëve të fundit vazhdoi me një qasje imituese ndaj botës kapitaliste duke u tjetërsuar tërësisht nga origjina. Sot, ne duhet të eliminojmë të gjitha këto aspekte negative dhe të ecim përpara me parimet bazë që Islami kërkon prej nesh. Për të shpëtuar veten dhe për të arritur lumturinë e shoqërisë, duhet të risjellim në praktikë kulturën e vakufeve dhe të dhurimit. Duhet të jemi pasues të denjë të asaj gjenerate që skaliti gurët e sadakasë dhe ndërtoi vakufe për fshirjen e borxhit të njerëzve në defterët e tregtarëve, për përgatitjen e pajës së vajzave të varfra, apo për kompensimin e vlerës së enëve të thyera të shërbëtorëve...

**7) Sot në botë, termi “islamofobi” po përhapet qëllimisht. Përse thuhet pikërisht “islamofobi” ndërkohë, që për fetë e tjera nuk përdoret termi “fobi-frikë”?**

Shkaku i përdorimit të termit “fobi” vetëm për Islamin dhe jo për fetë e tjera, është i qartë:

Sepse: *“Pema që ka fruta goditet”.*

*“Hajduti synon të vjedhë dyqanin e argjendarëve dhe jo të vjetërsirave”.*

Sot të gjitha fetë e rreme dhe të devijuara, nuk kanë çfarë t'i japin njerëzimit. Kishat në Europë po shiten dhe po kthehen në xhami. Bartësit e besimeve të rreme po mundohen ta paraqesin Islamin si të shëmtuar për t'i dhënë fund përhapjes së tij. Ata po përpiqen ta diskreditojnë Islamin për të parandaluar konvertimin në Islam të bashkëfetarëve të tyre.

Arsyeja pse flasin keq për Islamin është e thjeshtë:

*“E kota shqetësohet nga e drejta!”*

Ata që flenë në gjumin e shkujdesjes, shqetësohen nga ata që ua prishin gjumin.

Sot Islami po shqetëson njerëzit dhe shoqëritë pragmatiste, si dhe fuqitë imperialiste, si rrjedhojë e predikimit të mëshirës së vërtetë, dhembshurisë dhe altruizmit. Po ashtu po shqetëson zullumçarët dhe mashtruesit për shkak të drejtësisë dhe të së vërtetës që shpall.

Në të vërtetë, 20-30 vite më parë vendet Evropiane thurën plane kundër saj. Ata pranuan që qytetërimi Islam ishte i vetmi që mund të përballej me qytetërimin perëndimor. Kështu hodhën tezen e Konfliktit të Qytetërimeve.

Ata kanë frikë nga Islami edhe pse myslimanët janë ende shumë larg nga Perëndimi në aspektin material, politik, ushtarak, teknik dhe teknologjik.

Përse ndodh kjo?

Sepse sipas Islamit jeta e vërtetë është jeta e përtejme (Ahireti). Islami ndërthur jetën e kësaj bote me botën tjetër. Jep formulën e lumturisë për të dy botët.

Por ata nuk pranojnë përgjegjësinë e jetës së përtejme dhe janë në kërkim të jetës së dëfrimit, të rastësisë dhe të asaj që përshtatet me dëshirat e tyre egoiste. Arsyeja pse i kundërvihen Islamit është se kjo fe e ngarkon njeriun me përgjegjësi, përcakton kriteret dhe kufij në jetë dhe pengon papërgjegjshmërinë dhe indiferentizmin.

Ata gjithashtu e dinë se pragmatizmi e trazon ndërgjegjen njerëzore, sepse njerëzimi ka nevojë për dhembshuri dhe mëshirë.

Padrejtësia trazon zemrat. Njerëzimi ka nevojë t'i drejtohet një feje që urdhëron drejtësi dhe fal jetë.

Një jetë pa qëllim, jonjerëzore dhe e çmendur, e lëndon shpirtin

njerëzor, sepse njeriu është përherë në kërkim të qëllimit të ekzistencës.

Përgjigjen e kësaj pyetjeje e japin më së miri ata myslimanë që me zemër të mëshirshme e të butë e jetojnë Islamin në mënyrën më të denjë.

Në këtë këndvështrim, duan ta njollosin dhe ta deformojnë Islamin në mendjet njerëzore, në mënyrë që të pengojnë përhapjen e tij në masat e gjera.

Situata e sotme paraqitet e njëjtë me gjendjen e shumë pejgamberëve të cilët historikisht janë kundërshtuar dhe ndaj të cilëve është shpifur.

Sot, ata që duan të ndalojnë përhapjen e Islamit në mbarë botën, kanë krijuar një valë të shëmtuar urrejtjeje ndaj tij dhe myslimanëve, nën emrin «Islamofobi». Ata përpiqen ta etiketojnë Islamin me terrorizëm. Shpallin Islamin si diçka të frikshme e që duhet patur fobi.

Por e vërteta është se terrori bazohet në zemërim, ndërsa parimet Islame të edukatës, moralit, ndërgjegjes, dashurisë dhe frikës ndaj Allahut, të vërtetës dhe drejtësisë, janë parime të larta që për ata nuk kanë kurrëfarë vlere. Terrorizmi nuk njih lot, mëshirë dhe ndërgjegje.

Përkundër kësaj, Islami është ndërtuar veçanërisht mbi bazën e dhembshurisë dhe mëshirës. Allahu Fuqipotë në Kuranin Famëlartë na mëson për emrat e Tij "Rahman" (i Gjithëmëshirshmi) dhe "Rahim" (Mëshirëploti), pra për mëshirën që ka përfshirë çdo krijesë. Edhe Profeti ﷺ është dërguar si "mëshirë për botët".



Në Luftën e Dytë Botërore, Amerika bombardoi Japoninë me bombë atomike. Mbetën të vrarë gra, fëmijë, të moshuar, njerëz që nuk

kishin asnjë lidhje me luftën, madje edhe kafshët e bimët u shkru- mbëzuan e u bënë pluhur. Personi që e urdhëroi bombardimin ishte i krishterë. Edhe Hitleri që vrau me qindra mijëra njerëz ishte po ashtu i krishterë. Por askush nuk e quan këtë terrorizëm katolik.

Stalini ishte komunist. Vrau me qindra e mijëra persona. Ndërtoi kala me kafkat e viktimave. Por askush nuk e quan këtë terrorizëm komunist.

Izraeli ka vrarë vëllezërit tanë palestinezë për vite me radhë. Por askush nuk e quan këtë terrorizëm hebre.

Aty ku shteti mbyll njërin sy, në Mijanmar (Myanmar), terroristët po vrasin myslimanët e Arakanit. Por askush nuk e quan këtë terro- rizëm budist.

Islami akuzohet me terror edhe pse janë myslimanët atë që në- përkëmben dhe shkatërrohen. Islami po përpiqet të tregohet si diçka për t'u patur frikë.

E vërteta është se Islami ka sjellë një sistem drejtësie të jashtë- zakonshëm, i cili vlen edhe për luftën. I Dërguari i Allahut ishte burim mëshire edhe në luftë. Le të sjellim një shembull:

Në luftën e Bedrit, një ditë para betejës, idhujtarët kërkuan të nxirrnin ujë nga pusi i të Dërguarit të Allahut. Pejgamberi i lejoi. Në kthimin nga Bedri, kishin mbetur 150 km për të mbërritur në Medine. Ishin zënë 70 robër. Kafshët e udhëtimit nuk mjaftonin. Sahabët e nderuar herë pas here zbrisnin nga devetë e tyre, hipnin robërit mbi deve dhe ecnin. Shpreheshin se: "Edhe ata janë (njerëz) si ne". I Dërguari i Allahut i porositi sahabët: "Jepuni robërve për të ngrënë e për të pirë ashtu si bëni për veten tuaj!" Shumica dërmuese e myslimanëve ishin mbartës të këtij virtyti dhe kësaj mëshire.

Çfarë i bëri ata të sakrifikojnë në këtë mënyrë?



- Qasja ndaj krijesave me mëshirën hyjnore...
- Shpresa se edhe robërit do udhëzohen (si ata)...
- Shfaqja e një personaliteti dhe karakteri të lartë Islam...

Do të mjaftonte ky shembull për të treguar që Islami i mëson njeriut humanizmin e vërtetë. Pra ky humanizëm është tipar vetëm i Islamit, ndërsa humanizmi si ideologji është një gënjeshtër boshe.

Kur hedhim vështrimin në histori kuptojmë se, personi që ka luftuar më shumë me terrorin është i Dërguari i Allahut ﷺ. Periudha 23 vjeçare profetike është një periudhë lufte kundër terrorit. Terrorit ndaj të dobtëve në shoqëri, ndaj robërve, skllevërve, kafshëve e bimësisë... Ai respektoi të drejtat e çdo qenieje njerëzore, pa marrë parasysh nëse është besimtar apo i pafe. Si rrjedhojë solli paqe në shkretëtirat që qenë kthyer në liqene gjaku. Ai hodhi themelet e një qytetërimi të pashe-mbullt të virtyteve që historia e njerëzimit nuk kishte pare asnjëherë.

Ajo që duhet të bëjmë sot, është praktikimi i moralit të lartë të Resulullahut ﷺ që është dërguar si mëshirë për botët, dhe përcjellja e mesazhit të tij me aq sa kemi mundësi. Nëse e realizojmë këtë detyrë me dinjitet, sado të mundohen ta njollosin Islamin, Allahu i Plotfuqishëm ka për t'i prishur planet e tyre.

Sepse Islam do të thotë selam, shpëtim për njerëzimin, paqe, prehje...

Islami nuk është frikësues, përkundrazi është qetësim i shpirtit, në të njëjtën kohë është një fe që përhap delikatesë dhe mirësjellje. Islami lufton çdo lloj padrejtësie dhe terrori. Është feja e mëshirës ndaj çdo krijese.

Le të japim disa shembuj:

Një ditë i Dërguari i Allahut ﷺ u shpreh:

*"Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, nuk do të hyni në Xhenet derisa të mos mëshironi njëri-tjetrin".*

Sahabët thanë:

*"O i Dërguari i Allahut! Të gjithë jemi të mëshirshëm".* Pejgamberi u përgjigj:

*"Mëshira që kam për qëllim nuk është thjesht mëshira që keni për njeri-tjetrin. Përkundrazi është mëshira që përfshin të gjitha krijesat, po, është mëshira që përfshin të gjitha krijesat." (Hakim, IV, 185/7310.)*

I Dërguari i Allahut ﷺ një ditë pa një person duke tërhequr nga veshi delen, të cilën donte ta therte. Menjëherë ndërhyri duke thënë: *"Lëre veshin e bagëtisë (e kafshës) dhe kape nga qafa." (Ibn-i Maxhe, Dhebailh, 3.)*

Përsëri, i Dërguari i Allahut ﷺ, takoi një grup njerëzish rrugës. Ata ishin ndaluar dhe po flisnin hipur mbi kafshët e tyre. U tha:


*"Hipni mbi kafshët tuaja pa i lodhur dhe lërinë të pushojnë. Mos i ktheni ata në karrige për të bërë bisedat tuaja në rrugë. Ka shumë kafshë që janë më të dobishme se personi që mbartin dhe ato e përmendin Allahun më shumë". (Ahmed, III, 439.)*

Sevade ibn Rebi رضي الله عنه ka thënë:

*"Dola para Pejgamberit ﷺ dhe kërkova diçka. Ai urdhëroi të më jepeshin disa deve. Pastaj më këshilloi: "Kur të kthehesh në shtëpinë tënde porositi njerëzit e tu (anëtarët e familjes) që të kujdesen për kafshët, e t'u japin atyre ushqim (në mënyrë të rregullt). Po ashtu, urdhëroi që të presin thonjtë në mënyrë që kur të mjelin (kafshët) mos t'i dëmtojnë thithkat (gjinjtë) e tyre". (Ahmed, III, 484; Hajthemi, V, 168, 259, VIII, 196.)*

Po ashtu kur i Dërguari i Allahut po shkonte me sahabet e tij në Mekë, rrugës u ndesh me një gazelë që po flinte e strukur. I Dërguari i

Allahut urdhëroi një nga shokët e tij të priste pranë gazelës derisa të kalonin të gjithë në mënyrë që kafsha të mos shqetësohej.<sup>1</sup>

Ndërsa kur po shkonte në Mekë me një ushtri prej dhjetë mijë ushtarësh, rrugës pa një qen të shtrirë mbi këlyshët duke i ushqyer ato me gji. I Dërguari i Allahut thirri nga sahabet e tij Xhuajl bin Surakën , të cilin e ngarkoi me detyrën e rojtarit pranë këtij qeni dhe këlyshve të tij.<sup>2</sup>

Një herë i Dërguari i Allahut pa një fole milingonash që i ishte vënë zjarri. Ai nuk mundi ta pranonte këtë pamje. Foleja e djegur e milingonave trazoi zemrën e tij të butë dhe me një keqardhje të madhe u shpreh:

*"Kush e dogji këtë fole? Dënimi me zjarr është një e drejtë vetëm e Zotit të zjarrit."*<sup>3</sup>

Përsëri i Dërguari i Allahut kishte parë një beduin (endacak) që për të ushqyer kafshët e tij, përpiquej të hidhte gjethet e pemës duke e goditur atë me një shkop. U tha personave që kishte pranë:

*"Ma sillni atë beduin, por silluni butë me të, mos e frikësoni!"*

Kur e sollën iu drejtua butësisht:

*"O beduin! Hidhi gjethet në mënyrë të butë dhe duke e tundur pemën lehtë, jo duke e thyer atë. (Pra mos e dëmto rrënjën e pemës)."* (Ibnu'l- Ethir, Usdu'l-Gabe, Bejrut, 1417, VI, 378.)

I Dërguari i Allahut, i cili nuk pajtohej qoftë edhe me një dëmtim të rëndomtë të një dege peme, në çdo rast i kumtoi umetit të tij mirësinë, ëmbëlsinë, butësinë, mëshirën.

1. Muvatta, Haxh, 79; Nesai, Haxh, 78.

2. Vakidi, II, 804

3. Ebu Davud, Xhihad, 112/2675, Edeb, 163-164/5268.

Tek paraardhësit tanë Osmanët, mëshira dhe dhembshuria përfshiu edhe bimët e kafshët. Kështu, ishte e ndaluar me ligj të ngarkohej kafsha përtej mundësisë së saj. Forcat e rendit kishin për detyrë të evidentonin ata që shkelnin këtë ligj, duke i dënuar të mbanin të njëjtën ngarkesë dhe ta linin kafshën të pushojë. Sulltan Sulejmani gjatë ndërtimit të xhamisë Sulejmanije kishtë nxjerrë një sërë dekretesh në lidhje me kaf shët që përdorehin për transport dhe kishtë urdhëruar të vëzhgoheshin me kujdes oraret e tyre të pushimit dhe të kullotjes në livadhe.

Si përfundim, emri i një feje që fal mëshirë të tillë, jo vetëm ndaj njerëzve por ndaj të gjitha krijesave, në asnjë mënyrë nuk mund të barazohet me "fobi"-ra. Nëse Islami si fe e virtytit do njihej ashtu siç duhet, në vend të frikës dhe ngurrimit, do ngjallte vetëm dashuri dhe admirim. Përpjekja për ta njollosur duke anashkaluar këto virtyte, nuk është gjë tjetër vetëm se një tregues dashakeqësie.

## 8) Si duhet të sillet njeriu me krijesat e tjera? Si ishte sjellje e Pejgamberit ﷺ me gjallesat?

Çdo sjellje e të Dërguarit të Allahut kishte themel mëshirën dhe dashurinë. Ai kish trajtuar të gjitha krijesat me dhembshuri dhe butësi, qe përgjigjur për gjithë nevojat e nevojtarëve. Madje, edhe kafshët kanë marrë pjesën e tyre nga ky Oqean i Mëshirës. Në periudhën e injorancës paraislamike njerëzit i trajtonin kafshët në mënyrë të pakujdesshme dhe të pamëshirshme. Pa mëshirë e dhembje e pritnin mishin e kafshëve për së gjalli dhe e hanin, organizonin gara me përleshje të kafshëve. Të gjitha këto zakone që njollosnin ndërgjegjen e njeriut i mënjanoi i Dërguari mëshirë për gjithë krijesat nga Allahu i Lartë, Muhamedi ﷺ.

Sahabiu Ebu Vakidi رضي الله عنه rrëfen:

“Kur i Dërguari i Allahut ﷺ erdhi në Medine, medinasit hanin mish të prerë nga gungat e deveve dhe nga kofshët e dheneve.

I Dërguari i Allahut ﷺ ndaloi këtë ves e tha:

“Çfarëdo që pritet nga kafsha gjersa ajo është e gjallë, llogaritet si e ngordhur, nuk hahet.” (Tirmidhi, Sajid, 12/1480)

Një ditë Profeti ﷺ pa në rrugë një gomar me fytyrë të përgjakur, u dëshpërua dhe tha:

“Mallkimi i Allahut qoftë mbi atë që ka përgjakur kështu këtë kafshë!” (Buhari, Dhebaïh, 25)

Ata të cilët kishin shqetësuar shpezën, zogjtë e të cilës ia kishin marrë nga foleja, i urdhëroi dhe u tha:

“Kush e mundon këtë shpezë duke ia marrë zogjtë? Shpejt vendoni zogjtë në folenë e vet!” (Ebu Davud, Edeb, 163-164/5268)

Një herë kur Profeti pa një deve të cilës lëkura i ishte ngjitur për kocka, urdhëroi e tha:

“Frikohuni prej Allahut për hakun e kësaj kafshe e cila nuk flet! Shaloni të ngirë, thereni të ngirë!” (Ebu Davud, Xhihad, 44/2548)

Një ditë i Dërguari pa një njeri që therte një dele. Por ai, pasi kishte shtrirë për dhe delen, mudohej të mprehte thikën. Profeti i prekur thellë nga kjo sjellje arrogante dhe e pamëshirshme, ia tërhoqi vërejtjen atij personi e i tha:

“A dëshiron të mbysësh kafshën disa herë!? A nuk do të ishte më mirë të mprehësh thikën para se të shtrish për dhe kafshën?” (Hakim, IV, 257, 260)

Në një transmetim tjetër Profeti i pyet shokët:

“A doni që t’ju tregoj se kush është larg Xhehenemit, dhe xhehenemi larg tij?” Më pas përgjigjet e thotë:

“Ata janë personat të cilët janë të butë, të ndershëm, të mëshirshëm, të afërt dhe të dhembshur.” (Ahmed, I, 415)

Pejgamberi ynë ﷺ në një hadith tregon gjendjen e atyre të cilët janë të mëshirshëm dhe të atyre të cilët nuk janë të mëshirshëm:

*"Një grua mëkatore takon në shkretëtirë një qen i cili lëpinë rërën nga etja që e kishte kapluar. Nga mëshira nxori këpucën e saj dhe me të mori ujë nga pusi e i dha qenit të pijë. Allahu i Lartë i fali mëkatet kësaj gruaje. Një grua tjetër, duke mos përfillur macen e kishte lënë të uritur. Madje, kishte penguar atë që të mos hajë edhe thneglat. Si rrjedhojë e kësaj sjelljeje, macja kishte ngordhur. Kjo grua e pamëshirë për këtë shkak mori rrugën e Xhehneimit!"*  
(Shih. Buhari Enbija 54; Muslim, Sala, 151, 154; Birr, 133; Nesai, Kusuf, 14.)

Profeti ﷺ me këto kritere do të shndërroj shoqërinë injorante paraislame në një shoqëri të epokës së lumturisë (*asru sadet*). Madje edhe personat që dikur keqtrajtonin edhe njerëzit, edhe ata të cilët dikur groposshin vajzat për së gjalli, do të shndërrohen në shëmbëlltyrë, mëshira e dhembshuria e të cilit përfshinte edhe kafshët.

Ngaqë i Dërguari i Allahut ﷺ i cili është shembulli më i mirë, që duhet ndjekur madje edhe të drejtën, hakun e një zogu të vogël e përfillte dhe i përgatiste ata me një kujdes të papërshkrueshëm.

Profeti ﷺ me këto kritere do të shndërroj shoqërinë injorante paraislame në një shoqëri të epokës së lumturisë (*asru sadet*). Madje edhe personat që dikur keqtrajtonin edhe njerëzit, edhe ata të cilët dikur groposshin vajzat për së gjalli, do të shndërrohen në shëmbëlltyrë, mëshira e dhembshuria e të cilit përfshinte edhe kafshët.

Ngaqë i Dërguari i Allahut ﷺ i cili është shembulli më i mirë, që duhet ndjekur madje edhe të drejtën, hakun e një zogu të vogël e përfillte dhe i përgatiste ata me një kujdes të papërshkrueshëm. Edhe gjallesat e dëmshme për njeriun, si gjarprin dhe akrepin, urdhëronte që të mbyten me një goditje që të mos mundohen tepër. A nuk është një shembull i pashoq, fakti që të këshillosh që edhe gjallesat e dëmshme t'i mbysësh me mëshirë?

- 9) Perceptimi historicist i Kuranit dhe Islamit, në krye të të cilit vjen Fazlurrahmani në shkallë botërore, në ditët e fundit ka filluar të shtjellohet edhe nga disa teologë në Turqi. Madje në këtë kontekst është thënë se Kurani i ka zbritur Pejgamberit si kuptim. Ndërsa ai e ka shndërruar në koncepte dhe fjalë të asaj kohe. Nisur nga ky aspekt, si duhet ta kuptojmë dhe shpjegojmë të qenët e Kuranit mbi historinë dhe mesazhin universal të tij?**

Së pari duhet të shprehim këtë:

I Dërguari i Allahut, është Pejgamberi i fundit. Ai është i Dërguari i Allahut i kohës së fundit. Nëse do të bëheshin rinovime në Kuranin Fisnik, Allahu Teala mund të dërgonte një pejgamber tjetër.

Shumë ajete të Kuranit Fisnik nxjerrin në pah qartazi se ai (Kurani) i përket i tëri Allahut të Lartësuar, domethënë edhe me kuptimin, edhe me fjalët:



“Në të vërtetë, ty (o Muhamed) po të shpallet Kurani nga ana e një të Urti të Gjithëdijshtëm!” (Neml, 6)

“Nuk ka dyshim se ky (Kuran) është Shpallja e Zotit të botëve. Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe.” (Shuara, 192-195)

Domethënë se Kurani Fisnik është zbritur në zemrën e të Nderuarit tonë dhe nga aty i është dhënë të gjithë umetit.

Për sa i përket fjalëve dhe kuptimit të Kuranit përgjatë procesit të zbritjes, nuk bëhet aspak fjalë për ndonjë lloj ndikimi/ndërrhyrjeje të Pejgamberit ﷺ. Edhe kjo çështje është shprehur qartë në shumë ajete:

**“Kur u lexohen shpalljet Tona të qarta, atëherë ata që nuk shpresojnë se do të dalin, para Nesh thonë: “Na sill ndonjë Kuran tjetër ose ndërroje atë!” Thuaj (o Muhamed): “Është e pamundur ta ndërroj unë atë nga ana ime. Unë shkoj vetëm pas asaj që më është shpallur. Unë druaj, nëse e kundërshtoj Zotin tim, dënimin e Ditës së Madhe.”** (Junus, 15)

**“Kur ti (Muhamed) nuk u lexon atyre ndonjë varg nga Shpallja, ata thonë: “Ah! Sikur ta bëje ti vetë!” Thuaju: “Unë ndjek vetëm atë që më ka shpallur Zoti im...”** (Araf, 203)

Edhe këto ajete fisnike e shpjegojnë qartazi se i Dërguari i Allahut, ﷺ, nuk mund të kishte asnjë lloj roli për shprehjen e Kuranit në fjalë:

**“Ai është shpallje e zbritur nga Zoti i botëve! Sikur ai (Muhamedi), në mënyrë të rreme, të Na kishte veshur ndonjë fjalë, Ne do ta kapnim atë për dorën e djathtë dhe me siguri që do t’ia prisnim damarin e qafës e askush prej jush nuk do të mund ta mbronte. Natyrisht, Kurani është përkujtesë për ata që i frikësohen Zotit!”**

(Hakka, 43-48)

**“Mos nxito (o Muhamed) në leximin e Kuranit me gjuhën tënde! Ne e kemi për detyrë t’i mbledhim pjesët e tij e ta lexojmë atë. Dhe, kur ta lexojmë atë, ti përcille leximin e tij! Pastaj, e kemi Ne për detyrë ta shpjegojmë.”** (Kijamet, 16-19)

Prej këtij ajeti fisnik kuptohet se Pejgamberi ynë i Nderuar përgjatë zbritjes së shpalljes është përpjekur për t’i mësuar ajetet përmendësh. Edhe kjo gjendje tregon se ajetet i kanë zbritur atij me fjalët dhe kuptimin e tyre. Po t’i përkisnin fjalët të Nderuarit tonë, **Zot na fal, një përpjekje e tillë do të ishte e pakuptimtë.** Kurani Fisnik është një mrekulli në fjalë. Diksioni i tij i përket Allahut Teala. Për shembull:

Në vend të *el-hamdulil-lahi Rabbi’l-alemin*, nuk mund të thuhet *el-hamdulil-lahi ala’s-semavati ve’l-ard*, sepse bie letërsia, retorika dhe elokuenca. Përveç të tjerash, Zoti (xh.xh.), premtan se do ta mbrojë Kuranin deri në kiamet:

**“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.”** (Hixhr, 9)

Allahu i Madhëruar nuk ka dhënë ndonjë premtim se do t’i mbronte tre librat e tjerë. Andaj edhe ata me kalimin e kohës u manipuluan.

Për këtë arsye asnjë dispozitë e Kuranit Fisnik nuk mund të ndryshohet. Edhe tentativa më e vogël për rinovim është kufër. Me Pejgamberin e fundit ka ardhur mesazhi i fundit.

**Edhe këto argumente racionale në lidhje me faktin se Kurani nuk është formuar në mendjen e të Dërguarit të Allahut ﷺ, janë të njohura:**

- Ndryshimi ndërmjet metodës specifike të Kuranit që e sfidon njerëzimin, madje që i bën ta ndjejnë veten të dobët qoftë edhe poe-

tët më elokuentë e gojëtarë dhe metodës së haditheve fisnike është shumë i qartë.

- Praktikata e ixhtihadit të Pejgamberit tonë të Nderuar janë rregulluar disa herë nga Kurani Fisnik pothuajse me një metodë qortimi. Marrja e haraçit nga robërit e luftës së Bedrit, ngjarja e Abesesë, falja e xhenazes së kryetarit të hipokritëve nga Pejgamberi ﷺ, etj. Po të ishte formuar Kurani Fisnik në kokën e Pejgamberit ﷺ, Zoti na faltë, a do të shpreheshin me këto fjali plot qortime këto lloje ixhtihadesh?

- Po ashtu Pejgamberi ynë i Nderuar nuk bëri dot asgjë veçse të priste pa asnjë rrugëzgjdhje derisa t'i zbriste ndonjë ajet në lidhje me çështjen e Kibles, në ngjarjen e Ifkut dhe në situata të tjera të ngjashme me këto. Meqë ra fjala, duhet ta themi edhe këtë; mendimet si **historicismi** përgjatë historisë islame janë përvetësuar nga **grupet ekstremiste si Karmatinët që kanë dalë jashtë Islamit**.

Kurani Fisnik edhe me fjalët, edhe me kuptimin, domethënë me të gjitha aspektet e tij është fjala e Allahut (xh.xh.). Mbi të gjitha, ai ka ardhur deri në ditët e sotme me mbrojtjen e veçantë të Allahut pa iu ndryshuar qoftë edhe një shkronjë. Ai do të vazhdojë pa u ndryshuar deri në kiamet. Fakti që në asnjërën prej kopjeve të Kuranit Fisnik të cilat gjenden në të katër anët e botës nga e kaluara e deri më sot nuk ka asnjë ndryshim, është një ndër argumentet më të qarta të kësaj të vërtete dhe mrekullie. Krahas të gjitha këtyre të vërtetave, lëvizjet për manipulimin e fesë islame me mendime imponuese dhe të shpifura është metodë vetëm e misionarëve. Në këtë manipulim kanë si qëllim veçanërisht këto tri pika:

- Refuzimin e medhhebeve,
- Mohimin e Traditës Profetike,
- Anulimin e dispozitave...

▪ **E para:** Po përpiqen t'i bëjnë muxhtehidë të vetes të gjithë, madje edhe injorantët që kanë lexuar vetëm dy faqe duke i shfaqur si të panevojshme ixhtihadet dhe medhhebet. Si rrjedhojë e këtyre mendimeve të gjithë, madje edhe njerëzit më të paditur po tentojnë të formojnë një fe sipas perceptimit të tyre, duke thënë: "Sipas meje..." Ndërkohë të gjitha medhhebet e vërteta janë ekolet e jurisprudencës islame në të cilat janë mbledhur mendimet më të sakta të dijetarëve të përsosur muxhtehidë, duke filluar që nga sahabët e nderuar. Zgjedhja e njëres prej këtyre është domosdoshmëri. Nuk është e lejuar që të lihen të gjitha njëherësh, sepse të gjitha janë dispozita të ndërtuara mbi themelin e Kuranit dhe Sunetit.

▪ **E dyta:** Ata që përpiqen të manipulojnë fenë, dëshirojnë që Tradita Profetike të shihet me dyshim. Këtë po e realizojnë me një dredhi që duket si e vërtetë, duke bërë sikur po nxjerrin në plan të parë Kuranin Fisnik. Ndërkohë Kurani Fisnik është zbritur në zemrën e bekuar të **Pejgamberit** tonë të Nderuar. Ndërsa predikimi, shpjegimi dhe mësimi i Kuranit i përket të Dërguarit të Allahut ﷺ. Komentimi më i saktë i Kuranit Fisnik është Suneti i Krenarisë së Gjithësisë ﷺ. Suneti është praktikimi i Kuranit. Pra, nuk është diçka ndryshe nga ai. Gjithashtu nuk është diçka që mund të shkëputet prej tij.

**Abdullah ibn Dejlami** e shpreh si më poshtë rëndësinë e besnikërisë ndaj Traditës profetike:

*"Sipas asaj që më ka ardhur mua, fillimi i ikjes (shkatërrimit) të fesë do të ndodhë me lënien e Sunetit. Siç i zgjidhen fijet litarit një nga një dhe në fund këputet, edhe feja zhduket me braktisjen e suneteve një nga një."*  
(Darimi, Mukaddime, 16.) Domethënë se Kurani Fisnik dhe Tradita profetike janë dy arteriet kryesore të Islamit. Pra, janë dy argumentet bazë.

▪ **E treta:** Sigurisht që Kurani Fisnik ka dispozitat e tij. Ato janë urdhrat absolute të Zotit tonë për ne. Por njerëzit, besimi i të cilëve ka zënë mikrobe, përpiqen t'i nxjerrin jashtë funksionit urdhrave kurano-

re që i duken të vështira nefsit të tyre. Këtë tentativë e kanë quajtur **historicizëm**. Zoti na faltë, ata po shfaqin guximin të anulojnë dispozitat e Kuranit, duke thënë: “Këto ajete kanë qenë të vlefshme për atë kohë.” Gjithashtu thonë: “Këto dispozita kanë zbritur sipas kushteve të shekullit të shtatë të kalendarit gregorian.” Ndërkohë Kurani Fisnik është libri i fundit, Pejgamberi ynë i nderuar është i Dërguari i fundit dhe dispozitat që ka sjellë ai, janë dispozita të vlefshme deri në ditën e kiametit. Edhe pse Allahu i Madhëruar na njofton se e ka plotësuar fenë, kopeja historiciste tenton të ndryshojë dispozitat e ajeteve. Ndërsa, Allahu Teala thotë në ajetet fisnike:

**“Ndërsa atë që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.”** (Nisa, 14)

**“...Këta janë kufijtë e Allahut, andaj mos i shkelni ata! Ata që shkelin kufijtë e Allahut, pikërisht ata janë keqbërësit.”** (Bekare, 229)

Në fakt, ky qëndrim i historicistëve i ngjan pikërisht debatit që shejtani bëri kundrejt Zotit (xh.xh.). Siç dihet, kur Allahu i Lartësuar e krijoi Ademin ﷺ, i urdhëroi engjëjt:

**“Bëjini sexhde Ademit!”**

Sexhdeja për të cilën u urdhëruan këtu, nuk ishte sexhde adhurimi, por sexhde respekti. Por Iblisi i mallkuar u kaplua nga mendjemadhësia. Atë e pushtoi smira kundrejt Ademit dhe nuk i bëri sexhde. Kështu që e kundërshtoi urdhrin e Allahut (xh.xh.). Kur u pyet se përse nuk i bëri sexhde, në vend që të thoshte: **“Më mashtroi nefsi. Të kërkoj falje, o Zot!..”**; bëri një krahasim të pakuptimtë dhe dha mend duke u shprehur me mendjemadhësi: **“Unë jam prej zjarri. Ndërsa Ademi është prej dheu. Unë jam më i lartë se ai!”** Ndërkohë Allahu Teala nuk e kishte pyetur Iblisin: **“Je më i lartë ti, apo Ademi?”** Vetëm e kishte urdhëruar që t’i bënte sexhde Ademit. Kurse Iblisi nuk zgjodhi bindjen, por zgjodhi

kundërshtimin dhe mallkimin. Në këtë mënyrë Iblisi ishte i pari që e filloi debatin kundër Allahut (xh.xh.). Për shkak të kësaj paturpësie u përzu nga audienca hyjnore dhe mori ndëshkimin e përhershëm.

Përfundimisht, ky stil i të menduarit që e ka bërë flamur qëllimin për:

- Refuzimin e medhhebeve,
- Mohimin e Sunetit
- Anulimin e dispozitave të shariatit

Është plotësisht i humbur dhe nuk është gjë tjetër veçse një prej kurtheve për ta krishterizuar fenë tonë të lartë, Islamin.

Qëllimi i atyre që nxjerrin këto përçarje, është boshatisja e brendësisë së Islamit siç ka bërë Pavlosi (Pali) në krishterim. Kështu është manipuluar edhe krishterimi. Në fillim e prishën besimin me mendjen e njerëzve nëpër këshilla. Pastaj u hoq ibadeti dhe në vend të tij erdhi mesha. U hoq agjërimi dhe erdhi pehrizi. U hoq mbulesa e gruas, u anulua ligji hyjnor dhe në vend të tij u soll ligji njerëzor.

Lideri i kishës katolike, **Papa Françesko** thotë: *“Mendoj se do të ishte mirë që edhe ata të bënin një punim kritik rreth Kuranit siç e kemi bërë ne për tekstet tona të shenjta. Një metodë komentimi historiko-kritike do t’u mundësojë atyre të zhvillohen.”*

Domethënë, ai po thotë se edhe ne duhet ta komentojmë përsëri Kuranin siç i kanë komentuar ata sërish tekstet e tyre të shenjta. Ndërsa historicistët po i shërbejnë këtij projekti të Vatikanit.

Për këtë arsye, edhe marrja e dijes fetare nga një vend i duhur është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme po aq sa mos nënvlerësimi i dijes fetare. Veçanërisht vëllezërit tanë të rinj duhet të jenë të zgjuar në këto çështje dhe duhet ta mësojnë fenë nga hoxhallarë që

janë të devotshëm dhe të qëndrueshëm në rrugën e drejtë. Pejgamberi ynë i Nderuar ﷺ, e ka paralajmëruar kështu Abdullah ibn Omerin ﷺ, i cili ishte një prej sahabëve të cilin e donte shumë:

*“O Ibn Omer! Kapu fort pas fesë! Kapu fort pas fesë! Sepse ajo është edhe mishi, edhe gjaku yt. Bëj shumë kujdes se nga kush e mëson fenë! Dijen dhe dispozitat fetare merri nga dijetarët e drejtë dhe jo nga ata që anojnë majtas e djathtas!”* (Hatib el-Bagdadi, el-kifaje, fq.121)

**10) Në ditët e sotme, të mjaftuarit vetëm me Kuran për të kuptuar dhe jetuar Islamin duke përdorur shprehje të tilla si: “Ne na mjafton Kurani”, po bëhen ndikuese në disa qarqe. Ç’mendoni në lidhje me rëndësinë e Hadithit dhe Sunetit?**

Periodha 23 vjeçare e jetës së Pejgamberit ﷺ ishte një lloj komentimi i Kuranit Famëlartë. Nga Suneti i tij kemi mësuar namazin, agjërimin, të gjithë adhurimet, raportet shoqërore, ligjet. Si mund të jetohej një jetë pa të?

Krijuesi i Gjithësisë shprehet:

مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ اطَّاعَ اللَّهَ

**“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut.”** (Nisa, 80) Ajeti i mëposhtëm e shpreh bukur kuptimin e fjalëve të Pejgamberit ﷺ:

**“Ai nuk flet sipas dëshirës, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij.”** (Nexhm, 3-4)



Si fjala, ashtu edhe kuptimi i Kuranit Famëlartë është nga Allahu. Ndërsa Hadithet profetike, mënyrën e të shprehurit e kanë nga Profeti ﷺ kurse kuptimin nga Krijuesi i Gjithësisë.

Aliu ؑ thotë: *"E pamë të Dërguarin e Allahut të ngrihej në këmbë, u ngritëm edhe ne; e pamë të ulej, u ulëm edhe ne."* (Ahmed, I, 83.) Sahabët e nderuar e dinin shumë mirë se i Dërguari i Allahut vepronte vetëm sipas dëshirës së Tij (të Allahut). Mësuesi dhe edukuesi i tij ishte vetëm Allahu i Lartësuar. Ai nuk fliste sipas dëshirës, por predikonte shpalljen hyjnore. Në mënyrë të veçantë ajeti i mëposhtëm shpreh qartazi që krahas Allahut Fuqplotë, edhe i Dërguari i Tij është i autorizuar të vendosë dispozita fetare:

**"...Ai do t'i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t'i ndalojë nga të këqijat; do t'ua lejojë të mirat e do t'ua ndalojë të këqijat..."**

(Araf, 157; Teube, 29)

*Po ashtu:*

**"Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj."** (Hashr, 7)

**"Thuaju (o Muhamed): "Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet!"** (Al-i Imran, 31)

Kurani dhe Suneti janë dy baza të pandashme nga njëra tjetra. Sjelljet dhe veprat e Pejgamberit janë një koment i Kuranit Famëlartë. Si rrjedhojë edhe ne në ditët e sotme duhet të jemi shumë vigilentë ndaj grupimeve të cilët po përpiqen ta zhvlerësojnë Traditën Profetike, e cila është një koment i gjallë i Kuranit Famëlartë, duke thënë se "Na mjafton neve Kurani".

Ejjub es-Sahtijani, një ndër dijetarët e fikhut dhe hadithit, i kohës së tabiinëve thotë:

*"Kur t'i flisni një personi në lidhje me Sunetin dhe ai ju përgjigjet: «Lëri këto, na mjafton ne Kurani», ta dini se ka devijuar për vete dhe po çorienton edhe të tjerët.”<sup>4</sup>*

Edhe Imam Evzai, dijetari i gjeneratës së tabei tabiinëve, thotë: *"Suneti ka të drejtën e vendosjes së dispozitave në bazë të Kuranit"*.

Kurani Famëlatë është zbritur në zemrën e Krenarisë së Gjithësisë ﷺ. Në ajetin fisnik thuhet:

**"Nuk ka dyshim se ky (Kuran) është Shpallja e Zotit të botëve. Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë. E zbriti në gjuhën e qartë arabe."** (Shuara, 192-195)

Komentuesi i parë dhe më i saktë i Kuranit Famëllartë është vetë i Dërguari i Allahut. Në ajetin fisnik thuhet:

**"...Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kuranin), me qëllim që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë."** (Nahl, 44)

Kurani Kerim është komentuar me jetën 23 vjeçare profetike. Prandaj është e pamundur të kuptohet dhe të jetohej Kurani pa u bërë pjesë e botës së brendshme të Pejgamberit, pa u edukuar me moralin e tij, pa ndjekur traditën e tij.

Kështu, të gjitha detajet e adhurimeve bazë të Islamit, si: namazi, agjërimi, zeqati, dhe haxhi, janë përcaktuar në praktikën e vetë Pejgamberit ﷺ. Në Kuranin Fisnik nuk janë përcaktuar çështje të tilla, si:

4. Hakim, Ma'rifetu Ulumi'l-Hadith, fq. 65; Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi Ilmi'r-Rivaje, fq.16.

kohët e namazit, rekatet, shtyllat e namazit, apo gjërat që e prishin namazin; të gjithë këto çështje zënë vend në Sunetin e Pejgamberit ﷺ.

Në Kuran nuk përcaktohet si, sa dhe në çfarë kushtesh dhe në çfarë sasive do të jepet zekati. Të gjitha këto ne i kemi mësuar nga Pejgamberi ﷺ. Me të vërtetë, nuk mund të mësohet si të vihet në praktikë Kurani pa u njohur me Traditën Profetike.

Për shembull sipas Kuranit Fisnik është e ndaluar (haram) të hahet coftina. Por ne konsumojmë peshkun që ka ngordhur vetvetiu pas peshkimit. Ne mësojmë se sipas Traditës Profetike peshku përbën një përjashtim. Në Kuranin Fisnik urdhërohet për namazin e Xhumasë.

Por kur e si do falet, e mësojmë nga Tradita Profetike. Prandaj kuptohet që qëllimi i fshehtë i atyre që nënvlerësojnë Traditën Profetike, është heqja e dispozitave fetare. Nuk ka dyshim që sahabët e nderuar e shihnin Traditën Profetike si një burim bazik të fesë. Tregohet se në kohën e kalifatit të Osmanit ﷺ, një person shkon tek Imran ibn Husejni ﷺ, kadiu i Basrës, dhe i thotë: " Ju na tregoni disa hadithe, por ne nuk arrijmë ta gjejmë burimin e tyre në Kuran".

Imrani ﷺ shprehet: " - A ju tregohet në Kuran se për çdo 40 dirhem jepet 1 dirhem zekat, se për aq dele jepen kaq dele apo se për aq deve jepen kaq deve?"

Personi përgjigjet:

" -Jo."

Imrani ﷺ e pyet: " -Po nga i mësuat gjithë këto rregulla? I mësuat nga ne. Ndërsa ne i mësuam nga i Dërguari i Allahut». Dhe i përmend edhe shembuj të tillë të ngjashëm.<sup>5</sup>


5. Ebu Davud, Zekat, 2/1561;Ibni Eb' Asim, es-Sunne, II, 386.

Vetë i Dërguari i Allahut u ka paraprirë me këtë thënie personave që do të kishin tendencën e përjashtimit të hadithit dhe sunetit: *"A mendon ndonjëri prej jush, i krekosur në kolltukun e tij, që nuk ka gjëra të tjera të ndaluara përveç atyre që ka ndaluar Kurani? Ta dini se unë ju kam këshilluar, ju kam urdhëruar dhe shumë gjëra jua kam ndaluar. Këta janë sa Kurani madje edhe më shumë..."* (Ebu Davud, Haraxh, 31-33/3050.)

*"Ta dini se bashkë me Kurandin Fisnik më është dhënë edhe diçka e ngjashme me të. Kini kujdes; janë të afërta ditët kur një njeri me barkun plot, i krekosur në kolltukun e tij do të thotë:*

*«Ju kapuni vetëm pas këtij Kurani! Mjafton që të pranoni si të lejuar atë që ju lejon ky Libër e të pranoni të ndaluar atë që ju ndalon ai».*" (Ebu Davud, Sunnet, 5/4604; Ahmed, IV, 131.)

Këto hadithe janë të mrekullueshme...Sepse në të vërtetë kemi arritur në kohën për të cilën i Dërguari i Allahut ka bërë me dije se Tradita Profetike do të ketë tendencën të zhvlerësohet.

Duhet të përpiqemi ta mësojmë fenë tonë në mënyrën e duhur që të mund të shpëtojmë veten dhe pasardhësit tanë nga përçarjet e kohës. Lidhur me këtë çështje i Dërguari i Allahut i është shprehur Abdullah Ibn Omerit  kështu: *"O ibn-i Omer! Përqafoje fort fenë tënde, përqafoje fort fenë tënde! Sepse ajo është edhe mishi edhe gjaku yt. Ki kujdes nga kush e mëson fenë tënde! Shkencat dhe dispozitat fetare merri nga dijetarët e qëndrueshëm në fe, mos i merr nga ata që orvaten majtas djathtas nga interesat e kësaj bote!"*<sup>6</sup>

Nuk duhet të harrojmë që Tradita Profetike është një udhëzues unik për të kuptuar Kurandin. Prandaj dhe nuk duhet harruar kurrë se çdo kundërshtim ndaj Traditës Profetike është kundërshtim edhe ndaj Kuranit e për rrjedhojë edhe ndaj Krijuesit të Gjithësisë. Kështu Abdullah

6. Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi Ilmi'r-Rivaje, el-Medinetu'l-Munevvere, el-Mektebetu'l-Ilmijje, fq.121.

ibn Dejlemi, një nga dijetarët e medhenj të brezit të tabiinëve, thotë: *"Sipas asaj që më ka mbërritur mua, shkatërrimi i fesë do vijë si rezultat i largimit nga Tradita Profetike. Ashtu sikur litarit i hiqen fijet një nga një e në fund këputet, ashtu edhe feja do braktiset me largimin një nga një prej suneteve."* (Darimi, Mukaddime, 16/98.)

Prandaj dhe largimi një nga një prej suneteve nga jeta jonë e mban në fije të perit shpëtimin tonë në jetën e përtejme. I Dërguari i Allahut thotë: *"Po ju lë dy porosi: Kuranin dhe Traditën time"*. (Hakim, I, 171/318) Vëllëzër, të mos harrojmë së armiqësia ndaj Traditës Profetike është një skemë e qëllimshme.

Prandaj duhet t'i kushtojmë shumë rëndësi Traditës Profetike sepse objektivi i armiqve të sunetit është zbrazja e brendësisë së Islamit. Kështu në historinë e feve, devijimi i Jahudizmit dhe Krishtëritit ka filluar në të njëjtën mënyrë. Fillimisht u braktis tradita e pejpgambereve e më pas u devijua nga çështjet e besimit dhe adhurimit. Kemi shembullin e Abdulehad Davut Efendiut, i cili ka studiuar kopjet më të vjetra të literaturës së krishterë dhe letrat e Palit. U konvertua në Islam dhe mori emrin Abdulehad. Ai shprehet: "Shtrembërimi i krishtëritit filloi në këtë mënyrë:

- U hoq tradita profetike e në vend të saj erdhi pagëzimi,
- U hoq namazi e në vend të saj erdhi rituali,
- U hoq agjërimi e në vend të saj erdhi dieta".

Më pas u braktis mbulesa duke iu lënë si veçanti vetëm murgeshëve. Sot, kjo mbulesë ka filluar të hiqet edhe ndër murgesha. Kështu krishtërimi pushoi së qeni një fe hyjnore.

U shtrembërua, u dëmtua. Tashmë nuk është më një model jete, por një markë e një shenjë. Sot Dëshmitarët e Jehovait pothuajse po i japin fund dispozitave të Krishtëritit.

Në lidhje me këtë diskutim ka shumë shembuj. Në momentin që feja shqetëson egon e njerëzve, bëhet tabelë qitjeje. Për shembull në Greqinë e lashtë Sokrati tha: "Zoti është një". Sapo vendosi disa dispozita në lidhje me besimin monoteist, Konsulli i Athinës kundërshtoi dhe Sokrati u helmua. Sepse feja i kishte shqetësuar ata....

Me pak fjalë ka disa grupime shoqërore që shqetësohen nga Tradita Profetike. Qëllimi i tyre është zbrazja e fesë sikurse ndodhi në fenë e krishterë... I njëjti kurth po mundohet të ngrihet edhe ndaj fesë së vetme hyjnore, Islamit. Duke përjashtuar Traditën Profetike po kërkohet të prishet Islami ashtu sikurse edhe krishterimi. Është thelbësore të jemi jashtëzakonisht vigjilentë si besimtarë ndaj këtyre armiqve të fshehtë apo të dukshëm të fesë. Le të mos harrojmë se medh'hebet janë mbrojtësit e Traditës Profetike, e Tradita Profetike është mbrojtëse e Kuranit.

Prandaj:

Është domosdoshmëri ngritja dhe vijimësia e institucioneve ku mësohet feja me sinqeritet e përkushtim.

Është thelbësor edukimi i dijetarëve që kanë njohuri të thella dhe që mund të mbrojnë hadithin e shkencat e ngjashme.

## 11) Si duhet të jetë marrëdhënia jonë me librin e Allahut, Kuranin Famëlartë?

Lumturia e vërtetë, është të jetosh në Xhenetin e të vërtetave të Kuranit, sepse ai është një dritë që pastron botën e brendshme dhe të jashtme të individit, një libër që i jep zemrave mësim dhe këshilla, shërim për sëmundjet shoqërore dhe individuale, rruga më e sigurt që të çon drejt Allahut, ndriçues i errësirave, udhërrëfyes drejt të panjohurave të jetës dhe një fjalë hyjnore që siguron lumturinë dhe harmoninë e pafundme.

Për të përfituar prej këtyre mirësive të Kuranit, është e domosdoshme që ai të lexohet duke u ndjerë thellë në zemër dhe duke u frymëzuar prej tij. Kjo ndodhi shumë mësimdhënëse e transmetuar nga Ebu Hurejre رضي الله عنه, tregon qartë se Kurani Fisnik ka zbritur për t'u lexuar duke u kuptuar dhe për të punuar me të sipas udhëzimeve të tij:

Një herë, Profeti ﷺ, do të niste me mision një njësi të madhe ushtarake. Para se të niseshin, Profeti ﷺ, i urdhëroi të lexojnë Kuran; dhe secili lexoi aq sa kishte mësuar përmendësh. Më pas, Profeti ﷺ, shkoi pranë sahabiut që ishte më i riu në moshë dhe i tha:

- O ti filan! Çfarë di përmendësh? Ai tha:

- Unë di përmendësh filan sure dhe suren Bekare! – tha ai. Profeti ﷺ, e pyeti përsëri:

- E di përmendësh suren Bekare?

Kur i riu i tha:

“Po!”, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Shko, ti je komandanti i tyre, sepse kjo sure e përmbledh pothuajse të gjithë fenë.”

Njëri nga prijësit e xhematit tha:

- O i Dërguari i Allahut! Frika se nuk do të mund ta vë në jetë përmbajtjen e saj, më ka penguar ta mësoj atë sure!

Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

*“Mësojeni Kuranin, lexojeni, mësojuani të tjerëve dhe punoni me të, sepse ai që e mëson Kuranin, e lexon dhe punon me të, është si një çantë e mbushur me misk, aroma e të cilit shpërndahet në çdo anë. Kurse ai që e mëson Kuranin dhe fle (e lë shërbimin e Kuranit), është si një çantë e mbushur me misk, por që i është lidhur gryka.”* (Tirmidhi, Fedailu'l-Kur'an, 2/2876.)

Fjalët e Profetit ﷺ, në këtë ngjarje, tregojnë nivelin e edukimit që do të arrijë dikush që e lexon dhe e vë në jetë suren Bekare.

Synimi i përgjithshëm dhe i vetëm i Kuranit, është shpëtimi i zemrave nga angazhimi me dëshirat dhe lakmitë e padobishme, që i degradojnë në indiferencë mendjet dhe mendimet, orientimi i tyre (zemrave) drejt njohjes së Allahut dhe afrimit me Të. Prandaj, për ta arritur këtë synim, është e domosdoshme angazhimi i vazhdueshëm me Kuranin.

Çdo besimtar duhet ta kuptojë dhe ta zbatojë Kuranin në jetën e



tij të përditshme, gjë që është domosdoshmëri e besimit dhe kriteri i devotshmërisë. Për rrjedhojë, edhe sahabët fisnikë, kur i mësonin dhjetë ajete nga i Dërguari i Allahut ﷺ, nuk kalonin në mësimin e dhjetë ajeteve të tjera, pa i kuptuar dhe pa i zbatuar mirë dhjetë ajetet e para. Për shembull, Abdullah Ibn Omeri رضي الله عنه, ka rritur ta përvetësojë suren Bekare për tetë vjet.

Po ashtu, edhe Aliu رضي الله عنه, duke dashur të na tregojë mënyrën se si mund të përfitojmë nga Kurani Fisnik, na këshillon:

*“Mësojeni Librin e Allahut, sepse Libri i Allahut është fjala më e çmuar. Mundohuni të jeni të informuar në lidhje me Kuranin, sepse Kurani është pranvera e shpirtrave. Kërkoni shërim nga drita e Kuranit, sepse Kurani është shërim për sëmundjet e zemrës. Lexojeni bukur Kuranin, sepse Kurani është shprehja më e lartë. Kur lexohet Kuran afër jush, heshtni dhe dëgjojeni me vëmendje, në mënyrë që të mëshiroheni. Kur ju mësohet diçka nga Kurani, punoni me të në mënyrë që të udhëzoheni, sepse dijetari që nuk jeton në bazë të diturisë që ka, nuk ka ndryshim nga i padituri që ka devijuar për shkak të mosdijes së tij.”* (Ibn Kethir, Bidaje, 7/30)

Ndërsa Abdulkadir Gejlani shprehet:

*“O bir! Të punosh sipas Kuranit, të lartëson dhe të vendos në pozitën e Kuranit. Ndërsa, të punosh sipas sunnetit, të afron tek i Dërguari i Allahut ﷺ.”*

Po ashtu, edhe Muhjiddin Arabi, ka këshilluar kështu në lidhje me Kurani:

*“Duhet ta lexosh shumë Kuranin dhe të mendosh për kuptimin e tij. Gjatë leximit, bëj kujdes në cilësitë me të cilat Allahu Teala ka cilësuar robërit e Tij të dashur! Shih edhe ato vepra të këqija, të cilat Kurani i qorton dhe Allahu i ka cilësuar si të humbura; e ruaju prej tyre. Të gjitha këto, Allahu i ka zbritur dhe i ka përmendur në librin e Vet, vetëm që ti të punosh*

*me to dhe të bësh atë që kërkohet. Për këtë arsye, kur të lexohet Kurani, bëhu njësh me Kuranin, që të kuptosh brendësinë e tij!"*

*"Kur të lexosh Librin e Allahut, që është fjala më e bukur, medito mirë rreth gjykimeve dhe historive të tij! Kështu, Allahu do të të falë një botë-kuptim të thellë. Xhibrili e zbriti Kuranin në zemrën e Profetit ﷺ, me lejen e Allahut. Ndërsa Kurani i frymëzon zemrat e njerëzve të devotshëm që e lexojnë, sikur të jetë duke u zbritur rishtazi. Nëse ia mëson Kuranin edhe të tjerëve, bëhesh ndihmësi i Allahut."*

*"Duhet bërë shumë kujdes që ajetet e Allahut të mos lexohen me pavetëdije. Ato duhen lexuar me zemër të ndjeshme, duke u përpjekur të kuptohen e të zbatohen. Shumë hafiza dhe dijetarë nuk kanë përfituar gjë prej leximit të Kuranit për shkak se e kanë lexuar në mënyrë të pavetëdijshme."*

Ndërsa Ibrahim Desuki, fton pasuesit e Kuranit drejt moralit dhe maturisë për të përfituar plotësisht nga mirësia e Kuranit. Ja si shprehet ai:

*"Njeriu i cili dëshiron të lexojë Kuran, në fillim duhet të pastrojë gjuhën nga fjalët e këqija e të shëmtuara. Nuk duhet ta teprojë në asnjë çështje dhe duhet të qëndrojë i vendosur përballë gjërave të dyshimta dhe të ndaluara. Nëse nuk tregohet i kujdesshëm ndaj këtyre çështjeve, atëherë nuk është treguar i ndershëm ndaj Kuranit..."*

*"Biri im! Nëse dëshiron të kuptosh të fshehtat e Kuranit pastroje egon tënde dhe përpiku të përfitosh nga mirësia e Kuranit. Lëri fjalët e kota, merru me punë të dobishme! Vendose faqen në tokë (bëhu modest), mos harro se ke ardhur nga toka dhe përsëri tek ajo do të kthehesh. Frikësohu nga tërësia e mëkateve dhe përplasja me to Ditën e Kiametit. Llogarite mirë nëse veprat do të të pranohen apo jo. Nëse vepron kështu, atëherë do të mund të kuptosh mesazhet e fshehta të fjalës së Zotit tënd. Nëse nuk vepron kështu kjo derë hyjnore nuk hapet për ty."*

Nisur nga kjo, mund të themi se, ata që e lexojnë Kuranin pa shpirt, qoftë edhe me një zë të bukur, nuk mund të quhen pasues të Kuranit nëse nuk i kuptojnë urtësitë e tij dhe nuk punojnë me të. E në fakt, ajo që është thelbësore për myslimanët, është qëllimi, mendimi dhe përpjekja për t'u brumosur me Kuranin.

Në të njëjtën mënyrë, edhe ata besimtarë që duan të matin dashurinë që kanë ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ, duhet të shohin se sa kanë përvetësuar prej diturive të Kuranit dhe sa reflektohet ai në jetët e tyre.

## 12) Cilat janë synimet e historive që përmenden në Kuran?

Tregimet e Kuranit i referohen urtësisë së realizimit të disa qëllimeve thjesht fetare. Këto qëllime paraqesin një përmbajtje të gjerë, sepse qëllimet e tregimeve përfshijnë pothuajse të gjitha synimet kuranore. Në këtë kontekst ato përfshijnë qëllime si; vërtetimi i vahjit dhe profetësisë, vërtetimi i njëshmërisë së Allahut, uniteti i feve në themel, paralajmërimi, lajmi i gëzuar, vendet ku shfaqet fuqia hyjnore, e mira-e keqja, durimi-ankesa, mirënjohja-mosmirënjohja dhe shumë qëllime të tjera fetare dhe morale.

Lidhur me qëllimet më të rëndësishme dhe të qarta të këtyre historive mund të thuhet:

1. Vërtetimi dhe shpjegimi i parimeve të besimit.
2. Vërtetimi i vahjit dhe profetësisë.

Profeti ynë ﷺ, ishte analfabet. Ai nuk kishte mësuar të lexonte dhe të shkruante. Gjithashtu nuk është dëshmuar asnjëherë që ai të jetë ulur e të bisedojë me priftërinjtë hebrenj dhe të krishterë. Përkundrazi këtyre, atij iu shpallën histori në Kuran që i befasuan të krishterët dhe hebrenjtë. Sidomos disa çështje që u shpjeguan në një mënyrë

jashtëzakonisht të thellë dhe delikate, si historia e Ibrahimit, Jusufit, Musait dhe Isai ﷺ. Shpallja e këtyre në Kuran përbënte provën se ai ishte shpallje hyjnore. Kurani i përshkruan qartë këto synime në fillim ose në fund të disa tregimeve:

**“Ti (o Muhamed) nuk ke qenë i pranishëm në anën perëndimore (të Turit), kur Ne ia besuam Musait Misionin (Profecinë) dhe as nuk ke qenë dëshmitar i kësaj ngjarjeje. Pastaj, Ne krijuam brezni të tjera që jetuan shumë gjatë. Ti nuk ke banuar midis banorëve të Medjenit, që t’iu lexoje shpalljet Tona, por Ne gjithnjë kemi çuar të dërguar. Ti nuk ke qenë as pranë Turit, kur Ne thirrëm Musain. Por ti je dërguar si mëshirë nga Zoti yt për të paralajmëruar njerëzit, të cilëve nuk u kishte ardhur kurrfarë paralajmëruesi para teje, që ata të mund të marrin këshilla.”** (Kasas, 44-46.)

3. Për të shpjeguar se feja erdhi nga Allahu prej Ademit ﷺ, deri tek Profeti ynë ﷺ, se të gjithë besimtarët janë një ummet dhe se Allahu, i Cili është Një, është Zoti i të gjithëve.

4. Shpallja e mirësisë që Allahu u dha profetëve dhe robërve të Tij të zgjedhur.

5. Paralajmërimi i njerëzimit kundër armikut të tij të përjetshëm, shejtanit.

Allahu i Madhëruar thotë:

**“O njerëz! Ushqehuni me të gjitha ato gjëra të lejuara e të mira që gjenden në Tokë dhe mos ndiqni gjurmët e djallit, sepse ai është njëmend armiku juaj i hapur. Ai ju nxit vetëm në të këqija, në vepra të turpshme dhe të flisni për Allahun gjëra që nuk i dini.”** (Bekare, 168-169.)

6. Ngushëllimi dhe forcimi i zemrës së të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe të gjithë besimtarët, duke u bërë të ditur se në fund Allahu do ta ndihmojë profetin e Tij dhe do t’i shkatërrojë gënjeshtarët.

Kjo, nga ana tjetër, ka për qëllim të përforcojë Profetin tonë dhe të ndikojë në shpirtrat e atyre që ai i ftoi të besojnë.

#### 7. Të sigurojë edukimin dhe pastrimin gradual të njeriut.

Ka edhe shumë qëllime të tjera të këtyre historive. Dhe, ndër to, është e rëndësishme të bëhet e ditur se Allahu është i Plotfuqishëm për mrekulli të pafundme dhe unike dhe shpjegimi i tyre. Për shembull, krijimi i Ademit عليه السلام, nga hiçi dhe lindja e Isa عليه السلام, pa baba janë prej këtyre mrekullive.

Shkurtimisht, në saje të historive në Kuran, Allahu i Madhëruar i jep njerëzimit mësim të panumërta sublime, të hapura dhe të fshehta. Përveç kësaj, duke nxjerrë në pah nga një karakteristikë të ndryshme tek secili profet, Ai e vendos atë në trurin dhe të kuptuarit e njeriut. Gjegjësisht:

Kur shikojmë jetën e profetit Nuh عليه السلام, para së gjithash, në plan të parë dalin ftesa për besim, durimi, toleranca dhe në fund, një urrejtje e fortë për mosbesimin dhe mosbesimtarët.

**Jeta e Ibrahimit** عليه السلام, kaloi në një luftë të pamëshirshme kundër politeizmit, për shkatërrimin e idhujtarisë dhe ishte një shembull i jashtëzakonshëm për sa i përket dorëzimit, mbështetjes dhe besimit ndaj Zotit, në saje të të cilit zjarri i Nemrudit u shndërrua në një trëndafilishte.

**Jeta e Musait** عليه السلام, kaloi në luftë me faraonin mizor dhe pasuesit e tij, dhe me ligjin që solli më vonë, ai themeloi një rend shoqëror për besimtarët.

Karakteristika dalluese e mesazhit të **Isait** عليه السلام, është një zemër plot dhembshuri dhe mëshirë ndaj njerëzve. Ndër cilësitë e tij të shquara, na tërheqin vëmendjen gjendjet e larta si falja dhe modestia ndaj njerëzve.

Është për t'u admiruar edhe historia e Sulejmanit ﷺ, i cili, pa varësisht mbretërimit të tij legjendar, e ruajti gjendjen e tij shpirtërore të përlësisë dhe mirënjohjes dhe e lartësoi veten në robëri ndaj Allahut.

Në jetën e **Ejubit** ﷺ, gjejmë manifestime të larta të durimit ndaj provave dhe falënderimit ndaj Allahut në të gjitha rrethanat.

Jeta e **Junusit** ﷺ, është një shembull i përsosur i kthimit tek Allahu dhe i kapjes pas pendimit, duke shfaqur keqardhje për gabimin.

Edhe kur ishte në robëri, Profeti **Jusuf** ﷺ, përjetoi kulmin e përkushtimit ndaj Zotit. Ai tregoi një dëlirësi dhe ndershmëri të lartë edhe kur një grua e bukur me pasuri dhe famë i bëri një ofertë joshëse duke thënë "Eja tek unë". Zemra e tij, e cila ishte e stolitur me një takva të lartë, ishte burimi madhështor i përsosurive të sjelljes së tij.

Jeta e **Daudit** ﷺ, është plot me mësim për madhëstinë hyjnore. Orientimi dhe lidhja e tij me Allahun me frikë-respekt, në gjendje vajtimi dhe lutjeje, është shumë mësimdhënëse.

Po ashtu, edhe historia e **Jakubit** ﷺ, është një shembull i mrekullueshëm që na tregon se si nuk duhet të dëshpërohemi edhe kur bota na errësohet, por të lidhemi me Allahun me durim dhe të mos heqim dorë nga shpresa në mëshirën e Tij.

Jeta e **Profetit** ﷺ, nga ana tjetër, është aq sublime dhe e përsosur sa nuk përfundon me të treguar.

### 13) Çfarë rinie jetoi Resulullahu ﷺ?

I Dërguari i Allahut ﷺ, edhe në vitet e rinisë ka qëndruar larg të këqijave të Periudhës së Injorancës. Ai, edhe para se të ishte Profet, ishte njeriu më i ndershëm i shoqërisë nga aspekti i personalitetit dhe humanizmit. Po ashtu, edhe nga aspekti i edukatës ishte më i miri. Aq, sa për shkak se Allahu i kishte mbledhur tek ai të gjitha vetitë dhe virtytet më të bukura njerëzore, ai kishte merituar epitelin “**el-Emin**” (i besueshmi).<sup>7</sup> “**Emin**” tashmë ishte bërë emri i dytë i tij, madje kishte kaluar edhe emrin e vërtetë të tij.

Një ditë Resulullahu , u pyet:

“O Resulullah! A keni adhuruar ndonjëherë dikë tjetër përveç Allahut?”

“Jo!” -tha ai.

“A keni pirë ndonjëherë alkool?” -e pyetën përsëri.

“Jo! Edhe kur nuk e dija se ç’është imani dhe Kurani, e dija se ajo çfarë bënin ata ishte e ndaluar.” -tha. (Dijarbekri, I, 254 - 255.)

7. Ibn Hisham, I, 191; Ibn Sa’d, I, 121.



**Ummu Ejmen**, tregon:

Idhujtarët Kurejsh mblidheshin një herë në vit përreth idhullit Bu-vane dhe bënin ceremoni që zgjasnin deri në mbrëmje, duke prerë kurban, duke qethur flokët dhe duke bërë itikaf. Edhe Ebu Talibi ishte përgatitur për këtë festë. Por, kur Muhamedi ﷺ, ngurroi të merrte pjesë bashkë me ta, xhaxhallarët dhe hallat e tij u zemëruar shumë me të. Për këtë arsye, hallat i thanë:

“Kemi frikë mos të gjejë ndonjë e keqe për shkak se po ju kthen shpinën perëndive tona!” Madje, ato këmbëngulën aq shumë, saqë Muhamedi ﷺ, u detyrua të shkonte bashkë me ta.

Për një farë kohe humbi nga sytë, por më pas u kthye sërish pranë nesh me një fytyrë të zverdhur nga frika.

“Çfarë ndodhi?” - e pyetën me kureshtje hallat e tij.

“Kam frikë mos më kanë prekur xhinët” - tha ai.

“Allahu nuk të mundon me shejtanin! Tek ti gjendet çdo virtyt i bukur. Pa na thuaj, çfarë ndodhi me të vërtet?” - i thanë.

Atëherë Muhamedi ﷺ, u tha:

“Sa herë që i afrohesha idhu-llit, më shfaqej një burrë i gjatë, i veshur me të bardha dhe më thosh-te: «O Muhamed! Kthehu, mos e prek atë!»”

Pas kësaj, Muhamedi ﷺ, nuk mori më pjesë në festat dhe ceremonitë e tyre, megjithëse ende nuk i ishte dhënë detyra profetike. (Ibn Sa’d, I, 158.)

I Dërguari i Allahut, kaloi një rini mjaft të pastër dhe të ndershme. Allahu i Madhëruar e ruajti atë nga veprime të pahijshme dhe nga imoraliteti.

Kur po rindërtohej Qabeja, Profeti ﷺ, po mbante gurë me xhaxhain e tij, Abbasin ﷺ, i cili me qëllim që gurët të mos ia dëmtonin supin e tij të zbuluar, i tha Profetit:

“Vendose rrobën në sup!”

Ndërkohë që Profeti ﷺ, deshi të vendoste rrobën në sup, u rrëzua përtokë dhe duke i ngulur sytë nga qielli, i tha xhaxhait:

“Jepma rrobën!”

Më pas e mori menjëherë dhe u mbulua. (Buhari, Haxh, 42)

Në atë kohë, njerëzit nuk i kushtonin vëmendje veshjes. Veshjet jashtë etikës dhe moralit shiheshin natyrshëm. Megjithatë, i Dërguari i Allahut r, nuk është vënë re të ketë veshur ndonjëherë rroba të përshtatshme.

I Dërguari i Allahut, ka thënë:

“Dy herë kam tentuar të bëj një zakon të njerëzve të Periudhës së Injorancës. Mirëpo, Allahu i Madhëruar më ruajti nga kjo.

Një natë, po kullosnim kopetë e deleve me disa të rinj Kurejsh në pjesën e sipërme të Mekës. Shokut tim i thashë:

«Nëse kujdesesh për kopetë time, do shkoj të marr pjesë në muhabetet e natës të të rinjve mekas.»

«Dakord, bëj si të duash!» - më tha.

Pas kësaj, u nisa dhe kur iu afrova Mekës, fillova të dëgjoja zëra të defit, kavallit dhe të fishkëllimave.

«Ç’është kjo?» - pyeta.

«Filan burrë po martohet me filan grua.» - më thanë.

Menjëherë u ula dhe nisa të shikoj nga ajo anë. Ndërkohë, Allahu i Madhëruar më dha një rëndesë në veshët e mi dhe aty më zuri gjumi. Beto hem në Allah nuk u zgjova derisa lindi Dielli. Pastaj u ktheva dhe shkova menjëherë tek shoku im.

«Çfarë bëre?» -më pyeti.

«Nuk bëra dot asgjë!» - i thashë dhe i tregova ç'më ngjau.

Një natë tjetër, u përsërit e njëjta gjë dhe unë sërish mbeta në gjumë... Derisa Allahu më nderoi me profetësi, përveç këtyre rasteve nuk kam tentuar më për ndonjë punë të keqe!" (Ibni Is'hak, fq. 58 - 59; Ibni Kethir, el-Bidaje, II, 292.)

Profeti ﷺ, sillej me kujdes dhe edukatë ndaj familjes së vet, të afërmve dhe njerëzve të tjerë. Gjithmonë vepronte me mençuri dhe zgjuarsi.

Kur ishte i ri, Resulullahut ﷺ, i pëlqente të medi-tonte thellë mbi gjithësinë dhe ngjarjet e ndryshme. Prandaj, ai qëndronte i vetëm dhe thellohej në men-dime.

Shkurtimisht, Profeti ﷺ, e ka jetuar mirë rininë e tij dhe këtë etapë të vyer e ka kaluar me punë të mira dhe të mbara.

#### 14) A është e mundur që një njeri të jetë model për të gjitha shtresat shoqërore? Si është realizuar personaliteti shembullor i Pejgamberit ﷺ?

Profeti ynë Muhamedi ﷺ, është njeriu i vetëm në histori, të cilit i është studiuar çdo imtësi dhe detaj i gjithë jetës. Prej sjelljeve të përsosura nga vargu i profetëve të cilat mund të shërbejnë për orientim të njerëzimit drejt Zotit të Vërtetë dhe që janë të dobishme deri në ditët tona, kanë mbërritur vetëm disa rrëfime të caktuara. Kurse, veprat, fjalët dhe bota emocionale të cilën e ka manifestuar Zotëriu ynë Profeti i kohës së fundit ﷺ janë ndjekur pikë për pikë dhe janë shënuar si një tabelë nderi. Për më tepër, që të gjitha këto fjalë, vepra dhe detaje që kanë të bëjnë me Profetin tonë ﷺ kanë rastin dhe nderin që të mbarten deri te njeriu i fundit, deri në Kiamet.

Që të mbrojmë veten nga shpifjet që sjellin sprovat, sfidat dhe surprizat e ndryshme në jetë është e nevojshme që të vëmë në praktikë në formën më të bukur virtytet e larta morale, si: mirënjohjen, durimin karshi sprovave, qëndrueshmërinë, trimërinë, flijueshmërinë, kënaqësinë, pasurinë shpirtërore, altruizmin, bujarinë, modestinë, të mos prishim baraspeshën përballë ndodhive.

Zoti i Vërtetë zgjodhi për të gjithë njerëzimin Pejgamberin ﷺ, për të qenë shëmbëlltyrë me jetën e tij të pastër, modeste dhe bujare, mësues i përsosur.

Jeta e të Dërguarit të Allahut ﷺ do të jetë shembull për të gjithë brezat deri në Kiamet. Ja ç'thotë Kur'ani Fisnik për Të:

**“(O i Dërguar!) Ti padyshim do të kesh shpërblim të pa ndërprerë! Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!”** (Kalem, 3-4).

Tiparet dhe personaliteti i bekuar i të Dërguarit të Allahut ﷺ, madje edhe vetëm me manifestimet të cilat mund t'i kuptojë logjika e njeriut, paraqesin majën e tërësisë së sjelljeve njerëzore. Ai është Profet Kulmor dhe personalitet shembullor i cili plotësoi detyrën e thirrësit në rrugë të drejtë, duke qenë personalisht shembull konkret. Allahu i Lartëmadhëruar e prezanton në Kur'an atë qenie të bekuar para gjithë njerëzimit me epitetin **“usvei hasene”**, shembulli më i përkryer, sikurse thuhet në këtë ajet kuranor:

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ  
لِّمَن كَانَ يَرْجُوا اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا

**“Ju keni shembullin më të përkryer në të dërguarin e Allahut, kuptohet, për atë që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër dhe e përmend Allahu shpesh”** (Ahzab, 21)

Muhamedi ﷺ në çdo sferë të jetës ka manifestuar një bukuri dhe përsosmëri të pashoqe. Ai posedonte të gjitha bukuritë në shpirt dhe në sjellje. Si rrjedhojë, çdo njeri mund të gjejë në jetën e ndershme dhe synetin, traditën e Profetit ﷺ, sjelljet më të bukura dhe më të përsosura të cilat mund t'i shërbejnë si shembull.

Ai është shembull si prijës fetar, është shembull si kryetar shteti, është shembull për ata që hyjnë në lidhjen e dashurisë hyjnore, është shembull me ndjenjën e falënderimit dhe modestisë kur zhytej në dhuntitë e Zotit.

Është shembull me durimin dhe nënshtrimin e tij në kohë dhe rrethana të vështira.

Është shembull butësie dhe dhembshurie ndaj anëtarëve të familjes.

Është shembull me mëshirën e tij ndaj të dobëtëve, të vetmuarve, robërve e skllëvërve, është shembull me faljen dhe mirëkuptimin ndaj mëkatarëve dhe gabimtarëve.

*Nëse ti je një njeri i pasur, mendo për thjeshtësinë dhe bujarinë e atij Profeti të lartë që sundoi mbi tërë Gadishullin Arabik, që i bëri për vete të gjithë njerëzit e mëdhenj të kombit arab?*

*Nëse ti je njeri prej të dobëtëve, merr shembull prej jetës së Profetit ﷺ që ka jetuar në Meke nën regjimin e padrejtë dhe mizor të politeistëve!*

*Nëse ti je fitimtar, merr shembull nga jeta e Profetit ﷺ të guximit dhe nënshtrimit që doli fitues mbi armiqtë në Bedër dhe Hunejn!*

*Dhe, nëse, Zoti mos e dhëntë, pëson humbje, edhe atëherë kujto Profetin ﷺ e dorëzuar Zotit që përcillej me durim dhe trimëri mes shokëve të rënë dëshmorë apo të shtrirë gjithë plagë në sheshin e luftës së Uhudit!*

*Nëse ti je mësues, mendo për Profetin ﷺ që u mësonte shokëve të sofrës, urdhrat hyjnorë duke u përcjellë atyre frymëzimin e zemrës së vet të hollë e të ndjeshme!*

*Nëse ti je nxënës, përfytyro Profetin ﷺ që rri para Xhebrailit që i ka sjellë shpalljen!*

*Nëse ti je predikues që jep këshilla ose një prijës i besueshëm, dëgjo Profetin ﷺ që u shpërndan urtësi shokëve të vet brenda Xhamisë Profetike dhe vërja veshin e jepja zemrën zërit të Tij të ëmbël.*

*Nëse kërkon ta mbrosh të vërtetën, ta kumtosh atë, ta kapësh e ta ngresh në këmbë dhe, për ta bërë këtë, nuk të ndodhet ndonjë ndihmës, shih e mëso nga jeta e Profetit ﷺ, kur ndodhej në Mekë pa asnjë lloj ndihme, ua shpalli mizorëve të vet të vërtetën dhe i ftoi në rrugë të drejtë!*

*Nëse ti je një fitimtar që e ke thyer armikun, nëse e ke thyer inatin e kundërshtarit duke dalë epror mbi të, nëse e ke shkatërruar gënjeshtrën dhe e ke shpallur të vërtetën, mbaje të gjallë para syve Profetin ﷺ i cili, ditën e fitores së Mekës, megjithëse ishte një komandant fitimtar, hynte aty me ndjenjë falënderimi, me një thjeshtësi të madhe, i përkulur mbi deve sikur po përkulej në sexhde!*

*Nëse je pronar çifligu dhe kërkon t'i vësh në rrugë të mbarë punët e atyshme, merr si shembull Profetin ﷺ i cili, pasi u bë pronar i tokave Beni Nadër, Hajber dhe Fedek, vuri në krye të punëve njerëzit që do t'i përmirësonin ato dhe do t'i administronin në rrugë të mirë!*

*Nëse je njeri pa njeri, mendo për jetimin e vogël të Allahut dhe Amines!*

*Nëse je një i rritur, shih me kujdes kah jeta e të riut kandidat për profet që punon si çoban i kopesë së axhës Ebu Talib!*

*Nëse je një tregtar që merr rrugën me karvane, kupto situatën e personit më të urtë të karvanit që shkon në Siri dhe në Jemen!*

*Nëse je gjykatës, mendo zgjidhjen e tij të zgjuar e të drejtë për të vendosur Gurin e zi në Qabe ndërsa fiset mekase janë gati t'ia këpusin kokën njëri-tjetrit për këtë gjë!*

*Dhe, duke i kthyer sytë sërish nga historia, shih Profetin ﷺ i cili në Medine, në Faltoren Profetike rri duke i trajtuar para vetes si të barabartë të varfrin e të pasurin, vendos mes njerëzve në formën më të drejtë!*

*Nëse je një bashkëshort, shih me kujdes karakterin e pastër të atij personi të bekuar, bashkëshorti i Hatixhesë dhe Aishesë, botën ndijore të thellë dhe dhembshurinë e tij, trajtimin me drejtësi të të gjitha bashkëshorteve!*

*Nëse je prind, shih mënyrën e sjelljes së tij ndaj vajzës Fatime e ndaj nipërve Hasan dhe Husejn!...*

*Kushdo që të jesh në cilado kushte që të ndodhesh, mëngjes e mbrëmje, në çdo çast ke për të gjetur Muhamedin ﷺ, si prijësin më të mirë dhe udhërrëfyesin më të drejtë!*

*Ai është një prijës i tillë, me anë të syneteve, të të cilit mund të rregullosh çdo gabim, të vësh në udhë punët që nuk janë rregulluar, të ringjallësh shpresën. Në sajë të dritës dhe udhëzimit të tij mund të shpëtosh nga pengesat e të arrish lumturinë!*

*Me të vërtetë, figura e tij i ngjan një tufë lulësh të rralla e delikate, një tufë trëndafilash erëmirë!*

*Si kur se shihet jeta e Profetit ﷺ është shembulli më i përkryer edhe për ata që gjenden në pika polarisht të kundërta në shoqëri. Për shembull, jeta e një të burgosuri nuk është shembull për gjykatësin, as jeta e gjykatësit për të burgosurin.*

*Po ashtu edhe gjendja e një të varfri i cili tërë jetën kalon duke luftuar me varfërinë në kërkim të ekzistencës, nuk mund të jetë shembull për të pasurin i cili noton në begati. Kurse jeta e Profetit të Allahut ﷺ paraqet shëmbëlltyrë për të dy palët.*

*Zaten, Zoti i Vërtetë atë e barti duke nisur nga pozita më e ulët në shoqëri, sa i përket fuqisë, të qenit bonjak dhe duke e kaluar nëpër të*



gjithë pozitat e jetës e ngriti në pozitë më të lartë, shikuar nga aspekti i fuqisë dhe autoritetit, në pozitën e Profetit dhe prijësit shtetëror. Zotëriu ynë Muhamedi ﷺ në të gjitha manifestimet lavdëruese dhe ndëshkuese ekspozon shumë sjellje shembullore për situata të ndryshme të jetës së njeriut, qofshin ato të lavdëruara apo të përcmuara.

Për këtë shkak themi se jeta e Tij, u ofron që të gjithë njerëzve, pa dallim pozite dhe rrethane, shembull praktik konkret dhe të përkryer, që do të mund ta ndiqnin sipas pozitave dhe mundësive të tyre për të realizuar atë model.

## 15) Cila është rëndësia që ka bërja e slavateve për Profetin tonë ﷺ? Sa i kujdesshëm duhet të jetë një mysliman në këtë çështje?

Zoti i Vërtetë, në Kur'anin Fisnik betohet në jetën e Profetit ﷺ. Përmend emrin e lartë të Tij së bashku me emrin e Vet dhe e ka bërë kusht për të qenë rob besimtarë, besimin në profetësinë e Tij. Ka shprehur pakënaqësinë për ngritjen e zërit në prezencë të Tij dhe për përmendjen e emrit të Tij si ndonjë emër të rëndomtë. Dhe, për më tepër, duke treguar se Allahu dhe engjëjt e përshëndesin atë me shumë urata, ka këshilluar e kushtëzuar besimtarët që ta përshëndesin shpesh me salate dhe selame.

Ashtu siç kuptohet edhe nga ajeti i 56-të i sures el-Ahzab, në të cilin thuhet:

***“Me të vërtetë Allahu dhe engjëjt e Tij i dërgojnë urata Profetit. O ju besimtarë madhëroni atë duke i dërguar urata dhe përshëndetje”,*** për besimtarët është një urdhër hyjnor që të përshëndesin Atë me salate dhe selame.

*Njëri ndër as-habët e dalluar të Profetit, sahabiu Ubej bin Kab* ﷺ

rrëfen e thotë:

*"Pasi kaloi një e treta e natës, i Dërguari i Allahut ﷺ u zgjua dhe tha:*

*'O njerëz! Përmendeni dhe përkujtojeni (bëni dhikër) Allahun. Përmendeni dhe përkujtojeni Allahun! Do të fryje suri i parë, i cili do të dridh botën. Më pas do të pasojë i dyti. Vdekja do të vijë me të gjitha vështirësitë. Vdekja do të vijë me të gjitha vështirësitë.'*

Atëherë unë e pyeta Pejgamberin:

*"O i Dërguar i Allahut! Unë përsëris shpesh salavatet e ndershme për ju, a thua se sa duhet ta bëj këtë gjatë ditës?"*

Profeti më tha:

*"Përsërit sa të duash."*

Unë përsëri e pyeta:

*"A thua mjafton që një të katërtën e lutjeve t'ua kushtojmë salavateve?"*

Profeti m'u përgjigj:

*"Sa të duash kushtoua salavateve. Por, sikur të bësh më tepër, për ty është më mirë."*

Atëherë i thash:

*"Do t'ua kushtoj gjysmën e lutjeve salavateve."*

Kurse Ai më tha:

*"Sa të duash kushtoua salavateve. Por sikur të bësh edhe më tepër, për ty do të jetë edhe më mirë."*

Unë përsëri e pyeta:

"Atëherë a mjafton që dy të tretën e kohës së ndarë për lutje t'ua kushtoj salavateve."

Ai më tha:

*"Sa të duash, por sikur të shtosh do të jetë më mirë për ty."*

Unë përsëri e pyeta:

*"E çfarë mendoni sikur t'ua kushtoj salavateve gjithë kohën të cilën e ndaj për lutje."*

M'u përgjigj:

*"Atëherë Allahu i Madhëruar do t'i largojë të gjitha brengat dhe do t'i falë të gjitha mëkatet."* (Tirmidhi, Kijame, 23/2457)

Ja ky është preteksti pse ashikët e Profetit i bëjnë shprehi dhe ushqim shpirtëror salavatet dhe selamet. Salavatet dhe selamet ndikojnë që në zemër të besimtarit të shtohet dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut.

Pa mëdyshje, për të ndjekur denjesisht dhe për të përfituar nga shëmbëlltira më e bukur e Tij, është kusht që të kuptohet realiteti kur'anor dhe Syneti. Kurse kjo do të jetë e mundur me afrim ndaj moralit shembullor dhe thellësive të Muhamedit ﷺ.

Asnjë njeri nuk arriti që të përshkruajë virtytin e vërtetë të Tij. Nuk mundi të kuptojë denjesisht moralin dhe natyrën e Tij. Dijetarët, të urtët, mbretërit e zemrave dhe Xhebraili e konsideruan nderë ndjekjen e rrugës së Tij, pritjen në derën e Tij e llogaritën respekt.

Nga ana tjetër, sipas edukatës islame, lutjet fillojnë e mbarojnë me falënderime e madhërimë për Allahun dhe salavate për të Dërguarin

e Allahut. Ekziston një mendim dhe qëndrim se Allahu nuk refuzon salavatet të cilat, në të njëjtën kohë, janë edhe lutje. Prej këtu buron realiteti që lutjet tona t'i stolisim, në fillim dhe në fund, me salavate. Domethënë të fusim lutjen tonë ndërmjet dy lutjeve dhe të shpresojmë për pranimin e tyre.

Në këtë kontekst Omeri رضي الله عنه thotë:

“Lutja rri varur mes tokës e qiellit. Nuk ngrihet deri tek Allahu derisa nuk themi salavate për të Dërguarin e Allahut.” (Tirmidhi, Vitri, 21/486)

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم një ditë prej ditësh pa një njeri i cili i lutej Allahut pas namazit, pa falënderuar dhe pa thënë salavate për të Dërguarin e Allahut, dhe tha:

*“Ky njeri shpejton.”*

Më pas e ftoi këtë person dhe e këshilloi duke i thënë:

*“Kur dikush nga ju do t'i lutet Allahut, fillimisht le të falënderoj dhe madhërojë Allahun, më pas le të çoj salate dhe selame për të Dërguarin e Allahut. E më pas le të lutet çka të dojë.”* (Tirmidhi, Deavat, 64/3477)

Ibën Abbasi përcjell një hadith në të cilin theksohet rëndësia e ndërmjetësimit të Profetit të Allahut në lutje, ku thuhet:

Zhvillohej luftë ndërmjet hebrenjve të Hajberit dhe fisit Gatafan, hebrenjtë hajberas pësonin disfatë në çdo ballafaqim. Në fund iu lutën Allahut në këtë mënyrë:

“O Zot! Të lutemi, që për hir të profetit të umetit të kohës së fundit, për të cilin ke premtuar Ti se do të vijë, na ndihmo neve që të jemi ngadhënjyes”, dhe me të vërtetë hajberasit në këtë luftë ngadhënjyen kundër fisit Gatafanë. Por, më pas, ata refuzuan profecinë dhe librin të cilin e solli Muhamedi صلى الله عليه وسلم, për hir të të cilit Allahu u kishte ndihmuar në ballafaqim me armikun e tyre. Për këtë shkak Allahu i Lartë zbriti

këtë ajet kuranor:

**“E kur u erdhi atyre prej Allahut libri (*Kur’ani*) që është vërtetues i atij, që e kishin pranë, e që para se t’iu vinte e kërkonin ndihmën e tij kundër mosbesimtarëve, e mohuan atë (*Muhamedin*) që e njihnin, kur u erdhi. Pra mallkimi i Allahut qoftë kundër mosbesimtarëve!”**

(Bekare, 89) (Kurtubi, II, 27; Vakidi, f. 31)

Siç kuptohet, madje edhe jomyslimanët të cilët i luten Allahut për hir të Profetit ﷺ shfrytëzojnë mëshirën dhe begatinë që solli Ai për gjithë botët.

Allahu i Lartë në Kur’anin Fisnik, duke iu drejtuar të Dërguarit të Allahut thotë:

**“Po, Allahu nuk do t’i dënojë ata, derisa ti (Muhamed) je në mesin e tyre dhe Allahu nuk do t’i dënojë, derisa ata kërkojnë falje (bëjnë istigfarë).”** (Enfal, 33)

Ky lajmërim hyjnor ka ardhur për politeistët. Ja, nëse, edhe politeistët fitojnë privilegje të këtilla vetëm e vetëm pse gjendeshin në afërsi materiale me Atë, janë të pakapshme dhe të paarritshme për arsyen njerëzore begatitë hyjnore që do t’i arrijnë besimtarët. Dhe nëse besimtarët nuk mjaftohen vetëm me besimin në atë qenie të bekuar, por marrin pjesë edhe nga dashuria profetike prej të Dërguarit të Allahut për të formuar esencën e besimit në fjalë...Ja, këtu, fjala ngel e mangët!...Me të vërtetë, çfarë grade do të arrijë zemra e njeriut në dashurinë për të Dërguarin e Allahut, prehja dhe lumturia shpirtërore që do të arrijë në këtë botë dhe pozita që do të meritoj në ahiret, do të jenë të atij niveli.

Për këtë arsye, kujdes, mos harro t’i çosh shpirtit të Tij të ndershëm salavate dhe selame! Ngaqë je nevojtar për ndërmjetësimin e Tij në ditën më të tmerrshme!...

## 16) Çfarë mund të na thoni në lidhje me modestinë e Pejgamberit ﷺ?

Burimi i krenarisë është lavdërimi dhe miratimi nga të tjerët. Kjo gjendje është njëra prej shenjave të njerëzve të përkëdhelur. Megjithëse që njeriu më i nderuar dhe i merituari i lavdërimit të Allahut, Profeti ﷺ u thoshte shokëve:

*"Për mua thoni: "Eshtë robi dhe i dërguari i Allahut!"* (Buhari, Enbija, 48)

Duke e vënë në mënyrë të posaçme dhe me këmbëngulje fjalën **"abduhu"** (robi i Tij, i Allahut) në fillim të fjalisë që vërtetonte profetësinë e vet, Profeti kërkonte të siguronte që bashkësia e tij të mos binte në perversitetin e bashkësive të së kaluarës që i hyjnizonin njerëzit!

Gjithashtu lidhur me këtë çështje, ai thoshte:

*"Mos më ngrini lart mua mbi gradën që e meritoj, sepse Allahu i Lartë më pati bërë rob para se të më bënte të dërguar!"* (Hejthemi, IX, 21)

Me të vërtetë, ata njerëz që i karakterizonin pa u lëkundur **Krish-nën** dhe **Budën** si Zot dhe Isain, si bir të Zotit, si dhe që i pranonin pa u mërzhitur aspak Faraonin dhe Nemrudin si Zot, ata njerëz të mjerë që u faleshin, madje, kafshëve apo zjarrit, forcave të natyrës si uji apo

ajri, një njeri të tillë të jashtëzakonshëm e pranonin me gjithë dëshirë për Zot!

Kurse ai e shpallte veten kështu:

**“Edhe unë jam njeri si ju... Mua vetëm më zbulohet...”** (Kehf: 110)

I Dërguari i Allahut ﷺ e pohonte vazhdimisht dobësinë e tij. Kështu, një ditë pati thënë:

*“Askush (përfshi edhe mua) nuk mund të hyjë në xhennet në sajë të adhurimeve...!”*

Ata që e dëgjuan, e pyetën me habi:

*“A edhe ti, o i Dërguar i Allahut?”*

Ai iu përgjigj:

*“Po, edhe unë! Vetëm nëse më vjen në ndihmë favori hyjnor i Zotit tim!.. (Buhari, Rikak, 18; Muslim, Munafikun, 71-72)*

Me fjalë të tjera, Profeti u thoshte: “Pa më mbështjellë virtyti, mëshira dhe falja e Allahut të Lartë, as unë nuk mundem të hyj në xhennet! Adhurimi që kam bërë s’më shpëton dot as mua!”

Kjo tërheqje vëmendjeje është tregues jashtëzakonisht domethënës i vetëdijes së nënshtrimit dhe adhurimit, i thjeshtësisë, ndershmërisë dhe besnikërisë ndaj Zotit.

Ebu Usame ؓ tregon:

“Fjalët e të Dërguarit të Allahut ﷺ qenë Kur’an. Bënte shumë ziqër, hutbet i mbante të shkurtra, namazin e falte gjatë. Për t’i kryer punë një të varfëri, një të mjeri, nuk druhej të ecte së bashku me të gjersa t’i kryhej puna dhe nuk mbahej më të madh (përkundrazi, ndjente kënaqësi prej kësaj).” (Hejthemi, IX, 20. Veçanërisht, shih Nesai, Xhuma, 31)



Enesi رضي الله عنه thotë:

“I Dërguari i Allahut ﷺ i vizitonte të sëmurët, merrte pjesë në ngushëllime e varrime, shkonte te sklevërit kur e ftonin, hipte në gomar. Ditën e fitores së Hajberit dhe të marshimit mbi Beni Kurejdhat, pati hipur në një gomar me samar dhe mbulesë të bëra prej fijesh druri të hurmës.” (Tirmidhi, Xhenaiz, 32/1017; Hakim, II, 506/3734)

I Dërguari i Allahut ﷺ ulej mes sahabeve. Për këtë shkak, kur vinte ndonjë i huaj, nuk mund ta njihte Profetin pa pyetur. (Nesai, Iman, 6)

Në kohë të ndryshme, kur e kanë pyetur Aishen رضي الله عنها se me ç’merrej Profeti në shtëpi, ajo ka dhënë këto përgjigje:

“I Dërguari i Allahut ﷺ merrej me punët e shtëpisë, kurse kur dëgjonte ezanin, dilte menjëherë për në namaz!” (Buhari, Nafakat, 8)

“Edhe i Dërguari i Allahut ﷺ ishte njeri. Ai i qepte vetë rrobat e veta, milte dhentë, kryente punët vetiake.” (Ahmed, VI, 256)

“Ai i qepte dhe i arnonte vetë rrobat e veta, i meremetonte këpucët dhe bënte po ato punë që bënin njerëzit e tjerë në shtëpitë e veta!” (Ahmed, VI, 121, 106)

Me sjelljen e sinqertë e të thjeshtë si dhe me modestinë e tij, Profeti ﷺ pati përfaqësuar trajtën më të përshtatshme të natyrës së lartë krijimore të posaçme për njeriun. Qëndrimet dhe sjelljet e tij shfaqeshin jo si situata artificiale, të shtira, të rastit, por si tipare të jashtëzakonshme në thellësi të shpirtit të tij të lartë.

Adij bin Hatim tregon:

“Ende s’isha bërë musliman. I shkova për vizitë të Dërguarit të Allahut ﷺ. Më ftoi në shtëpi. Në rrugë e ndaloi një grua e moshuar dhe e dobët. I Dërguari i Allahut ﷺ priti për një kohë të gjatë në këmbë gjersa gruaja e mbaroi fjalën. Unë thashë me vete:

“Vallahi, ky s’është sundimtar!”

Pastaj shkuam te shtëpia e tij. Mori një jastëk lëkure të mbushur me fije druri dhe ma zgjati mua duke më thënë:

“Urdhëro, ulu!”

“Jo, ulu ti!” – I thashë dhe, sadoqë këmbëngula, ai vazhdoi të më thotë:

“Ti ulu!”

Atëherë, për të mos ia kundërshtuar fjalën, u ula. Ai vetë u ul për-tokë. Unë përsëri mendova me vete:

“Vallahi, kjo s’është punë që mund ta bëjë një sundimtar!”

Pastaj filluam të bisedojmë. Profeti ﷺ më tha se i përkisja doktrinës rekusi, se merrja një të katërtën e zeqatit të mbledhur dhe se, sipas doktrinës sime, ky veprim ishte haram (i ndaluar, i pabekuar). Unë mbeta i çuditur. Dhe pikërisht atëherë e kuptova mirë se ai ishte profet. Sepse njihite të gjitha gjërat që i preokuponin njerëzit.<sup>8</sup>

Të gjitha këto ndodhi parashtrojnë me tërë qartësinë e saj, natyrën e lartë të Profetit ﷺ.

Amr bin Rebia رضي الله عنه tregon:

Ndërsa po e bënte Qaben tavaf, Profetit ﷺ iu këput lidhësja e këpucës. Një person e nxori menjëherë lidhësen e këpucës së vet dhe ia lidhi këpucës së Profetit. Atëherë, i Dërguari i Allahut ﷺ e nxori lidhësen dhe tha kështu:

*“Kjo është përpjekje e personit i cili, duke parapëlqyer veten, kërkon të duket mbi shokët. Parapëlqimi i vetes mua s’më pëlqen!”* (Hejthemi, III, 244; IX, 21)

---

8. **Rekusi:** Botëkuptim fetar i përzjerë sebaist dhe krishter

I Dërguari i Allahut i cili parashtroi rrugën e drejtë dhe u falte njerëzve një lumturi të pafundme, nuk priste për këtë ndonjë shpërblym material të kësaj bote dhe, në këtë drejtim, tregoi shumë indiferent.

## 17) Cili është qëllimi i krijimit të njeriut?

Qëllimin e krijimit të njeriut mund ta përblehim në tre pika kryesore:

Shkaku kryesor i krijimit të njeriut, është adhurimi dhe njohja e Zotit. Në Kuran, urdhërohet:

**“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”**

(Dharijat, 56)

“Adhurimi”, i cili në këtë ajet përmendet si shkaku i krijimit, është një gradë dhe pozitë shumë e lartë, e cila shfaqet në “shprehjen e shehadetit”. Siç dihet, Profeti ynë në këtë shprehje, në fillim pranohet si “rob”, pastaj si i Dërguari i Tij. Kjo, tregon se adhurimi është parësor. Ndërsa profecia është brenda kuadrit të adhurimit të Zotit.

Profeti ﷺ, atyre që kanë treguar madhërim dhe respekt të tepruar ndaj tij, u ka thënë: *“Mos më ngrini mbi pozitën që më takon, sepse Allahu i Madhëruar, para se të më bënte profet, më ka bërë rob të Tij.”* (Hejthemî, Mexhmeu’z-Zeuaid, IX, 21.)

Në një ajet tjetër, Allahu i Madhëruar, urdhëron:

**“Thuaj: “Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...”** (Furkan, 77)

### **a. Njohja**

Një kuptim tjetër i shprehjes “adhurim”, është “marifetullah”, pra, njohja e Allahut të Madhëruar. Krijimi i njeriut, është i lidhur me qëllimin “e realizimit të adhurimit” dhe “njohjen e Allahut”.

Një kuptim i fjalës “abd” është njohje. Imam Maturidiu i ka konsideruar të domosdoshëm këto dy elementë për besimin.

Krijimi i njeriut është i orientuar nga qëllimi për ta njohur Zotin dhe adhuruar Atë. Kjo e vërtetë e lidhur me krijimin tonë, e shprehur në formën ...” për të më adhuruar Mua’ si në ajetin e mësipërm, nga disa komentues të Kur’anit është kuptuar si “ njohje E Allahut, arritje e njohjes intuitave të Zotit duke e ndjerë atë në zemër. (Shif Ibn Kethir, Tefsir, IX, 255)

### **b. Dashuria**

Allahu thotë në Kuran:

**“Dashuria e atyre që e besuan Allahun është shumë më e fortë se çdo dashuri tjetër...”** (Bekare, 165)

Prandaj një nga qëllimet kryesore të krijimit tonë është dashuria. Allahu na ka krijuar dhe na ka dhënë mirësi pafund nga dashuria që ka për njeriun. Njeriu nga ana e tij duhet të ushqejë dashuri pafund për Allahun. Në të kundërt nëse ne i kthejmë shpinën dashurisë së Allahut atëherë na pret një dënim i madh.

Allahu thotë në Kuran:

**“O ju që besuat! Kush prej jush largohet nga feja e tij, atëherë Allahu do ta sjellë një popull që Ai i do ata dhe ata e duan Atë.** (Maide, 54)

Në një ajet tjerët shprehet se shkak i shkatërrimit të individit dhe shoqërive të ndryshme ka qenë ndërprerja e dashurisë.

**Thuaj: «Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni deri sa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.»**

(Teube, 24.)

Shijimi i besimit është lumturia më e madhe. Arritja e këtij shijimi ka disa kushte dhe tregues. I Dërguari i Allahut, i ka përmbledhur në këtë formë:

Ka tri cilësi. Kushdo që i zotëron ato, e arrin ëmbëlsinë e besimit: Të duash Allahun dhe të Dërguarin e Tij më shumë se çdo gjë, të duash një rob vetëm për hir të Allahut dhe ta pranosh të tmerrshme si hedhja në zjarr rikthimin në kufër pasi të shpëtosh prej tij." (Buhari, Iman, 9; Muslim, Iman, 67.)

Por kushti i dashurisë është ndjekja dhe zbatimi i mësimëve hyjnore.

Allahu në Kuran thotë:

**"Thuaju (o Muhamed): "Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t'ju dojë dhe t'jua falë gjynahet!.."** (Al-i Imran, 31)

Kurse Pejgamberi ﷺ dashurinë ndaj tij si kusht të besimit e ka shprehur në këtë mënyrë:

*"Betohem në Allahun i Cili ka në dorë shpirtin tim, se pa qenë unë më i dashur tek ndokush prej jush se vetja e tij, prindërit e tij, fëmijët dhe të gjithë njerëzit e tjerë, ai nuk ka besuar me gjithë shpirt."* (Buhari, Iman, 8)

2. Arti madhështor, is hprehur në krijimin e njeriut është rrjedhojë e domosdoshme e artit dhe madhësisë së Zotit. Në ajetet 20-21 të sures Dharijat urdhërohet kështu:

**“Në Tokë ka shenja për ata që besojnë me bindje, po edhe në vetet tuaja - a nuk e shihni vallë?”** (Dharijat,20-21)

Veçanërisht në një ajet tjetër, Zoti pasi bën të ditur etapat nëpër të cilat kalon krijimi i njeriut, e shpreh kështu madhësitinë e Tij:

**“Qoftë lartësuar Allahu, Krijuesi më i përsosur!”** (Muminun,14)

Një tjetër shkak i krijimit të njeriut është detyra e tij si përfaqësues i Zotit në tokë.

**“Kujto që Zoti yt u pati thënë engjëjve: “Unë do të krijoj mbi tokë një zëvendës”. (Bakara, 30)**

Emërtimi i njeriut si zëvendës (kalif) në këtë ajet, ka këto kuptime:

“Nga vullneti, fuqia dhe atributet e mia do t’i jap atij disa kompetenca. Ai do të ketë të drejtë të bëjë disa veprime e të drejtojë në emrin tim dhe si zëvendësi im. Ai do ta zbatojë ligjin në emrin tim. Në këtë gjë ai nuk do të bëhet i parë, ai nuk do ta zbatojë ligjin në emër të personit dhe individualitetit të vet. Ai do të jetë vetëm zëvendësi dhe ndihmësi im. Ai do të jetë i ngarkuar me detyrën që, me vullnetin e vet, të zbatojë vullnetin tim, urdhrat e mia, ligjet e mia. Pastaj, ata që do të vijnë pas tij, do të kryejnë të njëjtën detyrë si zëvendës të tij dhe, kështu, do të zbulohet e fshehta **“Ai (Allahu i Lartë) ju bëri juve zëvendës mbi tokë!”** (En’am, 165) (Elmalili, Hak Dini, I, 299-300)

Me të vërtetë, për nga afërsia me Zotin, njeriu është krijuar me karakteristika dhe mundësi që do t’i dëshironin shumë edhe negjëjt. Në suren Tin kjo e vërtetë shprehet kështu:

**“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun në formën (harmoninë) më të përsosur (bukur).”** (Tin, 4)

### 3. Shfaqja e attributeve të Allahut në krijim

Hadithi profetik “Pajisuni me moralin e Allahut!” (Munavi, Tearif, fq. 564) shpreh pikërisht këtë të vërtetë. Njeriut i janë dhënë shumë cilësi dhe afëtesë që nuk i ka asnjë krijesë tjetër. Në natën e Miraxhit as Xhibrili nuk mund të shkonte përtej pragut që shkoi Pejgamberi ﷺ.

Njeriu duhet të kuptojë qëllimin e krijimit të tij dhe të falenderojë Allahun vazhdimisht për mirësitë e mëdha dhe të shumta që i janë dhënë.



## 18) Cili është qëllimi i Tasavvufit?

Po të vështrohet përkufizimi dhe tematika e gjerë e tasavvufit, do të shihet se ai ka bërë për parim një qëllim shumë të rëndësishëm e të lartë për njeriun. Ky qëllim është "adhurimi i Allahut në mënyrën më të bukur e të begatë", që qëndron si një diell në qiellin e të gjithë profetëve dhe të të urtëve qysh nga profeti i parë. Me këtë aspekt, është qëllimi i qëllimeve. Me fjalë të tjera, për të fituar në kuptim të plotë pëlqimin e Zotit, është përfitimi nga morali i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij duke shpëtuar nga sëmundjet moralo-shpirtërore, është nënshtrimi i nefsit (frymës, egos) urdhrit të fesë, është shpëtimi i adhurimeve nga kryerja mekanike për t'u dhënë ndjenjën e mirësisë (**ihsan**), është orientimi i zemrës në drejtim të gjërave të larta moralo-shpirtërore për t'u bërë, si përfundim, i merituar i pëlqimit hyjnor me një zemër të paqëtuar.

Është një e vërtetë e ekspozuar për shumë herë me radhë nga historia, sipas së cilës njeriu, ndërsa është në lartësinë e **ahsen-i takvim-it**, domethënë, *qenies më të nderuar*, po të tjetërsohet për sa i përket qëllimit të krijimit e të largohet nga orientimi, mund të bëhet një qenie që të meritojë madje edhe cilësimin e *qenies më të ulët se kafshët* i vetmi faktor që cakton te njeriu vlerën dhe nderin, është *besimi* (**iman**). Kurse pas besimit vjen *morali* (**ahlak**).

Dijetarët janë ndër trashëgimtarët e Profetit ﷺ, dhe dituria e përftuar prej tyre nga ai burimi i begatë profetik, janë në pozitën e trashëgimtarit dhe përfaqësuesit të detyrës së të Dërguarit të Allahut.

Ata që ecin në këtë rrugë, veprimet e tyre karakterizohen nga një përpjekje lidhjeje e besnikërie të plotë ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ i cili është qendra e vlerave të jashtme e të brendshme. Edhe dijetarët e orientuar në këtë rrugë, marrin përsipër një shërbim të kryer nga Profeti ﷺ në këtë botë, duke marrë pjesë brenda konkluzionit:

*“Dijetarët e vërtetë janë trashëgimtarë të profetëve!”* (Ebu Davud, Ilm, 1)

Prandaj, pjekuria moralo-shpirtërore, mund të thuhet se, në një aspekt, është shfaqje e qëllimit që ka dashur të realizojë te njerëzit Profeti ﷺ. Siç dihet, ky qëllim është që, në truallin e besimit, t'i shpëtojë njerëzit nga veset egoistike e të këqija për t'i lartësuar në moralin e lavdërueshëm, domethënë në pjekurinë morale-shpirtërore dhe shprehitë e bukura.

Në një hadith të shenjtë, Zoti thotë kështu:

*“Kjo është një fe për të cilën unë si personalitet, jam i kënaqur. Dhe çka i ka hije kësaj feje, është bujaria dhe morali i bukur. Për sa kohë që juve t'ju favorizohet dhuntia për t'u bërë ndjekës të kësaj feje, lartësojeni atë me këto dy virtyte!”* (Hejthemi, Mexhmau'z-Zevaid, VIII, 20)

Nisur nga kjo, tasavvufi është mundësia për ta shndërruar moralin e bukur, pra, meritat e larta, si mëshirën, dhembshurinë, bujarinë, faljen, falenderimin, në gjendje shijeje e kënaqësie te besimtari.

Gjithashtu, qëllimi në tasavvuf është që, duke i zhvilluar më tej e duke i përsosur njerëzit me kapacitete, me aq sa e mundësojnë kapacitetet e tyre, të nxiten të kapërcejnë largësi në rrugën për t'u bërë njeri i përsosur, njeri bujar, njeri që e njuh mirë veten dhe Zotin e vet, që shijon gëzimin e afërsisë ndaj Zotit, që është mik i Zotit me qëndrueshmërinë ndaj armiqtësive të nefsit (frymës, egos).

Në Kur'an thuhet:

**“Ne ua propozuam amanetin qiejve, tokës e maleve dhe ata u drojtën ta merrnin përsipër këtë, u trembën (nga përgjegjësia). Atë e mori përsipër njeriu. Me të vërtetë, ai është shumë injorant dhe mizor!”** (Ahzab, 72)

Siç thuhet në këtë ajet, njeriun që përpëlitet mes mëkatit, duke e shpëtuar nga cilësitë e ulta të **inJORANTIT** dhe **mIZORIT**, ta ngrësh në cilësinë e njeriut të përsosur. E kundërta e mizorisë apo padrejtësisë (zulm) është drejtësia (adl). Me fjalë të tjera, që akti i robit të jetë i mirë (salih). Kurse e kundërta e injorancës (xhehl) është dituria (ilm). Për t'u bërë dijetar i vërtetë, duhet që ta zotërosh aq sa dijen e jashtme, formale, edhe dijen e brendshme, përmbajtësore.

Imam Gazaliu (r. alejh) ka thënë:

“Trashëgimtarë profetikë janë ata që zotërojnë dijen e jashtme e të brendshme!”

Shpëtimi i njeriut varet nga pastrimi i cilësive të këqija të nefsit, kështu, nga shndërrimi i akteve të tij në akte të mira (salih) dhe nga personalizimi i dijes, domethënë, nga kthimi i dijes së tij në kulturë shpirtërore (irfan). Ja, pra, tasavvufi ka për qëllim konceptimin dhe përjetimin e edukatës dhe cilësive që do të siguronin arritjen e kësaj.

Evljanjtë që e realizojnë këtë qëllim, domethënë të urtët që Zoti i bën miq të vet, janë njerëz përjashtimorë që e përjetojnë përsosmërinë në besim (iman) dhe devocion (takva). Zoti flet kështu për ta:

**“Ta dini se për miqtë e Zotit nuk ka frikë dhe ata nuk do të dëshpërohen. Ata kanë besuar dhe kanë arritur devocionin!”** (Junus, 62-63)

Ndërsa besimi i shfaqur në zemër e shpëton robin nga të gjitha bestytnitë dhe e afron tek e Vërteta, edhe devocioni e pastron zemrën nga vanitetet. Tashmë zemra e një robi të këtille fiton cilësinë e

të qenit seli e vështrimit të Zotit, bëhet mjedisi i shfaqjes së urtësive dhe enigmave hyjnore.

## 19) Në cilat periudha të Historisë islame është ndjerë nevoja e Tasavvufit? A kemi sot nevojë për Tasavvufin? A mund të rrugëtohet pa të?

Nevoja për Tasavvufin është e përhershme, sepse e tillë është edhe domosdoshmëria e njeriut për t'u përmirësuar.

Nëse hedhim vështrimin në histori, shohim se në kohën e mirëqenies ekonomike dhe shoqërore tasavvufi ka ushqyer shpirtin duke u bërë pengesë e përtacisë, dembelizmit e arrogancës; po ashtu në periudhat e vështira të pushtimit e mizorisë së plotë, ka çelur dritare madhështore duke i dhënë frymë zemrave të ngushtuara.

Kjo është një qasje profetike. I Dërguari i Allahut ﷺ, sa herë arrinte një fitore apo mirësi, thoshte: *"O Allah! Jeta e vërtetë është jeta e përtejme..."*<sup>9</sup>, duke mbyllur kështu derën e krenarisë, egoizmit dhe devijimit të zemrave ndaj kësaj bote.

Nga ana tjetër, sa herë përballej me ndonjë padrejtësi, mërzi, shqetësim, shprehej: *"O Allah! Jeta e vërtetë është jeta e përtejme..."*

---

9. Buhari, Rikak, 1.

Në këtë mënyrë ai i ka ruajtur zemrat e besimtarëve nga humbja e shpresës përballë vështirësive të përkohshme, si dhe nga humbja e qetësisë shpirtërore si rrjedhojë e zhytjes në ankesa dhe në mërzë të tepruar. Ai i dhuroi umetit recetën shpirtërore të paqes, qetësisë dhe ekuilibrit përballë çdo situatë.

Në kohën kur Islami ishte i vështirë të jetohej, nevoja e Tasavvufit u rrit. Për shembull, në periudhën kur bota Islame u plaçkit nga Mongolët, personalitete të larta shpirtërore si Mevlana apo Junus Emre, ishin pranë popullit. E vërteta është se kjo prani nuk ka munguar që prej 700 vjetësh.

Në kohën kur Batinitë synuan ta dëmtojnë shpirtin e Islamit, u shfaq Imam Gazaliu me devotshmërinë, diturinë dhe urtësinë e tij. Ai ka dhënë një kontribut të vyer në çështjen e ruajtjes së besimit Islam nga disa opinione të huazuara nga filozofia indiane dhe greke. Ai u përpoq të pastronte besimet e gabuara dhe ta drejtonte popullin drejt jetës së devotshme.

Po ashtu shohim edhe këshillat e urta të Imam Rabbanit në kohën kur në Indi, Shahu Ekberi u përpoq të dëmtonte besimin islam duke bërë lëshime në fe. Ai ruajti besimin Islam ndaj përçarjeve të kohës dhe u bë shkak që shumë nga burrat e shtetit, paria ushtarake dhe populli i thjeshtë, të cilët kishin rënë pre e mendimeve të pabaza, të pendoheshin dhe të drejtoheshin në rrugë të drejtë.

Në Perandorinë Osmane mbizotëronte qetësia shpirtërore për sa kohë vazhdoi tarikati (silsile) i Edebalit. Në ditën e bekuar kur Sulltan Mehmet Fatihu mori Stambollin, tha: *"Gëzimi dhe paqja që shihni tek unë, nuk buron thjesht nga pushtimi i kësaj kalaje; por nga prania e (dhe afërsia) e një robi të dashur të Allahut siç është Akshemseddini (nga përfitimi prej mësimëve të tij shpirtërore)."*

Aziz Mahmud Hydaji, një rob i dashur i Allahut, i cili ka jetuar në kohën e tetë sultanëve, ka arritur të jetë burim qetësie shpirtërore, paqeje e qëndrueshmërie në besim, si për sultanët që kanë sunduar botën ashtu edhe për popullin e thjeshtë, duke iu tërhequr atyre vëmendjen dhe duke i orientuar. Së bashku me Ferhat Pashën, mori pjesë edhe në fushatën luftarake të Tebrizit në detyrën e komandantit shpirtëror të ushtrisë.

Nga ana tjetër, është vërtetuar historikisht se besimtarët që kanë arritur të përfitojnë me të vërtetë nga edukimi shpirtëror i tasavvufit, kanë qenë më të lidhur me besimin dhe punët e mira dhe kanë mbrojtur më lehtë imanin e tyre përballë tiranisë e shtypjes.

Në shumë vende islame si: Ballkani, Kaukazi, Azia Qëndrore dhe Afrika, të ekspozuara nga njëra anë nga rreziku i asimilimit ateist dhe komunist dhe erozioni kulturor global, nga ana tjetër nga aktivitetet misionare, ata që kanë arritur të ruajnë identitetin e tyre islam kanë qenë kryesisht besimtarët e edukuar në frymën e tasavvufit.

Qëllimi i tasavvufit është forcimi i besimit në zemër në atë shkallë që të mos lëkundet përballë fortunave me të egra të mosbesimit dhe femohimit.

Edhe në vendin tonë, në kohën kur Islami u sulmua, përpjekjet e Sami Efendiut dhe miqve të tjerë të Allahut, ishin të mëdha.

Një aspekt tjetër i domosdoshmërisë dhe rëndësisë së Tasavvufit në ditët tona, është edhe metoda dhe rruga që ai ndjek në çështjen e përmirësimit të njerëzve.

Veçanërisht në këto kohë, shumë njerëz janë zhytur në krizën shpirtërore të egos dhe gjynaheve të mëdha. Është e qartë se në vend që të zemërohemi me ta, është më e lehtë t'u ofrojmë një rrugë shpëtimi dhe përmirësimi përmes parimeve të patjetërsueshme të tasavvufit, siç janë: falja, mirëkuptimi, mëshira dhe dhembshuria.

Kështu sipas botëkuptimit mistik, urrejtja ndaj gjynahit nuk duhet t'i mvishet gjynahqarit. Madje qasja ndaj tij duhet të jetë e bazuar në dhembshuri dhe mëshirë, sikur ndaj një zogu krahëthyer.

Le të shohim disa shembuj që e shprehin bukur këtë të vërtetë:

Kadiu i Shamit, Ebu Derda عليه السلام, një ditë teksa po shëtiste në rruget e qytetit, vërejti disa njerëz që po i flisnin me fjalë të rënda një gjynahqari.

U tha: “-Nëse do shihnit një njeri që ka rënë në pus, a do e shpëtonit?”

“-Po, do e shpëtonim!”,- u përgjigjën ata.

Pas kësaj Ebu Derda tha:

“-Atëherë mos i flisni me fjalë të rënda vëllait tuaj, por falënderoni Allahun që ju ka dhuruar shëndet”.

Ata pyetën:

“-Po ju, a nuk u zemëruat me këtë gjynahqar?”

Ebu Derda u përgjigj:

“-Unë nuk u zemërova me të, por me mëkatin e tij, kur ai të largohet nga ky mëkat, përsëri do jetë vëllai im në fe”. (Abdurrezzak, Musannef, XI, 180; Ebu Nuajm, Hilje, I, 225.)

Një shembull nga Mevlana:

Gjatë një tubimi fetar në teqe papritmas shfaqet një i dehur. Dervishët e pranishëm aty mundohen ta nxjerrin jashtë me forcë. Ndërkohë Mevlana mendon se ky njeri i dehur ka trokitur në derën e teqes për të gjetur të vërtetën, prandaj u thotë dervishëve me ton qortues:



*"-Mos e prekni të gjorin! Po shoh se verën e ka pirë ai, por të dehurit jeni ju!"*

Një tjetër shembull:

Në një sofër iftari të shtruar nga fondacioni Hydaji, shfaqen dy të dehur. Një pjesë e xhematit shprehet me zemërim: "-T'i nxjerrim përjashta këto njerëz të pamatur që vijnë të dehur në këtë vend të begatë!"

Disa të tjerë të edukuar në frymën e tasavvufit thanë:

"-Le të mos shohim mëkatin e tyre. Le t'i pranojmë këta persona si dy krijesa të uritura të Zotit, që kanë trokitur në derën tonë në këtë kohë të begatë". U japin për të ngrënë dhe për të pirë dhe interesohen për gjendjen e tyre. Koha kalon dhe njëri prej tyre ndryshon krejtësisht duke u bërë një besimtar i devotshëm.

Kështu metoda e tasavvufit ndaj atyre që kanë humbur besimin dhe janë zhytur në dobësitë e egos, synon fitimin e zemrës përmes gjuhës së mëshirës, jo përmes gjuhës së ftohtë dhe helmuese gjarpëruese.

Për këtë arsye, gjatë gjithë historisë ithtarët e vërtetë të tasavvufit, zemrat e të cilëve ishin burime mëshire, kanë qenë një pishtar ndriçues për gjithë shoqërinë. Prandaj dhe Abdulkadir Gejlani, Bahauddin Nakshibendi, Mevlana, Junus Emre e robërit e tjerë të dashur të Allahut, përherë duhen dhe iu ndihet mungesa.

Për fat të keq sot ka prej atyre që e komentojnë Islamin sipas dëshirave dhe interesave vetjake. Por cili është Islami që duhet jetuar në mënyrë që Zoti ynë të jetë i kënaqur? Natyrisht është Islami i të Dërguarit të Allahut dhe shokëve të tij. Pra është e domosdoshme që Islami të jetohet me thellësinë e zemrës, me delikatesën e moralit dhe me ndjeshmërinë e devotshmërisë.

Ky është vetë Islami; megjithatë për ta ndarë nga kuptime të ndryshme përdoren termat: "takva", "zuhd", "ihsan", shkurtimisht "tasavvuf". Këto janë emërtime të ndryshme të një të vërtete të vetme...

Në këtë kuptim, në një kohë kur njerëzimi i është nënshtruar materiales dhe epsheve, nevoja për tasavvufin është e patjetërsueshme. Sepse feja mund të ruhet vetëm me ndjeshmërinë e devotshmërisë. Devotshmëria shkurtimisht është frika dhe dashuria ndaj Allahut.

Krijuesi i Gjithësisë i përshkruan besimtarët:

**"Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë..."** (Enfal, 2)

Kjo do të thotë që devotshmëria është të jetuarit e Islamit mes fërgëllimës së një zemre të butë e të ndjeshme.

## **20) Cila është urtësia e ekzistencës së nefsit? Si mund të kapërcehet pengesa e nefsit?**

Nderi i një fitoreje është më i madh në raport me vështirësitë e duruara për ta arritur atë.

Veprimi i gabimit të njohur të Ademit عليه السلام, u bë shkak që ai të zbritej nga xheneti në Tokë. Shtimi i pasardhësve të tij në këtë vend të ri, sprovimi i tyre dhe kthimi i disa prej tyre në xhenet si e drejtë e merituar, është me qëllim që njeriut të arrijë nderin e të qenin “krijesa më e nderuar”. Mirëpo, për ta rritur këtë nder dhe vlerë, Allahu i Madhëruar e ka pajisur njeriun me “nefs”. “Nefsi” është një pengesë e jashtëzakonshme që bëhet shkak për rritjen e nderit dhe vlerës së rezultatit që duhet të arrihet.

Allahu i Madhëruar, i Cili i ka ngarkuar njerëzit me detyrën për të fituar kënaqësinë e Tij dhe të kthehen në xhenet duke e fituar këtë të drejtë, gjithashtu u ka dhënë atyre edhe mjetet dhe mundësitë e duhura për të kapërcyer pengesën e nefsit që u ka vendosur. Në krye të këtyre është dërgimi i “profetëve” dhe të trashëgimtarëve të tyre, të devotshmit dhe dijetarët, që do të vazhdojnë shërbimin e tyre ndaj njerëzimit deri në ditën e fundit.

Në tregimin e mëposhtëm, Mevlana përshkruan urtësinë e ekzistencës së "nefsit":

### **Mbreti misterioz**

"Një mbret po kalonte nga një rrugë me kalin e tij. Papritur pa një burrë që po flinte nën një pemë. Në ato momente, një gjarpër i zi filloi t'i hynte nga goja burrit që po flinte. Edhe pse mbreti shkoi me kalë drejt gjarprit dhe u përpoq për ta trembur, prapë se prapë nuk ia doli dot mbanë. Gjarpri i hyri burrit në trup.

Mbreti ishte një njeri largpamës, i zgjuar dhe plot urtësi. Ai mendoi shpejt dhe vendosi ta përdorte të gjithë aftësinë dhe zgjuarsinë e tij për ta shpëtuar burrin që po flinte nga një fund i dhimbshëm dhe i trishtueshëm. Për këtë arsye, filloi ta godiste burrin me kamxhik... Burri u zgjua duke u hedhur prej dhimbjes dhe filloi të ikte i frikësuar dhe i shqetësuar për të shpëtuar nga goditjet e kamxhikut që fishkëllenin njëra pas tjetrës.

Mbreti vazhdonte ta ndiqte nga pas burrin e shkretë. Ndërkohë që burri po ikte, arriti te një pemë molle. Mbreti e zuri burrin aty. Ai filloi t'ia fuste në gojë burrit mollët e kalbura dhe të prishura që kishin rënë në tokë. Ndërsa nga ana tjetër i bërtiste:

"O ti njeri i shkretë dhe i mjerë! Këto do t'i hash të gjitha! Këtë vuajtje do ta durosh!" Ndërsa burri i shkretë, nga njëra anë i gëlltiste me vështirësi mollët e prishura dhe të kalbura dhe nga ana tjetër e mallkonte mbretin pa pushim:

"O mbret! Çfarë të kam bërë?.. Çfarë do të bësh me mua? Cili është shkaku i kësaj padrejtësie që po më bën?.. Nëse do të më vrasësh, të paktën më gjuaj me shpatë dhe ma derdh gjakun! Përse po më bën të vuaj kaq shumë? Sa kohë e keqe paska qenë çasti kur të pashë!.. Sa njerëz fatlumë qenkan ata që nuk e kanë parë fytyrën tënde!.. As

zullumqarët më të mëdhenj nuk ia bëjnë këtë padrejtësi një njeriu që s'ka bërë asnjë faj! Siç e sheh, nga goja po më del gjak edhe kur po i them këto fjalë!.. Beto hem se nuk kam parë ndonjëherë njeri kaq të pamëshirshëm dhe të pandërgjegjshëm sa ti!.. O Zot! Ndëshkoje Ti këtë zullumqar!”

Mbreti nuk ua vuri veshin aspak këtyre fjalëve. Ai e detyroi atë t'i hante të gjitha mollët dhe pastaj përsëri filloi ta godiste me kamxhik duke i thënë: “Menjëherë vrapo në këtë luginë!”

Burri i shkretë filloi të vraponte si era prej frikës nga kamxhiku. Nganjëherë rrëzohej për tokë, por prapë ngrihej në këmbë dhe vraponte për shkak të kamxhikëve që hante. Stomaku i burrit të shkretë ishte i mbushur plot me mollë të prishura. Ndërsa fytyra i kishte marrë shumë plagë nga kamxhiku. Krahas kësaj, mbreti nuk shfaqte asnjë shenjë mëshire. Ai e bëri atë të vraponte derisa nuk i ngeli fuqi për ta hedhur hapin. Burrit të shkretë tashmë i shteroi fuqia. Stomaku i tij i mbushur me mollë të kalbura, u trazua pas gjithë atij vrapi shumë të mundimshëm. Për këtë arsye, burri i shkretë nuk duroi dot më shumë dhe filloi të villote.

Çdo gjë që kishte ngrënë, po i dilte nga goja edhe pse me vështirësi. Më së fundi, bashkë me mollët e kalbura doli jashtë edhe gjarpri i zi. Burri i shkretë u habit pa masë. Ai u tmerrua kundrejt gjarprit të frikshëm që doli nga stomaku i tij. Menjëherë e kuptoi çdo gjë. Menjëherë vrapoi dhe u përkul te këmbët e atij mbretit të devotshëm. Atij i tha:

Por!..

“Por ti paske ardhur si mëshira e Xhebrailit! Ti paske qenë një mirësi për mua! Sa kohë e bekuar paska qenë momenti kur të pashë! Po të mos ishte ti, do të kisha vdekur në një mënyrë të tmerrshme. Ti më fale jetë. Lum për atë që e shikon fytyrën tënde apo rastësisht vjen në lagjen tënde! O ti rob i dëlirë dhe i veçantë që meriton të lavdëroresh!

Sa keq më bëri të flas injoranca dhe shkujdesja ime e mëparshme! Më fal që t'i thashë ato! A do të t'i thosha ato fjalë të papërshtatshme po të kisha vetëm pak dijeni për këtë gjë! Pra, ti e fshehe të vërtetën se ishe një mjek i fuqishëm që i jep ilaç të hidhur të sëmurit, në mënyrë që ai të shërohet. Po të më kishe treguar qoftë edhe pak për këtë, nuk do të të ofendoja, por do të të falënderoja. Ndërsa ti heshtje dhe më godisje në kokë pa reshtur. Si rezultat, koka mu hutua dhe mendja më iku. Prandaj çfarë nuk të thashë prej paditurisë. Më fal dhe mos m'i merr për keq ato që t'i thashë!"

Mbreti i bekuar dhe largpamës i tha: "Nëse do të të tregoja qoftë edhe pak për atë që kishe brenda, do të të plaste tëmthi. Frika do të të shkatërronte. Do të shkatërroheshe si miu para maces dhe do të veproje si një qengj para ujkut... Po të të tregoja për tmerrin e atij gjarprit të zi, në ato momente do të hutoheshe prej frikës. Po të kishe dijeni për përbindëshin që kishe brenda, nuk do të kishe fuqi as për t'i ngrënë ato mollët, as për të vrapuar, as për ta nxjerrë atë gjarpër të zi duke vjellë... Unë bëra durim ndaj fjalëve të tua të papërshtatshme. Në vete lutesha: "O Zot! Lehtësoja për ta nxjerrë gjarpurin! Shpëtoje këtë të shkretë!" Edhe pse ti më the fjalë të hidhura, mëshira që kam në zemër nuk më lejoi të të lija në atë gjendje, sepse krijimi im është i mbujtur me mëshirë."

Burri i shkretë që e kuptoi të vërtetën e këtij miku të Zotit (xh.sh.), nuk dinte çfarë të thoshte.

Për këtë arsye, duke e ndjerë veten të turpëruar, tha: "O njeri i lartë! Ky i shkretë nuk ka mundësi të të falënderojë ty siç e meriton! Prandaj, Allahu të shpërbleftë për këtë mirësi!"

Të urtët kanë thënë:

"Nëse do t'u tregohej armikun që keni brenda, edhe më trimave prej do të tmerroheshin. Për këtë arsye, as nuk do të merrnin dot ndonjë

rrugë, as nuk do t'ia dilnin mbanë për të bërë ndonjë punë. Si rezultat, do të përpëliteshin nga dëshpërimi. Në trup nuk do t'u ngelte fuqi për adhurim, në zemër nuk do t'u ngelte forcë dhe nuk do të përparonit në besim. Atëherë, unë ju edukoj me heshtje dhe pa ua nxjerrë jashtë atë që keni brenda.”

Njeriu që flinte, i cili u përmend në historinë e Mevlanës, është njeriu i shkujdesur nga e vërteta. Gjarpri që i hyri brenda është nefsu'l-emma. Mbreti është udhërrëfyesi i përsosur. Rrahja me kamxhik, ndërsa ai ishte në gjumë, për ta zgjuar dhe detyrimi për ta bërë të vraponte në fushë e luginë, janë përpjekja dhe rijazati (ushqyerja me pak për ta edukuar veten, apo preokupimi me mendime e vepra të dobishme duke e ndaluar nefsin nga gjërat e këqija). Ndërsa dalja e gjarprit është shpëtimi nga nefsu'l-emma.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

“Xhehenemi është rrethuar me gjëra që i pëlqejnë nefsit (egos). Ndërsa xhenet është rrethuar me gjëra që nuk i pëlqejnë nefsit.” (Buhari, Rikak 28; Muslim, Xhennet 1.)

Kapërcimi i pengesës së nefsit, është e mundur të duke mbajtur për dore profetët dhe dijetarët, të cilët erdhën pandërprerë si trashëgimtarë të tyre, duke u dhënë besën dhe duke iu dorëzuar edukimit të tyre.

## 21) Përse është i rëndësishëm pastrimi i zemrës? Dhe si arrihet ajo?

Në mësimin e moralit të bukur që formon personalitetin Islam, një nga hapat që duhet hedhur më së pari është pastrimi i vetes dhe dëlirja e zemrës. Në të njëjtën kohë ky pastrim dhe kjo dëlirje janë faktorët më të qartë në realizimin e tragjedisë apo të lumturisë në të ardhmen e njerëzve.

Për të pastruar veten dhe për të dëlirë zemrën, së pari duhet t'i bindesh vullnetit hyjnor, e po ashtu të përpiqesh të dalësh kundra pasioneve vetjake dhe gjendjeve të këqija.

Duke e kuptuar gabimin, mangësinë, paaftësinë, asgjënë dhe padijen e tij, çdo besimtar duhet ta perceptojë Zotin me gjithë madhësinë, fuqinë dhe përsosmërinë e Tij, ndërsa veprat e tij duhet t'i drejtojë në këtë perceptim. Ja, kur të bëhet kjo -me shprehjen e Kur'anit- "**vetja e cila urdhëron të keqen me këmbëngulje**"<sup>10</sup>, pastrohet nga cilësitë e këqija dhe vjen në një gjendje të pranueshme.

Të përpiqesh të pastrosh veten dhe të hysh në këtë rrugë me

---

10. Shih. Sureja Jusuf, ajeti 53



përpekje serioze për hir të kësaj, është pranuar si **“xhihadi më i madh”** duke u mbështetur në rëndësinë dhe vështirësinë që ka.

Po ashtu, këtë shprehje e ka përdorur Pejgamberi ynë i Nderuar në kthimin nga Lufta e Tebukut, në të cilën u hasën vështirësi të mëdha. Në këtë luftë as’habët e nderuar kishin shkuar një mijë kilometra dhe ishin kthyer. Në udhëtim përjetuan shumë vuajtje si uria dhe etja. Mjekrat dhe flokët e sahabëve ishin ngatërruar me njëra-tjetrën dhe lëkurat iu ishin ngjitur pas kockave. Kur pa ashabët e nderuar në këtë gjendje, i Nderuari ynë tha:

*“Tani po kthehemi nga xhihadi i vogël dhe po shkojmë te xhihadi me dëshirat e vetes, i cili është xhihadi më e madh!”*

Në hadithe të ndryshme fisnike, i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

*“(Në të vërtetë) Luftëtar është ai që lufton me veten e tij.”* (Tirmidhi, Fedailu’l-Xhihad, 2/1621; Ahmed, VI, 20)

*“I mençur është ai që e sundon veten dhe punon për pasvdekjen, duke i kërkuar llogari asaj. Ndërsa budalla është ai që ndjek dëshirat e vetes dhe shpreson (të mirë) nga Allahu.”* (Tirmidhi, Kijamet, 25/2459; Ibn Maxhe, Zuhd, 31)

*“Ajo që kam më shumë frikë për ummetin tim është ndjekja e dëshirave vetjake.”* (Sujuti, I, 12)

Nga ky aspekt, edhe edukata profetike e të Nderuarit tonë ﷺ është realizuar në trajtën e një lufte të pamëshirshme që i bëhet vetes. As’habët e nderuar, që edukoheshin me këtë edukim profetik, u bënë njerëz të përsosur dhe erdhën në një gjendje brezi shembullor, duke arritur të pastroheshin nga veset e këqija, si rezultat i pastrimit të vetes dhe dëlirjes së zemrës.

Ibn Mes’udi ﷺ përjetonte gjendjen e falenderimit, lavdërimit dhe dhikrit në mësimet e Pejgamberit tonë të Nderuar. Edhe pse kishte një

dije të gjërë, të fituar për shkak të afërsisë që kishte ndaj të Nderuarit tonë, ai transmetoi vetëm 848 hadithe për shkak të përpikmërisë që kishte në transmetim. Gjendjen shpirtërore që e kishte arritur nën edukimin shpirtëror të të Nderuarit tonë ﷺ, Ibn Mes'udi ﷺ e shpreh kështu:

“Ne përfshiheshim aq shume në disa gjendje të të Dërguarit të Allahut, saqë mund të dëgjonim edhe dhikrin e kafshatave që hanim.”  
(Shik. Buhari, Menakib, 25)

Ibn Mes'ud ﷺ, që në të kaluarën ishte një çoban deveshë, kur u udhëzua dhe kaloi në edukimin shpirtëror të të Dërguarit të Allahut iu bë zemra det. U hollua, u thellua dhe zemra filloi të reflektonte shfaqjet hyjnore. Shkolla e famshme e Kufes është vepra e këtij sahabiu të njohur. Edhe Imam Azami Ebu Hanife, i cili ishte juristi më i madh i botës, është edukuar po nga kjo shkollë.

Ai ishte Imam Azami, para të cilit Soloni dhe Hamurabi, që njihen si juristët më të mëdhënj të botës, mund të jenë vetëm nxënës. Përderisa të vazhdojë medhhebi Hanefi që e ka formuar Ebu Hanife, Ibn Mes'ud ﷺ do të fitojë sadakutu'l-xharije (punë e mirë që vazhdon edhe pas vdekjes). Kësisoj, ai dhe sahabët e ngjashëm me të, nuk harrohen edhe pasi t'u bëhen trupat tokë. Salltanatet e tyre do të vazhdojnë deri në kiamet në zemrat e ummetit të Muhammedit.

Edhe njëri nga mënyrat kryesore që përdornin pejgamberët dhe miqtë e Zotit me qëllim që të ndikonin shpirtat dhe zemrat në edukimin shpirtëror të njerëzve, është **“kuvendi”**. Ndjenjat e gjendjes që jeton janë të ngarkuara në fjalët e atij që e ka pastruar veten dhe e ka dëlirur zemrën. Fjalët që thuhet me këto ndjenja dhe me këtë sinqeritet, e gjejnë rrugën nga veshi për në zemrën e bashkëbiseduesit, japin ndikime të mira dhe bëhen shkak për kalimin e begatisë dhe të ndjenjës shpirtërore.

Edhe dijetarët të cilët janë trashëgimtarë të Pejgamberit, para së t'iu rregullojnë njerëzve përjetimet negative, i sjellin në një gjendje të gatshme për t'u rregulluar, duke ua zbutur zemrat me begatinë dhe bereqetin e kuvendit. Duke i ndalur furtunat e zemërimit dhe të inatit, përgatisin bazat që flladet e ëmbla të pendimit të bëhen realitet.

Edhe begatia që transmetohet te zemra e nxënësve të përsosur në formë zinxhiri nga i Dërguari i Allahut ﷺ, vjen në zemrat e besimtarëve me rabita (lidhje shpirtërore) dhe kuvende. Për këtë shkak, personaliteti shembullor i Pejgamberit tonë të Nderuar reflektohet në zemrat besimtare aq sa ato e duan Atë.

Aq sa ç'kryhen kuvendet me adhurim, po aq vijnë edhe shfaqjet. Zemrat në kuvende ndahen sipas bashkëbiseduesit, sepse kuvendi është sikur t'i shkruash një recetë shpirtërore bashkëbiseduesit. Kuvendi që bëhet dhe dëgjohet me zemër të sinqertë, është një gjendje zbulimi e thellë. Shfaqjet fillojnë të vijnë sipas gjendjes së zemrës së bashkëbiseduesit.

Metoda me ndikuese që ka përdorur i Dërguari i Allahut për edukimin dhe pastrimin e ashabëve të Tij, është kuvendi, sepse Allahu i thotë Pejgamberit tonë të Nderuar:

**“Këshillo, sepse këshilla u bën dobi besimtarëve.”** (Dharijat, 55)

**“...Ti je vetëm një këshillues.”** (Gashije, 21)

Është shumë interesant edhe fakti se fjalët “sahabi” dhe “kuvend” janë formuar nga e njëjta rrënjë. Me dashurinë, respektin dhe ndjesinë që e kishin ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ, as'habët e nderuar janë bërë shembulli më i përkryer dhe më i shkëlqyer i përfitimit të asaj që duhet nga kuvendi dhe nga edukata shpirtërore. Qetësinë dhe edukatën që kishin në kuvendin e të Dërguarit të Allahut në lidhje me kushtin e asaj që përfituan, e kanë shprehur kështu:

“Ne pandehnim se në kokën tonë kishte një zog, i cili nëse lëviznim, do të fluturonte.” (Shik, Ebu Davud, Sunnet, 23-24/4753; Ibn Maxhe, Xhenaiz, 37; Ibn Sa'd, I, 424)

Ja pra, me një dëshirë të tillë të zjarrtë bëheshin kuvendet e të Dërguarit të Allahut. Kur Ai fliste, ato e dëgjonin me aq mall e përqendrim shpirtëror sa që tek to reflektohej një gjendje lumturie e ekstaze. Edukata dhe turpi që reflektohej te as'habët nga Ai, ishte në një gradë të atillë sa që as'habët e nderuar shumë herë nuk guxonin t'i bënin as pyetje të Dërguarit të Allahut. Për këtë arsye, nëse ndonjë bedevi vinte nga shkretëtira dhe bëhej shkak për kuvend duke i bërë pyetje Pejgamberit, ashabët prisnin që të përfitonin edhe ata nga begatia e Tij.

Ashabët e nderuar, të cilët në të kaluarën kishin jetuar në një periudhë injorance, pasi u udhëzuan, pasi e pastruan veten dhe pasi e dëlirën zemrën me kuvendet e begata dhe me edukatën shpirtërore të të Dërguarit të Allahut, u bënë njerëzit më të shkëlqyer të kësaj bote. Ata i kaluan legjendat e begata që shëtisnin gojë më gojë dhe që kishin zënë vend në zemra.

Pastrimi i vetes dhe dëlirja e zemrës kanë një pozitë të rëndësishme në formimin e personalitetit Islam. Së pari është pastrim nga kufri, padija, ndjenjat e këqija, besimi i gabuar dhe vetitë e këqia. Do të thotë të pastrohesh nga çdo besim i gabuar që bie ndesh me Fenë e qartë, të pastrohesh nga gabimet etike dhe veprare. Domethënë, pasi të pastrohet zemra dhe të mbrohet nga të këqijat, ta mbushësh me ndjenja shpirtërore, duke e zbukuruar me vetitë dhe me edukimin e devotshmërisë si besimi, dija, dija shpirtërore, urtësia, ndjenjat e mira dhe prirjet e bukura.

Njeriu që kur ka ardhur në këtë botë për tu sprovuar deri në vdekje, është i dhënë pas një sëmundjeje që i thuhet vete dhe e cila përfshin shumë gjëra negative. Ai, edhe nëse ngrihet në shkallën më të lartë të (velajetit) miqësisë, çdo çast është kundra hileve, vesveseve dhe

kurtheve të gjithmonshme të treshes: kësaj bote, vetes dhe shejtanit. Në fakt, edhe vlera e adhurimit fillon duke i mënjeluar këto rreziqe, duke u bërë i devotshëm e duke u larguar nga mashtrimet tërheqëse të kësaj bote të përkohshme ,dhe si rezultat i kësaj duke iu drejtuar Allahut.

Mevlana, i shpreh kështu baticat dhe zbaticat që janë në botën e brendshme të njeriut:

*"Ai që e komandon veten, është si Musa ﷺ. Ndërsa trupi është Faraoni i tij. Ai që e komandon veten, e lë veten që e ka brenda tij dhe fillon të kontrollojë jashtë se ku është armiku."*

*"O udhëtar i Zotit! Nëse dëshiron të mësosh të vërtetën, as Musa e as Faraoni nuk kanë vdekur. Ata sot jetojnë brenda teje, janë fshehur në ekzistencën tënde dhe vazhdojnë të luftojnë në zemrën tënde! Për këtë arsye, këto dy vetë që janë armiq të njëri-tjetrit, duhet t'i kërkosh në veten tënde!"*

Përsëri Mevlana thotë:

*"Mos u mundo ta ushqesh trupin shumë, sepse ai është një kurban që në fund do t'i jepet tokës. Ti mundohu të ushqesh zemrën! Është ajo që do të ngrihet lart dhe që do të nderohet."*

*"Trupit tënd jepi pak gjëra me vaj dhe me mjaltë, sepse ai që e ushqen tepër, bie në dëshirat vetjake dhe në fund poshtërohet."*

*"Shpirtit jepi ushqime shpirtërore. Shfaqi atij mendim të pjekur, perceptim të mprehtë dhe ushqime shpirtërore, ashtu që të shkojë i fuqishëm në vendin ku do të shkojë."*

Me të vërtetë, vetja është diçka dyanëshe e cila, kur edukohet e ngre njeriun në pozitën më të nderuar të krijesat, por kur nuk edukohet, i ndodh kundërta: e lëshon atë në fund të xhehennemit. Është pothuajse si një thikë me dy tehe të mprehura.

Çdo vete që është e privuar nga udhëzimi shpirtëror dhe kontrolli, është perde e një humbjeje të dhembshur që i mbulon të vërtetat me neglizhencë, por nëse njeriu shpëton nga morali i keq, paçka se e pengon vetja, nëse njeriu mund ta pastrojë veten dhe ta dëlirë zemrën, ai mund t'i kalojë edhe engjëjt të cilët nuk i pengon asgjë për t'u drejtuar te Allahu dhe te e mira, sepse nderi i një rezultati është i lidhur me vështirësitë që kapërcehen për ta arritur atë.

Prandaj themi se pastrimi i egos dhe purifikimi i zemrës është një domosdoshmëri për të gjelbëruar farërat e devotshmërisë (takvasë) dhe për të edukuar prirjen e natyrshme të njeriut për kah e keqja. Për këtë arsye, çdo njeri është i urdhëruar ta lartësojë dhe ta madhërojë Allahun me punë të mira, aq sa ka mundësi, ta njohë Atë dhe këtë informatë ta sjellë në gjendjen e dijes shpirtërore. Ja ky është "adhurimi". Që ky adhurim të arrijë qëllimin e tij, kjo është diçka që lidhet me pastrimin e vetes dhe me dëlirjen e zemrës, që do të thotë mbushje e njeriut me ndjenja të larta duke kapërcyer pengesat e vetes.

Pastrimi i vetes është një çështje e rëndësishme të cilën Allahu e ka theksuar duke u betuar herë pas here. Në suren Shems (dielli) thuhet:

**"PASHA diellin dhe dritën e tij! Pasha hënën kur vjen pas tij! Pasha ditën kur ai (dielli) e shëndrit! Pasha natën kur ajo e mbulon atë (dritën e diellit)! Pasha qiellin dhe Atë që e ndërtoi atë! Pasha tokën dhe Atë që e shtriu atë (e sheshoi)! Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë dhe që ia mësoi se cilat janë të këqiat dhe të mirat. Pra, patjetër ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten dhe ka humbur ai që e poshtëroi vetveten."** (Shems, 1-10)

Betimi i Allahut, në të vërtetë deklarimi hyjnor që shprehet pas betimit, përveç se tregon vlerën dhe nderin e atyre që betohen në të, ka për qëllim të tregojë madhështinë dhe rëndësinë e tyre. Edhe gjendja në këto ajete është e njëjtë, por ka vetëm këtë ndryshim:

Allahu betohet në këto ajete fisnike plotësisht dhjetë herë njëra pas tjetrës, pastaj, për të forcuar më shumë kuptimin, përdor pjesëzën **patjetër** dhe vetëm pas këtyre qortimeve dhe përforcimeve thotë:

**“Patjetër ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten dhe ka humbur ai që e poshtëroi vetveten!..”**

Është interesante edhe kjo: që Allahu në Kur’anin Fisnik nuk betohet njëmbëdhjetë herë në mënyrë njëra pas tjetrës përveçse në çështjen e pastrimit të vetes. Kjo e vërtetë është e mjaftueshme për të treguar se sa i rëndësishëm dhe i domosdoshëm është pastrimi i vetes për shpëtimin e njeriut.

Pastrimi në tasavvuf është thyerja e sundimit të vetes mbi trupin, duke i pakësuar dëshirat e saj e duke siguruar kësioj sundimin e shpirtit. Kjo mund të sigurohet vetëm me rrugën e rijadatit, domethënë me metoda të tilla si respekti ndaj normales në të ngrënë dhe në të pirë, në të fjetur dhe në të folur, me qëllim që këto ta forcojnë vullnetin kundra vetes. Për këtë arsye, në tasavvuf metoda për të frenuar veten është killelu’t-taam (të hash pak), killelu’l-menam (të flesh pak) dhe killelu’l-kelam (të flasësh pak), sepse këto janë hapat e parë të sundimit ndaj vetes. Megjithatë, si në çdo çështje tjetër, gjatë zbatimit të këtyre metodave nuk duhet ta lëmë normalen, sepse trupi është një amanet që Allahu ua ka dhënë njerëzve.

Në fakt, me luftën që bëhet kundra saj vetja nuk vdes por vetëm mund të merret nën kontroll. Ajo që kërkohet nuk është të shkatërrrojmë veten, por t’i kufizojmë dhe t’i edukojmë dëshirat e pasionet e saj me ligjet e përshtatshme ndaj kënaqësisë hyjnore, duke e larguar nga gjërat e tepërta.

Edhe një çështje tjetër e rëndësishme krahas pastrimit të vetes, është që ta sjellim zemrën në një gjendje të pastër dhe të dëlirë. Nisur nga xhevahiri i saj i vërtetë, zemra është “vendi” ku shikon Zoti i ma-

dhëruar. Domethënë ka nderin për të qenë vendi që sheh Zoti, por siç nuk është e mundur që në fronin e një saraji të ulet dikush tjetër përveç sulltanit, edhe zemra që është saraji i gjithëçkaje duhet të pastrohet nga mendimet vetjake, nga pasionet e shëmtuara dhe nga gjërat e kësaj bote, përveçse nga Allahu. Në të kundërt, zemra mbyllet ndaj të mirave hyjnore, por kjo nuk do të thotë se nuk mund të dojë dikë tjetër përveç Allahut. Në të vërtetë, ata të cilët arrijnë në kulmin e zemrës së shëndoshë duke e pastruar veten dhe duke e dëlirur zemrën, janë liruar nga dashuria e gjërave të kësaj bote, por njerëzit e tjerë, nuk kanë mundur ta fshijnë plotësisht nga zemrat e tyre dashurinë ndaj pasurisë dhe fëmijëve. Në të vërtetë, kjo lloj dashurie është e lejueshme derisa të mos kalojë një kufi të caktuar.

Për të perceptuar rëndësinë e dëlirjes së zemrës, është e mjaftueshme të shikosh pozitën e zemrës në jetën materiale dhe shpirtërore. Pejgamberi ﷺ e ka shprehur kështu rëndësinë jetësore të zemrës:

*“...Njeriu në trupin e tij ka një copë mish. Nëse ajo copë bëhet e fortë dhe e devotshme, po ashtu i tërë trupi bëhet i mirë, nëse ajo bëhet e keqe, po ashtu i tërë trupi bëhet i keq. Kini kujdes, ajo është **zemra**.”* (Buhari, Iman, 39)

Mevlana, thotë se të mbushësh një thes pa ia mbyllur vrimën që ka në fund, është një punë boshe. Kështu edhe veprat, vetëm kur të kryhen me një zemër të pastër dhe të dëlirë, mund të bëhen shkak për lumturinë e njeriut, sepse veprat janë të lidhura me nijetet dhe nijeti është një nga veprat e zemrës. Nisur nga kjo, është kusht që nijeti të rregullohet dhe të zbukurohet me sinqeritet.

Kjo është një gjendje që mund të fitohet vetëm si rezultat i edukimit shpirtëror që zbatohet si duhet. Pika që kanë për qëllim miqtë e Zotit në edukimin e zemrës, është që zemra të ketë një ndërgjegje për të qenë vazhdimisht me Allahun, që kështu të bëhet një zemër e gjallë. Që zemra të arrijë në këtë gradë, duhet të jetë e pastruar nga çdo gjë e kësaj bote, përveç Allahut.



Zemra e cila e arrin këtë gradë, i kupton të vërtetat delikate dhe të thella. Aq sa ç'bëhet e butë duke shpëtuar nga ashpërsia, zemra bëhet po aq një vend që reflekton emrat dhe të fshehtat hyjnore. Kështu fitohet marifetullah, që do të thotë ta njohësh Zotin me rrugën e zemrës. Kjo do të thotë se dija ka ardhur në gjendjen e dijes shpirtërore.

Ata që dalin para Allahut me zemër të shëndoshë, domethënë me zemër të pastër dhe të mbushur me dashuri hyjnore, me një zemër e cila është e pastruar nga të gjitha sëmundjet shpirtërore, do të shpëtojnë. Këtë Allahu e tregon kështu:

**“Atë ditën nuk bën dobi as malli dhe as fëmijët. Vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë.”** (Shuara, 88-89)

Për të pasur një vete mutmain (të sigurtë, të bindur) dhe një zemër të shëndoshë si rezultat i pastrimit dhe i dëlirjes shpirtërore, ka disa kushte që duhen respektuar. Këto janë:

- a. Ushqimi hallall
- b. Istigfari dhe lutja
- c. Leximi i Kur'anit dhe zbatimi i ligjeve të tij
- ç. Kryerja e adhurimeve me hushu (frikërespekt)
- d. Shpenzimi në rrugë të Allahut
- e. Falja namaz natën
- f. Dhikri dhe meditimi
- g. Dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut dhe vazhdimi i salavateve fisnike
- gj. Mendimi i vdekjes
- i. Qëndrimi me të devotshmit dhe të sinqertët
- j. Posedimi i moralit të bukur

Zemra e shëndoshë që fitohet si rezultat i të qëndruarit me seriozitet, duke i jetuar me përpjekje të gjitha këto kushte, ka ardhur në një gjendje pasqyre të pastër në të cilën shfaqen cilësitë e bukura të Zotit. Kur Allahu Teala shikon shfaqjet e cilësive të bukura në zemrën e robit, e do atë dhe kënaqet nga ai.

Zoti është krijuesi dhe zotëruesi i gjithçkaje. Për këtë arsye, Ai nuk ka nevojë për krijesat. Nuk ka asnjë lloj dhurate që mund t'i dërgohet, që të mos gjendet në thesarin e Tij. Ai është burimi i të gjitha të mirave dhe i të gjitha bukurive. Për këtë arsye, gjëja më e bukur dhe më e vlefshme të krijesat është një "zemër" e pastër dhe e dëlirë, e cila mund të bëhet pasqyrë e esmau'l-husna, domethënë e emrave të bukur të Allahut. Për këtë arsye, dhurata më e përshtatshme që mund t'i paraqitet Zotit, është "zemra e shëndoshë", që Zoti i madhërisëm e do nga ne.

## 22) Cili është qëllimi i namazit të natës?

Njeriu mund t'i hedhë nga vetja shqetësimet materialo-shpirtërore të ditës duke u kthyer në botën e vet të brendshme dhe duke u strehuar nën qetësinë e natës. Ditët nuk mundën ta japin prehjen shpirtërore dhe shëndetësore të natës. Dhe ata që nuk e njohin dhuntinë e natës, e kanë të pamundur ta mendojnë të mirën e ditës!

Për të hyrë në peizazhet hyjnore dhe shpirtërore të natës, është e domosdoshme që nata të përdoret me qëllim të caktuar.

Për njerëzit e zemrës nuk ka kohë më të begatë se qetësia e natës. Duhet që, duke e kaluar natën pjesërisht zgjuar, të përfitohet prej begatisë së saj. Në lidhje me këtë specifike, në Kur'an urdhërohet:

**"... Ata ngrihen nga shtretërit dhe luten duke u frikësuar prej Zotit të tyre e duke shpresuar mëshirën e Tij. Dhe japin në rrugë të dobishme nga ajo me të cilën i kemi furnizuar!"** (Sexhde, 16)

Si dhe:

**"Dhe bëji sexhde Atij në një pjesë të natës dhe madhëroje Atë në një pjesë të gjatë të natës!"** (Insan, 25-26)

Vlerat që i ka dhënë Zoti natës dhe të fshehtat e vendosura brenda saj janë të panumërta. Sekretet e mënyrës së shprehjes së ajeteve në vijim është një dritare hyjnore e hapur për ne për të na dhënë mundësi të sodisim shumë e shumë të vërteta!

**“Betohe me në natën dhe në errësirën e saj që mbështjell çdo gjë, se...”** (Inshikak, 17) **Betohe me në natën kur bie qetësia, se...”** (Duha, 2) **Betohe me në natën kur fillon të bjerë errësira, dhe në mëngjesin kur fillon të zbardhë!”** (Tekvir, 17-18)

Për besimtarët që kanë arritur pjekurinë, netët janë një pasuri e veçantë si rrjedhojë e qetësisë dhe begatisë së thellësisë së tyre. Ata që e njohin siç duhet vlerën e kësaj pasurie, veçanërisht pas mesit të natës, atëherë kur e gjithë qenia tërhiqet në pushim dhe tërë bota përfshihet nga qetësia, me lutje, adhurime dhe përgjërime të djegura, gjejnë truallin më të begatë të kthimit kah Zoti.

Në lidhje me kalimin zgjuar të netëve dhe agimeve, Zoti shprehet kështu për robtë e Tij fatlumë të cilët i lavdëron duke thënë se do të meritojnë dhunti hyjnore meqë janë ruajtur prej Tij:

**“Ata të bindurit flenë pak netëve dhe, në kohën e agimit, vazhdojnë me pendesë!”** (Dharijat, 17-18)

Si dhe:

**“(Robtë e Mëshiruesit që) E gdhijnë natën duke qëndruar në këmbë dhe duke rënë në sexhde para Zotit të tyre!”** (Furkan, 64)

Në një ajet tjetër, Zoti urdhëron kështu:

**“(O i Dërguar!) Allahu sheh se ti, kur ngrihesh natën (për namaz), përsille me atyre që bëjnë sexhde...”** (Shuara, 218-219)

Në lidhje me këtë ajet, Kadi Bejdaviu thotë kështu:

“Kur pesë kohë namaz u bënë farz për ummetin, kurse namazi i natës u kthye në sunnet, Profeti ﷺ ka dalë natën nga shtëpia për të parë se ç’bëjnë sahabet, është përsjellur mes shtëpive të tyre dhe ka vënë re se ato zjenin si koshere bletësh me zërat e këndimit të Kur’anit, dhikrit dhe tespive.”

Allahu i jep më shumë vlerë zikrit (dhikrit) të bërë në kohën e zbardhjes në mbarim të natës, në krahasim me dhikrin e bërë në kohë të tjera, sepse marrja me dhikër dhe adhurim në kohën e zbardhjes është më e vështirë se në kohët e tjera. Është për këtë shkak që kalimi zgjuar në kohën e zbardhjes është shprehje e dashurisë së pastër dhe e madhërimit që ndjen rob për Zotin e vet.

Po qe se besimtari mundet ta përdorë natën në mënyrë të qëllimshme dhe përfiton shpirtërisht nga dhikri në kohën e zbardhjes, nata i bëhet më e ndriçuar dhe më e dobishme se dita. Kurse nata e kaluar pa qëllim dhe e dënuar me gjumë, është si shiu që bie mbi gur, det dhe shkretëtirë dhe një humbje e pazëvendësueshme. Edhe dita e një nate të tillë është shpirtërisht e errët.

Po qe se fryma shpirtërore e tevhidit që fillon në zbardhje na i përfshin ditët dhe zemrat, edhe fryma jonë e fundit, domethënë vdekja që është lamtumira e madhe ndaj çdo gjëje në këtë botë, në dashtë Zoti, me frymën shpirtërore të Fjalës së Tevhidit, kthehet në “natë dasme”!

Abdullah bin Amr bin As رضي الله عنه ka bërë të ditur se Profeti ﷺ ia ka tërhequr vëmendjen në këtë mënyrë:

*“O Abdullah, mos u bëj si filani që, ndërsa vazhdonte të bënte adhurim natën, tani nuk ngrihet më!”* (Buhari, Tehexhxhud, 19; Muslim, Sijam, 185)

Duke iu drejtuar sahabeve, shokëve të tij, Profeti u ka thënë kë-shtu:

*“Kini kujdes për adhurimin e natës, sepse është zakoni i njerëzve të mirë para jush! Pa dyshim, ngritja për adhurim natën është pretekst për t’u afruar Zotit, pengon nga mëkatet, bëhet kundërshtim për gabimet dhe i lehtëson dhimbjet e trupit!” (Tirmidhi, Deavat, 101)*

Nga ana mjekësore është saktësuar se zgjimi natën është me rëndësi edhe për shëndetin e trupit të njeriut. Me të vërtetë, ata që ngrihen nga një gjumë i gjatë, kanë dhimbje koke. Kjo dukuri është rezultat i ngadalësimit të frymëmarrjes dhe mosushqimit të zemrës me sasi të mjaftueshme oksigjeni. Ata që e ndërpresin gjumin, meqë e normalizojnë frymëmarrjen me anë të lëvizjeve, megjithëse flenë pak, ngrihen nga shtrati më të gjallë.

Ndërkaq, edhe nëse urdhrat e fesë që nuk janë për dobi të tilla materiale të kësaj bote, janë vënë me qëllim për të realizuar adhurimin ndaj Allahut, në secilin prej tyre janë të pranishme edhe dobi të tilla materiale. Edhe në namaz, agjërim dhe në adhurime të tjera ka urtësi dhe përfitime materiale të tilla. Por, natyrisht, këto nuk janë shkak i ekzistencës së atyre adhurimeve, por ndikime të anshme të dobishme.

## 23) Cila është natyra e dashurisë së vërtetë? Si duhet të orientohet dashuria jonë?

Dashuria është ëmbëlsia, gëzimi, qetësia dhe hareja e jetës sonë. Brumi i ekzistencës është rrahur me majanë e dashurisë. Fuqia e dashurisë është nga mirësitë më të mëdha që Zoti ua ka dhënë robërve të tij. Për këtë arsye është e nevojshme që dashurinë ta mbajmë në zemra që kanë arritur të vërtetën e miqësisë, por sa keq që shumë njerëz e harxhojnë dashurinë në rrugë të përkohshme dhe për dëshirat vetjake. Çfarë vlere dhe nderi mund të ketë një zemër e cila është ngurtësuar aq shumë, sa të mos ndjejë nevojë dashurie për Zotin e tij?

Për ata që e privojnë veten nga dashuria për Allahun, duke e harxhuar dhuratën e dashurisë në rrugën e gjërave të përkohshme dhe relative, Mevlana jep këtë shembull mësimdhënës:

*“Ata që i japin zemrën kësaj bote, janë krejt si gjuetari që gjuan në hije. Si mund të jetë hija gjahu i tyre? Po ashtu një gjuetar i çmendur kujtoi se hija e zogut ishte zog dhe deshi ta kapte, por edhe zogu që ishte në degë u habit ndaj kësaj çmendurie.”*

Të ndjekësh njëri nga faqet e dashurisë së përkohëshme si pasuria, prona, pozita, paraja, familja dhe fëmijët dhe duke harruar **“Takimin**

**me Allahun**", që është qëllimi i fundit ku do të arrihet, kjo do të thotë humbje e botës shpirtërore. Një poet e ka sqaruar kështu këtë të vërtetë: *Nxirr nga zemra jote gjithçka, që Zoti të mbetet në zemrën tënde,*

*Padishahu nuk hyn në saraj pa u ndërtuar e gjitha...*

Fitorja e të çmendurit është mosndjekja e Lejlës që ia ngatërronte mendjen dhe mendimet, domethënë mospranimi i saj si gjëja e fundit në rrugën e Zotit. Lejla në këtë rrugë të vështirë për dikë ishte një lloj i kundërt, për dikë pasuri dhe për dikë pozitë. Këto dashuri, që janë quajtur figurative, patjetër duhet të bëhen urë e dashurisë së vërtetë.

#### **a. Dashuria ndaj Allahut** (Muhabbetullah)

Njeriu fiton një gradë në lidhje me përshtatjen ndaj qenies për të cilën ndjen dashuri. Duke u udhëhequr nga prirja për të dashur, gjë që është në natyrën e saj, zemra e njeriut arrin përsosmërinë në dashuri vetëm kur t'ia drejtojë atë Allahut, sepse e vetmja qenie që e meriton dashurinë e vërtetë, është Allahu Teala, i cili është edhe burimi i të gjitha dashurive. Sepse:

-Ai është krijuesi i çdo gjëje, është Ai u jep shpirt dhe rizk krijesave, i vetmi që është i përsosur, i fortë, absolut dhe që i mbron dhe kujdeset për to.

-Ai i do shumë robërit e tij. E krijoi Ademin në xhennet në formën më të bukur dhe me një përkujdesje të madhe. Ai dëshiron që edhe robërit e tij të hyjnë në xhennet. Shpërblimi i dashurisë është vetëm dashuria.<sup>11</sup>

-Ai ua ka lehtësuar robërve rrugët e takimit dhe të dashurisë për te Ai.

---

11. Shih. El-Maide, 54.



-Ai është sunduesi i vetëm i kësaj bote dhe i ahiretit.

-Më në fund njeriu do të dalë përpara Allahut dhe nuk do të gjejë asnjë vend strehimi dhe ndihme përveç Atij. Sa i mirë dhe sa ndihmues është Allahu, i cili është Zoti i botrave!

-Krahas gjithë këtyre mirësive hyjnore që kemi, borxhi ynë për fale.

### **b. Dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut**

Pika më e lartë që duhet të arrihet në frazat e dashurisë njerëzore, është dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ. Asnjë njeri nuk mund të imagjinohet se e meriton më shumë dashurinë njerëzore se sa Ai, sepse: -Të gjitha krijesat ia kanë borxh ekzistencën e tyre dashurisë që Allahu ka për Pejgamberin.

-Duke e njohur botën e njerëzve dhe të xhindëve me të vërtetën e pafillimtë dhe të pafund, i Dërguari i Allahut ﷺ është bërë shkak që ata të shpëtojnë nga ndëshkimi i përhershëm në ahiret.

-Allahu Teala ua ka shfaqur robërve të tij mirësitë e Kur'anit dhe të Islamit përmes zemrës së pastër të Pejgamberit.

-Atij i kanë ndodhur vështirësi dhe vuajtje aq sa s'i kanë ndodhur asnjë njeriu dhe ai i ka përballuar ato për hir të ummetit.

-Ai është i mëshirshëm ndaj besimtarëve. Ai është një det mëshire. Ai e do shumë ummetin e tij dhe atij i vjen shumë rëndë për vuajtjet e tyre.<sup>12</sup>

-Ai është një personalitet shembullor dhe ideal në adhurim.

-Përsëri Ai është ndërmjetësuesi më i mirë që i dërgon robërit te njësimi në Allahun Teala.

---

12. Teube,128

-Duke u betuar vetëm në jetën e Muhammedit ﷺ mes të gjithë pejgamberëve të tjerë, Allahu ka thënë: **“Betohem në jetën tënde!”**, dhe kështu ka urdhëruar që ummeti i tij të mendojë shumë për jetën e të Dërguarit të Allahut, e cila është usve hasene.

- Dashurinë dhe faljen e Tij Allahu e ka lidhur me kushtin e bindjes ndaj Pejgamberit. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Thuaj: Nëse e doni Allahun, më ndiqni mua ashtu që edhe Allahu tju dojë ju dhe t’i falë mëkatet tuaja. Allahu fal shumë dhe është mëshirues.”** (Ali Imran, 31)

-Dashuria që kemi ndaj të Dërguarit të Allahut është një shkak për të shpëtuar nga ndëshkimi hyjnor, sepse Zoti thotë:

**“Allahu nuk do t’i dënojë ata derisa Ti je në mësin e tyre!..”**  
(Enfal, 33)

Më e rëndësishmja është se Allahu e do Atë dhe e ka nderuar me lavdërimin Habibi, i dashuri im.<sup>13</sup> Sa nder i madh është të duash të Dashurin e Allahut!

Atëherë, me shkrimin e një dashurie që nuk fshihet kurrë, ashtu që zemrat tona të fillojnë të fitojnë përputhshmëri ndaj vlerës së lartë që i është dhënë Atij, le t’i gdhendim në zemrat tona salavatet dhe emrin e nderuar të Tij, sulltanit të pashoq.

Por duhet të themi edhe këtë: që edhe Pejgamberi ﷺ, nuk është qëllimi i fundit në dashuri. Qënia e vetme që njeriu duhet t’ia kushtojë dashurinë, është Allahu Teala, krijuesi i gjithësisë. Ndërsa dashuria që kemi për të Nderuarin Tonë është një shkas dhe rrugë që na prin kah njësimi dhe dashuria e Allahut.

13. Shih. Tirmidhi, Menakib, 1/3616; Darimi, Mukaddime, 8; Ahmed, VI, 241; Hjsemi, IX, 29.

### c. Dashuria ndaj vëllait në fe

Kur të shtohet në zemrën e robit dashuria ndaj Allahut, është e nevojshme që, së pari kjo dashuri të dojë Dritën e Muhammedit, pastaj ekzistencën e Pejgamber, pastaj miqtë e Zotit dhe më pas, duke u zgjeruar dora-dorës të dojë çdo krijesë që është e pranuar te Allahu sipas shkallës së pranimit. Ja, një sferë e tillë dashurie e drejtuar për te Allahu, përbën një burim shërimi dhe mëshire për shpirtrat. Për këtë arsye, në marrëdhëniet ndërmjet tyre besimtarët nuk duhet të dalin kurrë jashtë kësaj sfere mëshire dhe dashurie, sepse ky është rezultati i saj, dashuria ndaj Allahut dhe rruga për shfaqjen e afrimitetit ndaj Tij.

Në Kur'anin Fisnik, Allahu Teala thotë se besimtarët janë vëllezër.<sup>14</sup> Edhe i Nderuari ynë ﷺ thotë se nuk mund të arrihet besimi i përsosur pa u krijuar një lidhje e fortë dashurie ndërmjet vëllezërve në fe. Për krijimin e kësaj dashurie, Ai e ka porositur ummetin e Tij që të shpërndajnë selamin ndërmjet tyre. (Muslim, Iman 93-94.)

Dashuria e besimtarëve ndaj njëri-tjetrit është një veti e bukur me të cilën Allahu është i kënaqur. Edhe lumturia e të dy botrave është e lidhur me këtë dashuri. Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë, ka thënë:

*"Në ditën e kiametit Allahut Teala do të thotë: Për hir të madhërisë sime, ku janë ata që e kanë dashur njëri tjetrin me qëllim për të m'u bindur Mua? Sot kur nuk gjendet asnjë hije, do t'i marr ata në hijen Time dhe do t'i mbroj!"* (Muslim, Birr, 37)

*"Allahu Teala thotë: Për ata që e kanë dashur njëri-tjetrin për hir Tim, do të ketë minbere drite të cilat edhe pejgamberët dhe dëshmorët do t'i kenë zili!"* (Tirmidhi, Zuhd, 53/2390)

---

14. Huxhurat, 10.

Në një tjetër hadith fisnik tregohet se ditën kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Tij, Allahu do t'i marrë në hijen e Arshit.<sup>30</sup> Vëllazërit në fe, ata të cilët kanë dashur njëri-tjetrin për hir të Allahut dhe që takimet dhe ndarjet e tyre i kanë bërë vetëm për hir të Allahut. Sigurisht, kjo është dashuria vëllazërore e kohërave të vështira dhe të mundimshme.

Edhe zemërimet e vëllazërve besimtarë ndërmjet njëri-tjetrit janë sjellje të këqija të cilat asnjëherë nuk janë konsideruar të drejta. I Dërguari i Allahut ﷺ thotë:

*“Nuk është hallall që një besimtar ta lërë vëllain e tij në fe dhe të rrijë i zemëruar me të më shumë se tre dite. Pasi të kalojnë tre ditë të takohet me të dhe ti japë selam. Nëse tjetri e pranon selamin e tij, që të dy kanë sevape. Nëse nuk e pranon, ai që nuk e pranon ka bërë mëkat, dhe ai që ka dhënë selamin ka dalë nga zemërimi.”* (Ebu Davud, Edeb, 47/4912)

*“Kush e lë vëllain e tij në fe një vit dhe rri i zemëruar, ka hyrë në mëkat sikur t'i ketë derdhur gjakun.”* (Ebu Davud, Edeb, 47/4915)

Sipas haditheve të Pejgamberit ﷺ, veprat që kanë bërë njerëzit i paraqiten Allahut Teala ditën e hënë dhe ditën e enjte. Çdo robi që nuk ka bërë shirk, i falën mëkatet, përveç atij që ka armiqësi me vëllain në fe. Engjëjve u thuhet shpesh: “Vonojeni faljen e tyre, derisa të pajtohen me njëri-tjetrin!” (Muslim, Birr, 35-36; Ebu Davud, Edeb, 47)

#### **d. Dashuria ndaj të gjitha krijesave**

Të gjithë krijesat janë krijuar për t'i shërbyer njeriut, për t'i shërbyer si shembull dhe sërish i janë dhënë amanet njeriut në këtë botë. Për këtë arsye, njeriu e ka si borxh ndërgjegjeje që t'u afrohet me dashuri të gjithë krijesave.

Bleta jeton për t'i dhënë mjaltë njeriut. Delja, gjatë gjithë jetës së saj i jep njeriut qumësht, lesh, qengja dhe mish. Macja dhe qeni përsëri

janë nën urdhrin e njeriut. Edhe krijesat si gjarpri, shumëkëmbëshi dhe arkrepi, që janë një formë e shfaqjes së lartë të Zotit, për shkak se janë krijuar për të përkujtuar ndëshkimin e Allahut dhe detyrat e shumta që kanë në natyrë, përfshihen në mirësitë që i janë dhënë njeriut. Guri, dheu, pema, reja, mali dhe lugina janë vetëm për njeriun...

Po ashtu në ajetin fisnik thuhet:

**“Ai nënshtroi për ju gjithçka që ka në qiej dhe në tokë. Me të vërtetë në këtë ka argumente për një popull që mendon.”** (Xhathije, 13)

Të dhunosh krijesat që janë nën shërbimin tonë, është një poshtërsi që në fund të fundit do ta vuajmë ne. Ndërsa t’u bësh padrejtësi kafshëve, është një mëkat i rëndë, i cili do të na dalë përpara në ditën e gjyqimit. Në ajetin fisnik thuhet:

**“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë dhe as shpend që fluturojnë me krahë që të mos jenë të ndara në grupe (të ndryshme) ashtu siç u ka krijuar Zoti edhe ju. Ne nuk kemi lënë gjë mangët në libër (në leuhi’l-mahfudh). Së fundi të gjithë do të tubohen te Zoti i tyre.”** (En’am, 38)

Nga një aspekt tjetër, dashuria ndaj krijesave për hir të Krijuesit është një detyrë e robit.

Edhe krijesat e tjera kanë të drejtat e tyre në këtë botë dhe në mirësitë e saj. Marrja e hakut të tyre është një llogari e madhe që do të jepet në ditën e kiametit.

Sa bukur thotë poeti Firdeusi në librin e tij me titull *Shehname*:

*“Mos lëndo qoftë edhe një milingonë që tërheq një kokërr gruri, sepse edhe ajo ka shpirt. Ndërsa shpirti është i ëmbël dhe i dhembshur.”*

Pejgamberi ﷺ e ka ndaluar vrasjen e kafshëve pa dobi, pa vend dhe për argëtim. Në një hadith fisnik thuhet kështu: *“Kush vret një harabel pa vend vetëm për t’u argëtuar, në ditën e kiametit harabeli, duke u ankuar te Allahu, do t’i thotë:*

*-O Zoti im! Filan njeri më ka vrarë pa vend dhe jo për ndonjë dobi!"*

(Nesai, Dahaja, 42)

Në ditën e gjykimi do të ringjallet të gjithë përfshirë edhe kafshët. Pasi kafshët të marrin të drejtën e tyre prej atyre që i kanë bërë padrejtësi do të shndërrohen në dhe. Kur mosbesimtarët të shikojnë këtë gjendje do të shpresojnë të shndërrohen në dhe si kafshët.

**"Ah sikur të isha dhé!"** (Nebe, 40.)

Për të mos patur pendime të tilla duhet që në këtë botë të respektojnë urdhëresat e Allahut.

## 24) Çfarë është lidhja shpirtërore?

Kuptimi leksikor i fjalës “rabita” është “lidhje dhe interesim”. Me këtë aspekt, në fakt, në gjithësi nuk ka asnjë gjallesë pa lidhje dhe interesim. Çdo gjë është e lidhur me marrëdhënie të ndërsjelltja me të tjerat. E shprehur ndryshe, rabita, lidhja dhe interesimi, janë shfaqje e dashurisë (muhabbet) e cila përbën thelbin e ekzistencës, janë dhënia vazhdimësi freskisë dhe gjallërisë së dashurisë.

Janë tri lloje lidhjesh (rabita):

### 1) Lidhja e natyrshme (tabii):

Është afërsia dhe dashuria që ndjen individi ndaj individëve të tjerë të afërm. Kjo është produkt i motiveve shtytëse të bashkëlindura, si dashuria e nënës për fëmijën.

### 2) Lidhja e ulët (thufli):

Është lidhja ndaj prirjeve djallëzore të ndaluara, si preokupimi i vazhdueshëm i zemrës së një kumarxhiu me kumarin aq sa kumarxhiu të harrojë familjen!

### 3) Lidhja e lartë ose sublime (ulvi):

Është lidhja ose interesimi për pretekstet të cilat, me anë të koncepteve të shenjta dhe ndjenjave të larta e sublime, e çojnë njeriun te Allahu. Është konfidenca e vazhdueshme (e pandërprerë) faktike ose ideore me persona që kanë arritur pozitën e shkëlqimit të zemrës (shkëlqimit afektiv) dhe vëzhgimit hyjnor, me qëllim për të përfituar nga bota dhe vlerat shpirtërore të tyre.

Njeriu, është një qenie e hapur ndaj ndikimeve. Ashtu siç ndodh në rastin e disa sëmundjeve ngjitëse, edhe "gjendjet" e njeriut kanë cilësinë e "infektimit". Marrëdhënia e brendshme ndërmjet shpirtëve, është një e vërtetë e cila nuk mund të mohohet. Prirjet e forta shpirtërore të personaliteteve me cilësi aktive dhe ndikuese, pak a shumë -sipas aftësive të tyre shpirtërore- kalojnë edhe tek ata që ndodhen pranë tyre. Ky kalim, nuk varet nga cilësia e "gjendjes" që i ndikon ata, pra, a është negative apo pozitive, por sidoqoftë, ky kalim realizohet. Mjafton që midis tyre të ketë lidhje dashurie e miqësie.

Për shembull, gjendjet e njerëzve me mëshirë të jashtëzakonshme, altruistë e flijues, ndikojnë edhe bashkësinë ku ata ndodhen. Lidhja, që është një shfaqje e dashurisë, duhet për të shtuar marrëdhëniet shpirtërore me cilësi të tilla morale, për t'i shpejtuar dhe për t'i shndërruar ato në një moral më të lartë. Për këtë arsye, një besimtar me mendje të shëndoshë, duke ndjerë dashuri ndaj njerëzve të mirë e të devotshëm dhe duke formuar miqësi me ta, duhet të përpiqet t'i reflektojë në nivelin më të lartë gjendjet e tyre të mrekullueshme.

Për fat të keq, mendja e cila shqetësohet nga spërkatja me baltë ndaj një robe të bukur e të pastër, nëse nuk është ndriçuar me dritën e shpalljes hyjnore, në përgjithësi nuk ndikohet aspak nga pushtimi i shpirtit prej veseve të këqija të zemrave që janë nxirë nga gjynahet. Për shkak se ai ndodhet nën narkozën shpirtërore të tundimeve egoiste e djallëzore, nuk e ndjen aspak këtë shqetësim shpirtëror. Prandaj, duhet hapur syri i zemrës dhe të llogaritet mirë fitimi dhe



humbja e përjetshme, sepse përkrah ndikimeve pozitive, njeriu është lënë i lirë të zgjedhë edhe ndikimet negative. Mirëpo, Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik na e ka bërë të ditur se cila është zgjedhja më e drejtë që duhet të bëjë njeriu:

**“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me të drejtët (sinqertët në fjalë dhe në vepra)!”** (Teube, 119)

Nëse vihet re, Allahu i Madhëruar, në këtë ajet nuk u ka thënë robërve të Tij “bëhuni të drejtë!”, por për ta ruajtur devotshmërinë, i ka urdhëruar “të qëndrojnë së bashku me të drejtët”, sepse hapi i parë që hidhet në rrugën e së drejtës, është qëndrimi me njerëzit e drejtë, pra të kesh lidhje dashurie e miqësie me ta. Të jesh i drejtë, është rezultati i natyrshëm i kësaj gjendjeje.

Shprehja «bëhuni me të drejtët!», e cila kalon në ajet, shpreh qëndrimin e vazhdueshëm me të drejtët. Urdhri «bëhuni!» është absolut dhe përfshin edhe kuptimin e drejtpërdrejtë, edhe kuptimin indirekt të fjalës. Pra, në kuptimin e drejtpërdrejtë duke qëndruar fizikisht së bashku me njerëzit e drejtë dhe në kuptimin indirekt, duke i përfytyruar dhe vepruar si ata në mungesë të tyre.”

Të qenit bashkë me njerëzit e mirë e të drejtë, ndikon në zbutjen e egos, ashtu si radioaktiviteti, i cili nuk shihet por që ka një rezultat absolut. Kështu është edhe të gjendesh përreth njerëzve të mirë, të shohësh sjelljen dhe veprimet e tyre, madje edhe të shohësh fytyrën e tyre plot dritë. Për këtë arsye, të gjendesh pranë njerëzve me ndikim të lart shpirtëror, është një mirësi shumë e madhe. Kjo, sepse gjendjet e tyre kalojnë edhe tek të tjerët. Ashtu si njeriu i cili kur gjendet në një kopsht me trëndafila i ngjitet në trup aroma e trëndafilit, ashtu edhe vendi ku gjenden njerëzit e drejtë, ka një ndikim shpirtëror i cili u ngjitet edhe atyre që u ndodhen pranë. Sepse, dashuria është si një linjë elektrike midis dy zemrave.

Këtu, synohet që edukata dhe dashuria e cila tregohet në prezencë të mësuesit, të tregohet edhe në mungesë të tij. Që mendja njerëzore të shohë apo të ndjejë diçka abstrakte, ka nevojë ta përngajë atë me një send apo t'i japë asaj një formë. Për shembull, dija ekspozohet tek dijetari, dashuria tek i dashuruari dhe arti tek artisti. Pra, është e pamundur të prezantosh abstrakten pa një ekspozim.

Në këtë mënyrë, në saj të lidhjes (rabëta), cilësitë shpirtërore në zemrën e mësuesit, kalojnë edhe tek nxënësi i tij. Kuptimi i vërtetë i lidhjes, është që edukata dhe ndjenjat e larta që tregohen në praninë fizike të mësuesit, të vazhdojnë gjendjen e tyre të bashkimit shpirtëror edhe në mungesë të mësuesit. Kjo, sepse jo gjithmonë është e mundur të jemi fizikisht pranë robërve të mirë e të devotshëm të Allahut.



### **Mendimi mbi vdekjen ka një ndikim të madh në gjendjen dhe sjelljet e njeriut.**

#### **Pejgamberi ﷺ thotë:**

“Kujtojeni shpesh vdekjen, e cila ua pret si me thikë të gjitha kënaqësitë!” (Tirmidhi, Zuhd, 4)

Një sahab, e pyeti Rasulallahun ﷺ:

- Cili prej besimtarëve është më i mençur o Rasulallah?

Rasulallahun ﷺ, u përgjigj duke thënë:

“- Ai që e kujton shpesh vdekjen dhe përgatitet mirë për pasvdekjes. Ja pra, ata janë njerëzit më të mençur...” (Ibn Maxhe, Zuhd, 31)

Me të vërtetë meditimi mbi vdekjen minimizon dashurinë për këtë botë dhe e orienton njeriun për në botë tjetër. Dhënia pas mirësive të përkohshme të kësaj bote është një nga sëmundjet më të përhapura që shkaktojnë probleme shpirtërore.

Për t'u ruajtur nga kurthet e kësaj bote duhet që vazhdimisht të përkujtojmë dhe meditojmë mbi vdekjen.

**Allahu na i bëftë zemrat burim dashurie dhe dhikri.**

**Amin!..**

## 25) Përse është i rëndësishëm qëndrimi me njerëz të mirë?

Sipas një hadithi profetik të rrëfyer nga Enesi رضي الله عنه, Allahu i Lartë ka një sërë engjëj shëtitës që kërkojnë vazhdimisht kuvendet ku bëhet dhikër dhe zhvillohen biseda shpirtërore. Kur hasin në një kuvend të tillë, radhiten rrotull tij dhe thonë:

“Zoti ynë! Këta njerëz këndojnë Librin tënd, i dërgojnë përshëndetje Profetit duke u lutur për paqe e mëshirë për të dhe kërkojnë prej teje gjërat e nevojshme të kësaj bote e të jetës së pasme.”

Dhe Zoti urdhëron e thotë:

“Bëhuni dëshmitarë: qofshin të falur!”

Ndërkaq, engjëjt shtojnë:

“Zoti ynë! Por mes tyre janë edhe filani e filani që kanë hyrë aty gabimisht!” Por Zoti thotë:

“Ata robtë e mirë dhe besnikë janë një shoqëri e tillë që, kush ndodhet së bashku me ta, nuk mund të quhet i keq!” (Tergib, II, 402)

Sihariqet e dhëna këtu në lidhje me çështjen e shoqërimit me

njerëzit e mirë dhe besnikë, janë një nxitje me karakter të brendshëm, një nxitje që i drejtohet botës së brendshme të njeriut, sepse, për ta mbrojtur zemrën nga vanitetet dhe për ta bërë atë vazhdimisht objekt të sugjerimeve për të mira e dobi, **janë të domosdoshëm shoqërimi, konfidenca dhe intimiteti me njerëzit e zemrës, me njerëzit e mirë e besnikë me qëllim për të marrë frymëzim prej botës së tyre shpirtërore.** Nuk duhet harruar se, ndërsa organet e tjera kanë vullnet, zemra s'ka; ajo është e prirur për t'u orientuar në atë drejtim që i kërkojnë sugjerimet që i vijnë prej mjedisit.

Zemra merr ngjyrën, formën dhe harmoninë e mjedisit ku ndodhet. Ndërkaq, për zemrën, ky është fillimi i situatës kur nisin të lëshojnë rrënjë për të zënë vend në të ndikime të ndryshme. Ndikimet pozitive dhe negative të formuara më vonë mund të jenë edhe pozitive, por edhe negative për shkak të ngjashmërisë ose kundërshtisë me të parat.

Po qe se zemra nuk mbrohet e formohet qysh në fillim me ndikime të mira, mbetet e hapur ndaj një rreziku të madh, sepse konfidenca (dashuria) e pranishme në zemër ndaj të gjitha ndikimeve, luan një rol pranues, kurse neveria dhe urrejtja luajnë një rol kundërshtues. Prandaj, gjatë ngritje-uljeve shpirtërore të njeriut, përdorimi me vend i konfidencës (dashurisë) dhe urrejtjes ka një rëndësi shumë të madhe.

Në veprën e tij "Gylistani", shejh Sadi shprehet në mënyrë krahasuese kështu, në lidhje me ndikimin e Profetit ﷺ, tek të dashurit e Allahut: Një njeri shkoi në hamam dhe një nga miqtë e tij i dha një copë argjile me erë të këndshme për t'u pastruar. Prej argjilës përhapej një aromë e këndshme, që të ledhatonte shpirtin. Prandaj dhe njeriu e pyeti argjilën:

- Ah, moj e bekuar! Mos je gjë misk apo amber? Aroma jote ma kënaqi shpirtin...

Argjila i thotë:

- Unë nuk jam as misk dhe as amber, por veçse një copë tokë. Por gjendem poshtë rrënjëve të një trëndafili dhe çdo mëngjes lagem prej pikave të vesës që bien nga gonxhet e tij. Pra, edhe aroma e këndshme që të kënaqi shpirtin, vjen prej atij trëndafili...

Ja, kështu, ata që i shtrojnë zemrat para miqve të Zotit me sinqeritet, nënshtrim dhe thjeshtësi, shndërrohen në vend- shfaqjen e bukurive që u drejtohen. Ashtu si hëna në qiell që, megjithëse s'ka dritë vetë, fiton veti dritëdhënëse duke e reflektuar dritën e marrë nga dielli, njerëz të tillë bëhen si kandilë ndriçues në natën njerëzore të mbuluar nga errësira!

**Zoti ynë! Dhurojua edhe zemrave tona bukuritë e bisedave mes Profetit ﷺ dhe shokëve të tij! Dhe na bashko ne me bashkësinë e njerëzve të mirë!**

**Amin...**

## **26) Si mund ta mbrojë veten një mysliman në-për vende të huaja? Ndaj cilave gjëra duhet të bëjë kujdes në marrëdhëniet me jomyslimanët?**

Allahu i Lartësuar e ka bërë të gjithë tokën një vend sprove për ne. Kudo që myslimani të ndodhet në këtë botë dhe në cilën shoqëri të që të gjendet, duhet ta shfaqë personalitetin dhe karakterin e Islamit.

Myslimani nuk duhet ta humbë vlerën e tij pikërisht si një flori, edhe nëse bie në baltë. Madje ai duhet të jetë shumë i kujdesshëm kundrejt gjendjes dhe sjelljeve të tij kur ndodhet nëpër vende të huaja. Ai nuk duhet ta nxjerrë nga mendja, se edhe një gabim krejt i vogël që mund të bëjë si individ, i faturohet Islamit. Duhet të bëjë kujdes me një përkushtim edhe më të madh ndaj sjelljeve negative që e dëmtojnë imazhin e Islamit.

Sikundër kësaj, duhet të mendojë se edhe sjelljet e bukura që mund të shfaqë, e shtojnë dashurinë dhe interesimin ndaj Islamit në zemrat e njerëzve dhe duhet të përpiqet për këtë. Ai duhet të përpiqet për t'ia treguar njerëzimit fytyrën e qeshur të Islamit me gjendjen dhe veprimet e tij. Këtë duhet ta konsiderojë si një mundësi për arritjen e lumturisë në botën e përtejme.

Transmetohet se **i Dërguari i Allahut** ﷺ i ka thënë **Aliut** dhe nëpërmjet tij të gjithë myslimanëve:

*“O Ali! Nëse Allahu e udhëzon një njeri me dorën tënde, kjo është më e mirë për ty se çdo gjë mbi të cilën lind dielli.”* (Hakim, Mustedrek, III, 690.)

Në Kuranin Fisnik thuhet si më poshtë në lidhje me këtë çështje:

**“...Nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve...”** (Maide, 32)

Resulullahu, ﷺ, i edukonte sahabët dhe më pas i dërgonte nëpër vende të huaja. Pra, i dërgonte në Kinë, Semerkand dhe Jemen.

Domethënë se një mysliman duhet detyrimisht të shfaqë personalitetin dhe karakterin Islam në çdo kohë dhe në çdo vend. Në këtë mënyrë mbron veten dhe bëhet shkak për udhëzimin e të tjerëve, nëse e ka kështu.

Shërbimi i predikimit të fesë është kapitali më i vlefshëm për botën tjetër. Por predikimi i fesë nuk bëhet vetëm me fjalë. Predikimi që bëhet duke u praktikuar, është predikimi më influencues.

Një ditë **Omeri** ﷺ, tha:

“Bëhuni ftuesit e njerëzve pa folur!” Atij i thanë:

“O kalif! Si mund të bëhemi ftues pa folur?”

Ai tha:

*“Me gjendjen dhe moralin tuaj...”*

Njerëzit mahnitën ndaj personalitetit dhe karakterit. Ata shkojnë pas karakterit dhe personalitetit të lartë. Për këtë arsye, cilësia dalluese e një myslimani të vërtetë është ekspozimi i personalitetit dhe karakterit Islam me mënyrën e të jetuarit.



Edhe këtë nuk duhet ta harrojmë; vlera e një fitoreje është sa vështirësitë që janë duruar për ta arritur atë. Pikërisht si bonusi që u jepet atyre që ushtrojnë detyrën në vende të vështira, aq i madh është edhe shpërblimi për ata që i zbatojnë urdhrat e Allahut dhe e predikojnë fenë në kushte të vështira.

Përveç të tjerash, nuk është e drejtë që shërbimin ndaj Islamit ta konsiderojmë si detyrë vetëm të klerikëve fetarë apo të atyre që kanë mbaruar fakultetin e teologjisë. Çdo mysliman duhet të jetë shërbëtori i fesë së tij.

Përgjatë gjithë historisë nderimi i shumë vendeve me udhëzimin e Islamit ka ndodhur nëpërmjet tregtarëve që kanë shfaqur moralin Islam. Ai që e jep udhëzimin është vetëm Allahu (xh.xh.). Ajo që duhet të bëjë njeriu është që të përpiqet aq sa ka mundësi në këtë rrugë.

Njerëzit mahniten mbas njerëzve me karakter dhe personalitet të përsosur. Sepse sjellja më e vogël e një personaliteti shembullor, në shumë raste ndikon më shumë se sa fjala. Shembull tipik i kësaj është kjo ndodhi historike:

Një tregtar trikotazhi, i cili e kishte mbrujtur zemrën me bukuritë e Islamit, një ditë niset për tregti në Indonezi. Pasi vendoset në Indonezi, fillon të shesë mallin në Pazar.

Malli që kishte sjellë ishte shumë cilësor, por ngaqë nuk ishte lakmitar për të fituar shumë, mendoi se ishte më mirë të fitonte pak, por në mënyrë hallall. Prandaj kërkesën e lartë për mallrat e tij nuk e kishte shfrytëzuar asnjëherë për të ngritur çmimin.

Një ditë, kur erdhi vonë në punë, vuri re se shërbëtori kishte fituar shumë para nga mallrat e shitur. Dhe midis tyre u zhvillua ky dialog:

- Prej cilit stof ke shitur?

- Nga ky këtu zotëri.

- Sa e shite?

- Dhjetë dinarë.

- Si e shite dhjetë dinarë një pëlhurë që kushton pesë dinarë? I kemi hyrë në hak njeriut të shkretë. Nëse e shikon, a e njeh?

- Po zotëri, e njoh!

- Atëherë, shko menjëherë, gjeje dhe sille këtu.

Shërbëtori iku menjëherë, e gjeti klientin dhe e solli tek tregtari.

Tregtari, sapo e pa klientin i kërkoi falje atij dhe iu lut që t'ia bënte hallall dhe tha: "Na falni, punëtori gabimisht stofin që kushtonte 5 dinarë e ka shitur 10 dinarë." Dhe i zgjati klientit 5 dinarët e tepërt, duke i thënë se kjo ishte pjesa e tepërt që i përkiste atij.

Klienti u mahnit nga kjo sjellje sublime. Ishte hera e parë që përballë me një sjellje të tillë. Kurrë më parë nuk kishte dëgjuar për një rast si ky. Blerësi po mendonte mbi fjalët "ma bëj hallall". Si ka mundësi një gjë e tillë? Copën e stofit e kishte marrë me pëlqimin e vet. Megjithatë, falënderoi tregtarin dhe doli nga dyqani.

Ngjarja filloi të përcillej gojë më gojë dhe brenda një kohe të shkurtër u dëgjua në të gjithë qytetin. Të gjithë i tregonin njëri-tjetrit për këtë ngjarje. Pa kaluar shumë, çështja i ra në vesh mbretit dhe vendosi ta thërriste shitësin e stofit në sarajet e tij. Ai dëshironte të mësonte si qëndronte puna. Në mbretërinë e tij, për herë të parë ndodhte një gjë e tillë. Brenda popullit të tij ishte e pamundur të ndodhte një gjë e tillë sepse gjithkush e shite mallin e tij sipas dëshirës. Cili ishte shkaku që e shtynte tregtarin të bënte një veprim të tillë?

Mbreti e pyeti:

- Këtë veprim që ju keni bërë, ne as e kemi parë as e kemi dëgjuar më parë. Si është e vërteta e kësaj sjelljeje? Cili është shkaku që ju shtyn të bëni një veprim të tillë?

- Unë-, tha tregtari-, jam mysliman, jam besimtar. Feja islame kështu urdhëron. Atë stof e kisha blerë 4 dinarë dhe e shisja 5, por shërbëtori e kishte shitur 10 dinarë. Kështu që unë i kisha hyrë në hak klientit dhe për këtë shkak në mallin tim ishte përzier edhe fitimi haram. Unë vetëm rregullova një gabim të bërë.

Mbreti bëri disa pyetje të njëpasnjëshme:

Ç'është Islami? Ç'është morali islam? Tregtari iu përgjigj një e nga një pyetjeve të mbretit. Pa kaluar shumë kohë, mbreti pranoi Islamit dhe mbas tij i gjithë populli.

Ndoshta shkaku i pranimit të Islamit nga një vend me popullsi 250 milion banorë është pikërisht ky moral i bukur islam, i shfaqur nga tregtari.

Duhet që vazhdimisht në çdo situatë dhe vend të ekspozojmë moralin e bukur të Islamit.

**27) Çfarë solli dhe çfarë mori me vete jeta moderne dhe zhvillimi teknologjik i këtij shekulli? Pjesa më e madhe e rinisë sonë janë përdorues aktivë të rrjeteve sociale. Për çfarë duhet të bëjmë kujdes kur përdorim teknologjinë dhe veçanërisht internetin, në mënyrë që të mos përhumbemi në rrugët e pakuptimta të internetit dhe të mos de-vijojmë drejtimin tonë?**

Të nderuar vëllezërit e mi!

Sot hekuri, metalet dhe progresi teknologjik konsiderohen zhvillim. E vërteta është se zhvillimi arrihet përmes vlerave njerëzore. Progresi teknik dhe teknologjik nuk mund të prodhojë virtyte njerëzore, përkundrazi ai ndryshon natyrën e njeriut. Pra ndryshon negativisht natyrën njerëzore ngjashëm me frutat dhe perimet e ndryshuara gjenetikisht me hormone.

Cili është rezultati i zhvillimit të industrisë dhe teknologjisë?

- I nxiti njerëzit të bëhen egoistë. Ata tashmë mendojnë vetëm për vete.

- I orientoi drejt harresës së Ahiretit (Jetës së Përtejme).
- Ua dobësoi tiparet dhe virtytet, si: turpi, nderi, morali i bukur apo intimiteti.

Interneti është rezultat i teknologjisë. Nëse një besimtar mysliman paraqet një foto në internet duke darkuar me familjen e tij në një restorant luksoz dhe ju e pyesni:

“-Çfarë po bën?”

Ai do t’ju përgjigjet: “Po ia dërgoj një mikut tim.”

Ndoshta ai mik është nevojtar dhe kjo foto i ngjall lakmi.

Pastaj ajo foto mund të mos shkojë vetëm te miku, por mund të përhapet. Kështu humbet privatësia.

Nga ana tjetër, femniliteti po humbet si rezultat i pushtimit kulturor global. Femra po mashtrohet dhe sulmohet në emër të lirisë e barazisë. Në fakt gruaja është mbretëresha e familjes së vet.

Një problem tjetër është zhdukja e vlerave tona në ambiente das-mash:

- Dukja, shfaqja, syfaqësia po bëhen kriter i vlerësimit të das-mave.
- Të varfrit dhe nevojtarët po anashkalohen.
- Po humbet privatësia.

Kjo është një humbje e vërtetë, një humbje e vlerave shpirtërore si rezultat i pushtimit kulturor global i cili ka gjetur zhvillim të shpejtë përmes teknologjisë.

Kultura jonë e të ushqyerit po humbet:

Tashmë vendosja e lugës dhe pirunit në tryezat tona ka filluar t'i ngjasojë mënyrës së vendosjes në tryezat e huaja.

Ushqimet po ekspozohen. Ndërkohë që ka shumë prej njerëzve të privuar nga ushqimi. Ai ushqim më pas bëhet shkak për pakujdesi ndaj atij që e konsumon.

Në Stamboll, në kohën e fëmijërisë dhe rinisë sonë, kishte restorante luksoze si (për shembull) "Konja Lezzet". Në vitrinë kishte një perde që pengonte dukjen. Pra kishte një lloj ndjeshmërie të bukur që buronte nga tradita.

Në atë kohë nuk kishte furra në shtëpi. Ushqimi gatuhej me zjarrin që ndizej në oborr. Byrekët e bakllavatë mbulohehin me një copë dhe piqueshin në furrën e lagjes. Pastaj na thonin:

"-Kujdes o bir, ndaj diçka edhe për furrëpjekësin, mbase aroma e gatimit e shtyn ta provojë".

Në atë kohë nuk kishte as qese plastike, por çanta që pengonin ekspozimin e gjërave që kishin brenda. Kur dilnim të bënim pazar na thuhej:

"- Kujdes mos na sillni fruta e perime që kanë ngelur në syrin e nevojtarëve".

Për më tepër nuk kishte as ushqime të ekspozuara në syrin e nevojtarëve, si: doner, qebap apo të tilla si këto. Për fat të keq me kalimin e kohës u përhapën.

Për shembull në Stamboll -shpresoj të mos ndodhë kështu edhe në Konja nuk gatuajnë më në shtëpi. Restorantet janë plot. Ushqimet sillen në shtëpi me motoçikleta.

E vërteta është se ushqimi ka një shije materiale, por edhe një shije shpirtërore. Gatimi (duke qenë) me abdest, me emrin e Zotit, me

shehadet dhe me meditim, është burim qetësie dhe shërimi për ata që e konsumojnë. Ndërsa sot nuk dihet kush e gatuan ushqimin, me çfarë dhe si!

Duhet gjithashtu që ushqimi të fillohet me bismillah (me emrin e Zotit) dhe të përfundohet me elhamdulillah (falënderim), pa harruar Zotin e vërtetë të mirësive, në mënyrë që ai ushqim të jetë burim qetësie shpirtërore dhe shërimi.

Për fat të keq këto janë disa vlera që po humbasin me kohën.

Ka humbur kultura jonë e veshjes:

Po përdoren rroba të ngushta, të papërshtatshme për shëndetin dhe karakterin e njeriut. Po përzihet karakteri mashkullor me atë femëror. Po rritet tendenca për t'u ngjarë të huajve. Shumë gjëra jo të hijshme konsiderohen të zakonata për fëmijët, vetëm e vetëm që ata të kënaqen. Shumë parime të mbulesës po nëpërkëmben.

Kanë ndryshuar marrëdhëniet familjare:

Në të shkuarën, pra në fëmijërinë tonë, gratë kishin profesione të tilla si: gjinekologe, rrobaqepëse, mësuese, mësuese në kurse Kurani për vajza, në vende ku frekuentoheshin vetëm nga femra. Pra punonin në vende të përshtatshme për ta.

Në atë kohë familja dhe shtëpia nuk liheshin pas dore. Ndërsa sot po. Natyrisht nuk flas për të gjithë, por fëmijët e sotëm janë viktima të televizionit, internetit, modës, reklamave. Ata kanë filluar të marrin kënaqësi prej tyre. Si rezultat, tashmë nuk marrin ndonjë kënaqësi nga nëna dhe babai dhe nuk i ndjekin ata si shembull. Natyrisht kjo shkakton një pështjellim të madh shpirtëror të shoqërisë.

Ka humbur kultura e lagjes:

Më përpara njerëzit në lagje mbronin njeri - tjetrin. Jetimët dhe vejushat mbroheshin në mënyrë të veçantë, në kuptimin e plotë të fjalës. Paja e vajzës jetime përgatitej nga vetë zonjat-gratë e lagjes.

Të pasur e të varfër banonin së bashku në të njëjtën lagje. Nuk kishte një sistem klasash mes të pasurve dhe të varfërve. Jetohej në vëllazëri.

Kishte mirëkuptim dhe kursim. Kishte thjeshtësi dhe dinjitet.

Kishte mirësjelljeje të veçantë. Madje të sëmureve mendore nuk u thuhej "të çmendur", por "të pafuqishëm-të dobët".

Sot kjo edukatë, kjo delikatesë, kjo hijeshi ka humbur. Për she-mbull shohim se në dasma hidhen fishekzjarrë. A ka aty rrotull njerëz të sëmurë, njerëz që vuajnë apo të tjerë me probleme? Për fat të keq askush nuk mendon për ta.

### **Moda ka marrë një vëmendje të madhe:**

Moda i ka kthyer njerëzit në robotë. Përpjekja e njerëzve për të mbushur mangësitë shpirtërore

përmes materializmit, është tashmë tepër e dukshme. Pra dobësinë e personalitetit mundohen

ta kompensojnë përmes modës dhe stilit të veshjes. Kjo shfaqje, ky ves i konsumit, grykësia dhe

shpërdorimi, janë elementet e një jetese që Islami nuk e pranon. Ngjashmëritë formale dhe artificiale me ata që kanë fituar zemërimin e Allahut, tani janë shtuar. Çfarë përfaqëson ky model sjelljeje? Është

komplet kundërvënie ndaj mesazhit të vargut Kuranor:

**"...jo në rrugën e atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd..."**

(Fatiha, 7)

Përngjasimi me ata që kanë shkaktuar zemërimin e Allahut dhe me ata që kanë humbur rrugën, përkon me të qenit një prej tyre. I Dër-



guari i Allahut ﷻ shprehet: *“Ata që mundohen t’i përngjajnë një populli të caktuar, janë prej tyre”.* (Ebu Davud, Libas, 4/4031.)

Prandaj konceptet si, “Çdokush në shoqëri sillet kështu; si të vep-rojnë të tjerët, do të veprojnë edhe unë...”, nuk mund të jenë një kriter i pranueshëm nga ana jonë. Shembulli ynë është i Dërguari i Allahut, janë shokët e tij, janë njerëzit e mëdhenj të Islamit.

Bota kapitaliste shpiku disa festa në ditë të veçanta në mënyrë që të rrisë konsumin, të shesë më tepër e të fitojë më shumë para: E vërteta është se ditëlindjet, ‘Dita e nënës’, ‘Dita e babait’ e të tjera si këto, janë shpikje të Perëndimit kapitalist në mënyrë që të nxisë shoqërinë drejt shpërdorimit. Shkëmbimi i dhuratave sigurisht është traditë profetike.

Nuk ka ndonjë pengesë në shkëmbimin e dhuratave, pa e tep-ruar, në raste të tilla si ditëve të xhuma, netëve të mëdha, bajrameve etj., përkundrazi, ky është burim mëshire, begatie dhe dashurie. Për të shitur sa më shumë mallra, perëndimi kapitalist nxori një ‘Ditë të nënës’, apo ‘Ditë të babait’.

Shoqëritë që kanë humbur vlerat shpirtërore, filluan të qetësojnë ndërgjegjen e tyre duke iu dhënë vlerë personave të afërt vetëm në një ditë gjatë vitit. E vërteta është se çdo ditë është e nënës dhe e babait. Një mysliman duhet të interesohet në çdo rast për gjendjen e prindërve, t’u puthë dorën, t’u fitojë duanë e t’i vizitojë ata.

Madje edhe pas vdekjes së tyre duhet t’u jetë mirënjohës, të kryejë vepra të mira në emër të tyre, të lutet për shpirtin e tyre, e të jetë një sadaka rrjedhëse për ta. Po ashtu, perëndimi kapitalist për të shfrytë-zuar shoqërinë edhe më shumë, shpiku “Ditën e të Dashuruarve”.

Është shumë e vështirë të kuptohet ç’është kjo dashuri! Dashuria e vërtetë është ajo që të drejton drejt dashurisë hyjnore. Dashuria është

nevoja e shpirtit për shpirtin. Nevoja e trupit për trupin nuk është më dashuri, por epsh.

Sa bukur shprehet Mevlana:

*“Ki mëshirë! Dashuria është diçka e mirë. Janë shprehitë tuaja të këqija ata që e dëmtojnë dashurinë. Ti e paske quajtur dashuri epshin. Ah sikur ta dije, sa shumë ndryshim ka midis dashurisë dhe epshit! Dashuria hyjnore e bën besimtarin vigilent. Ndërsa dashuria e kësaj bote dhe epshi e bëjnë njeriun budalla dhe kokëtrashë!”*

Burimi i vërtetë i dashurisë është “el-Vedud”, Krijuesi i Gjithësisë. Besimtari i vërtetë i sheh të gjitha krijesat me dashuri në saje të Krijuesit të tyre. Dhe këtë nuk e bën vetëm në një ditë, por çdo ditë. Po ashtu, me avancimin e teknologjisë u përhap edhe vesi i fotografisë. Madje në emër të lidhjes (rabita) u shtri deri në jetën shpirtërore. Nuk mund të ketë lidhje shpirtërore (rabita) përmes fotografisë. Rabita është ruajtja e dashurisë, është një lidhje shpirtërore, vetëm kaq. Nuk mund të shkojë më tutje. Rabita duhet të mbesë në kufirin e dashurisë. Tejkalimi i këtij kufiri -Zoti na ruajt- shpie në shirk. Besimi monoteist nuk e pranon në asnjë mënyrë ortakërinë.

Edhe dashuria e nënës për fëmijën e saj është rabita, edhe dashuria e një njeriu të devijuar për pijen e kumarën e tillë është. Ndërsa rabita e një myslimani është dashuria për të Dërguarin e Allahut; dashuria, lidhja dhe besnikëria që ndjen në shpirt për njerëzit e mirë e të devotshëm. Kjo pra është rabita. Nuk mund të ketë rabita duke parë fotografinë. Për më tepër, fotografia është kufizim i kuptimit.

Adhurimi i idhujve lindi pikërisht në këtë mënyrë. Sahabët nuk bënë rabita duke pikturuar portretin e njeri-tjetrit. Në qytetërimin tonë njerëzit e mirë nuk përkujtohen me fotografi, ata mbahen mend me karakteristikat morale dhe përvojat e tyre. Për shembull, kur flitet për Omerin ﷺ, ne kujtojmë drejtësinë e tij, trimërinë e mprehtësinë.

Nuk kujtojmë vetullën, syrin, e trupin e tij! Për fat të keq gabime dhe risi të tilla tashmë kanë hyrë në jetën tonë. Interneti po i përhap ato me shpejtësi të madhe.

### **ÇFARË MASASH DUHET TË MARRIM?**

Zakonet dhe traditat e kohës duhet t'i vlerësojmë mbi bazën e parimeve Islame.

Nuk duhet të harrojmë se lehtësimet që ka sjellë teknologjia janë thikë me dy presa, kanë anët e tyre pozitive dhe ato negative. Gjatë përdorimit të kompjuterit, telefonit, tabletit apo rrjeteve sociale, nuk duhet të harrojmë domosdoshmërinë e kujdesit ndaj "takvasë" (devotshmërisë) në çdo çast të jetës sonë. Shpesh duhet të mendojmë se edhe këto janë mirësi për të cilat do japim llogari në jetën e përtejme. Në mënyrë të veçantë kjo këshillë e Imam Shafiut, duhet të jetë moto për çdo çështje:

*"Nëse nuk e mban veten të zënë me punë të mira, e keqja do të të pushtojë!"*

**28) Një i ri i ndërgjegjshëm, i rritur me edukim dhe frymë fetare, i cili pas shkollimit hidhet në jetë dhe në raporte pune, familjare, shoqërore, herë pas here mund të bëjë lëshime sa i takon disa parimeve islame. Pikërisht në këto rrethana, si mund të mbahet qëndrueshmëria në fe, si mund të kujdesemi për ruajtjen e ndjeshmërisë dhe parimeve islame? Si i këshilloni të rinjtë?**

**Së pari:**

Zgjidhja e parë sa i takon ruajtjes së qëndrueshmërisë në fe është shoqërimi me besimtarë të drejtë e besnikë. Krijuesi i Gjithësisë shprehet: **“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të singertë** (në fjalë dhe në vepra!)” (Teube, 119)

Si rezultat i shoqërimit me të mirët, njeriu merr vlera të cilat përmirësojnë nivelin e tij të gjykimit drejt dhe të sinqeritetit, përmes shkëmbimeve në gjendjet e tyre shpirtërore.

Shejh Sadi thotë:

*"Qeni i Banorëve të Shpellës (As'hab-i Kehf), fitoi një nderim të madh duke u përmendur në Kuran, ngaqë u shoqërua me njerëz të mirë. Ndërsa gratë e Nuhut dhe Lutit përfunduan në Xhehenem si rezultat i bashkimit shpirtëror me të devjuarit".* Prandaj është shumë e rëndësishme zgjedhja e rrethit, shoqërisë, komshiut, shokut. Kur një atom shpërbëhet në protone, neutrone dhe elektrone, fillojnë të përhapen disa rrezatime, të cilat mund të jenë pozitive apo negative. Ekzistojnë disa rreze që ne nuk mund t'i shohim si: alfa, beta, gama, ultravjollcë etj., por të gjitha kanë nga një efekt. Ndërsa rrezatimet më ndikuese janë ato që dalin nga zemra. Ndikimin e dobishëm e quajmë fejt, përshpirtshmëri; ndër- sa të dëmshmin e quajmë gaflet, shkujdesje. Për këtë arsye Krijuesi i Gjithësisë shprehet: **"...Bëhuni me ata që janë të sinqertë..."** (Teube, 119) **"...Mos rri me keqbërësit!"** (Enam, 68) Madje ana shpirtërore shtrin ndikimin e saj edhe në hapësira të caktuara. Kështu, i Dërguari i Allahut pati qëndruar me sahabët e tij në zonën e Hixhrit, aty ku u shkatërrua populli i Themudit. Sahabët nxorën ujë nga pusi për nevojat e tyre dhe nga ky ujë përgatitën brumë. I Dërguari i Allahut urdhëroi të derdhej ai ujë, brumi i përgatitur me të t'u jepej si ushqim deveve, dhe sahabet të merrnin ujë vetëm nga pusi ku kishte pirë deveja e Salihut ﷺ. (Buhari, Enbija, 17; Muslim, Zuhd, 40.) Edhe pse nga ajo kohë kanë kaluar me mijëra vite, akoma sot personat që kalojnë andej nuk e përdorin atë ujë për abdest, si rezultat i mallkimit hyjnor ndaj atij vendi.

Kjo do të thotë që, po aq sa duhet qëndruar larg femohuesit, të devjuarit apo të shkujdesurit, po aq duhet qëndruar larg edhe vendeve ku ka rënë mallkimi hyjnor për shkak të haramit dhe mosbindjes.

### **Së dyti:**

Këshilla e dytë është kujdesi ndaj adhurimeve tona, në mënyrë të veçantë kujdesi ndaj faljes së namazit me përqendrim dhe me xhemat. Sepse Krijuesi i Gjithësisë ka garantuar mbrojtje nga imoraliteti dhe e shëmtuara, pra nga gjynahet e papranueshme sipas fesë e logjikës,

nga zvarritja në situata dhe gabime të shëmtuara, nëse namazi falet si me trup ashtu edhe me zemër.

Prandaj, duhet të përpiqemi të jemi fqinj me xhaminë e të afërt me xhematin.

Edhe të parët tanë Osmanët kanë qenë të ndjeshëm ndaj detajeve. Ata ndërtuan komplekse të mëdha në vendet qendrore, ndërsa midis lagjeve ndërtuan xhami të vogla sa një dhomë, në mënyrë që kur nuk kishte energji elektrike, namazi me xhemat i sabahut, akshamit e jacisë të mund të falej rregullisht dhe njerëzit të mos privoheshin nga kënaqësia e qetësia e namazit me xhemat.

Provojeni o të rinj: Nëse jeni nisur të shkoni diku sepse keni një punë, mirëpo thërret ezani...

Zbrisni nga autobusi, faleni namazin me xhemat, pastaj vazhdoni rrugën; do ta shihni që punën do ta keni më të lehtë...

### **Së treti:**

Këshillohet që të mos harrohet mësimi i Pejgamberit ﷺ:

*"Jeta e vëtetë është jeta e Ahiretit."*<sup>15</sup> Nëse arrihet një sukses, duhet kujtuar ky hadith e duhet pasur kujdes nga teprimi. Ndërsa në momentet e vështira nuk duhet rënë në pesimizëm.

Asnjëherë nuk duhet të harrojmë që kjo jetë është kalimtare e jeta e Ahiretit është jeta e vërtetë dhe e pafundme. Nuk duhet të harrojmë se si rehatia, ashtu edhe vështirësitë e kësaj jete janë vetëm sprova hyjnore. Sulejmani ﷺ kishte pasuri dhe pushtet të jashtëzakonshëm. Por ai e kishte ruajtur zemrën e tij nga tundimi i mirësive të kësaj bote. Ai e falënderonte pafundësisht Zotëruetin e vërtetë të këtyre mirësive. Prandaj dhe fitoi vlerësimin **"robi i mirë"**.<sup>16</sup>

15. Buhari, Rikak, 1.

16. Sad, 30.

Nga ana tjetër edhe Ejjubi ﷺ, i sprovuar me skamje, sëmundje e shumë vështirësi, gjithnjë ishte falënderues dhe asnjëherë nuk ankohej për gjendjen e tij për të cilën ishte i bindur se ishte një sprovë e caktuar nga Allahu. Edhe ai përmes falënderimit dhe nënshtrimit ndaj Zotit, arriti të fitonte vlerësimin **“robi i mirë”**. Prandaj dhe ne si besimtarë, nuk duhet t’u kushtojmë rëndësi kushteve me të cilat jemi sprovuar, por mundësive të arritjes së kënaqësisë së Allahut Fuqiptotë. Sa bukur shprehet Mevlana:

*“Bota jote e brendshme është si një strehë mysafirësh. Gëzimet e hidhërimet hyjnë e dalin.*

*Mos u mashtro nga gëzimet, e as mos u mërzit nga hidhërimet! Mos u mërzit nëse pikëllimet pengojnë lumturinë tënde! Sepse nëse duron pikëllimet sot, ata janë lajmëtarë të gëzimit dhe lumturisë së të ardhmes”. Kjo botë është jetë e sprovave. Në këtë ajet fisnik Krijuesi i Gjithësisë shprehet:*

**“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?!”** (Ankebut, 2)

Ne duhet t’i mbështetemi mëshirës së Allahut Fuqiptotë, si në pasuri ashtu dhe në skamje. Jetën e Ahiretit duhet ta konsiderojmë çështjen parësore të jetës sonë. Nuk duhet të harrojmë kurrë se vdekja, përkohshmëria, fryma e fundit, varri, kiameti, ringjallja, llogaridhënia, peshorja e veprave, ura e Siratit, me pak fjalë Ahireti, është e vërteta më e madhe që i përket të ardhmes sonë. Në ajetin fisnik Allahu Fuqiptotë shprehet:

**“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!”** (Muminun, 115) **“Beto hem në Ditën e Kiametit! Beto hem në shpirtin qortues!”** (Kijame, 1-2) **“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?”** (Kijame, 36)

**“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.”** (Zelzele, 7-8)

**“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!”**  
(Tekathur, 8)

Ashtu si në ditët e sotme që nëse shkruan një emër në një telefon apo në një aparaturë të vogël, të shfaqen të gjitha të dhënat në lidhje me personin, po ashtu edhe melekët Kiramen Katibin regjistrojnë gjithçka në lidhje me ne. Këto të dhëna dokumentohen në dosjet e përtejme për t’u hapur ë Ditën e Llogarisë. Atë ditë do të thuhet: **“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!”** (Isra, 14) Do të flasim sytë! Çfarë kanë parë këta sy? Për çfarë t’i ka dhuruar Allahu këto sy, e ti çfarë ke vrojtuar me ta?

Allahu përse t’i ka dhënë veshët, ti çfarë ke dëgjuar?

Do të flasë gjuha jote! Çfarë ke shqiptuar? Në ç’masë ke folur pozitivisht e në ç’masë negativisht?

Me pak fjalë, ajo është një ditë e vështirë, për të cilën duhet të përgatitemi që në këtë botë. Prandaj duhet t’i kushtojmë rëndësi adhuri-meve. Duhet të përkujtojmë shpesh vdekjen dhe Ahiretin. Nëse mendja dhe zemra jonë thellohen në këtë meditim, do të jetë më e lehtë ta mbrojmë veten nga sfidat e kohës.

### **Së katërti:**

Këshillohet devotshmëria. Çfarë ka urdhëruar Allahu Fuqiptotë? Si e konkretizoi atë i Dërguari i Allahut? Si jetuan sahabët? Edhe ne pas gati 1400 vitesh duhet të përpiqemi të jetojmë si sahabët e nderuar. Çfarë është devotshmëria?

Devotshmëria është shmangia me kujdes nga veprat e ndaluara dhe të papëlqyeshme, me ndjenjën e dashurisë dhe frikës ndaj Allahut. Një ditë Omeri رضي الله عنه e pyeti Ubej ibn Kabin رضي الله عنه se çfarë është devotshmëria: Ubeji tha:



“-O Omer, a ke ecur ndonjëherë në një rrugë me gjemba?”

Omeri ﷺ u përgjigj:

“- Po kam ecur”.

“- Si ke ecur?”- e pyeti përsëri.

“- Kam mbledhur rrobën time dhe kam treguar kujdes që mos të dëmtohem nga gjembat”,- u përgjigj ai.

Pas kësaj Ubej ibn Kabi ﷺ tha:

“- Ja pra, kjo është devotshmëria”.

Pra të jesh i devotshëm do të thotë të mbrohesh me kujdes nga gjembat e haramit dhe gjynahit.

Sot njerëzimi nën ndikimin e televizionit, internetit, shifrave, modës e pushtimit kulturor global, është pllakosur në vorbullën e haramit dhe gjynaheve si trungjet e pemëve që rrëshqasin nga përmytjet. Rruga e mbrojtjes ndaj hutimit (të tipit) “shkoj pas turmës”, është mbushja e shpirtit me ndjesinë e frikës së humbjes së kënaqësisë dhe dashurisë së Allahut, pra me ndjenjën e devotshmërisë.

Devotshmëria është lartësim i zemrës. Shfaqja më e bukur e devotshmërisë është largimi nga kufri (mohimi), nifaku (hipokrizia) dhe shirku (idhujtaria), siç largohesh nga zjarri, dhe vrapimi për të realizuar urdhrat e Krijuesit të Gjithësisë në mënyrën më të plotë.

Në këtë botë, e cila është vendi i sprovave hyjnore, devotshmëria është kujdesi që duhet treguar në çdo hap që hedhim në jetën tonë, njësoj sikur të ishim duke ecur në një zonë të minuar.

Prandaj nuk duhet të harrojmë asnjëherë që Islami nuk është një përjetim stinor, por një jetë e tërë devotshmërie që rregullon çdo

frymëmarrje tonën në mënyrë që të ruajmë qëndrueshmërinë në fe. Po ashtu, duhet të kërkojmë mbrojtjen e Allahut gjatë gjithë jetës që Ai ta ruajë sinqeritetin dhe qëndrueshmërinë tonë në fe.

## **29) Cilat janë direktivat e fesë islame në një periudhë ku nën emrin e lirësë kanë humbur nderi dhe edukata?**

Nder do të thotë ta ruash veten që të mos mashtrohet nga çdo lloj epshi dhe nga dëshirat e këqija. Nderi është një veçori e njeriut dhe njëkohësisht vetia më dalluese që e ndan njeriun nga krijesat e tjera. Të të humbasë nderi do të thotë të të humbasë vlera njerëzore dhe të biesh në gjendje të njëjtë me krijesat e tjera.

Nderi është damari i jetës për të gjitha virtytet dhe moralin. Vetitë si morali, nderimi dhe respekti, janë të lidhura me nderin.

Dy vetë që kanë arritur kulmin në çështjen e nderit, Allahu i ka lavdëruar dhe i ka treguar si shembuj për besimtarët. Njëri është Jusufi historia e të cilit, si "historia më e bukur", shtjellohet në suren Jusuf, ndërsa tjetra është Merjem, për të cilën flitet me lavdërim në vende të ndryshme. Në ajetin fisnik thuhet:

**“(Përkujto) Edhe atë që e ruajti nderin e saj, Ne e frymëzuar me shpirt nga ana Jonë. Atë dhe birin e saj e bëmë mrekulli për njerëzit.”** (Enbija, 91)

Burrat dhe gratë që e ruajnë nderin e tyre, do të fitojnë faljen e gjërë të Allahut Teala. Allahu i lavdëron kështu robërit e Tij të ndershëm:

**“Dhe ata të cilët e ruajnë nderin e tyre, përveç ndaj grave të veta (me kurorë) dhe ndaj (robëreshave) që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuar. Atëherë kush kërkon jashtë këtyre (dëfrim nga të ndaluarat), këta janë ata që i kanë shkelur normat e caktuara.”** (Mu’minun, 5-7)

Ashtu siç u ka mësuar njerëzve bazat e besimit dhe të adhurimit, Pejgamberi ynë i Nderuar u mësonte atyre edhe bazat e moralit, si drejtësinë, nderin dhe mbrojtjen e të afërmeve. Po ashtu, kur perandori Bizantin Heraklius e pyeti Ebu Sufjanin se “Çfarë u urdhëron njerëzve i Dërguari i Allahut”, Ebu Sufjani u përgjigj: “U urdhëron që të jenë të drejtë, të ndershëm, të kujdesen dhe të mbrojnë të afërmit”. (Buhari, Bed’u’l-Vahj 6, Salat 1; Muslim, Xhihad 74)

I Dërguari i Allahut i jepte aq shumë rëndësi nderit, saqë veçanërisht grave u merrte besën në çështjen e ruajtjes së nderit.<sup>97</sup> Ai, duke iu drejtuar të gjithë besimtarëve, thotë:

*“Kush më jep fjalën se do ta ruajë atë që ka në mes dy nofullave (gjuhën) dhe nderin e tij, edhe unë i premtoj xhennetin.”* (Buhari, Rikak, 23)

Nga ana tjetër, sundimi i turpit, nderit, pastërtisë dhe njerëzillëkut mes burrave dhe grave është një çështje shumë e rëndësishme, sepse Islami i ka ndaluar të gjithë punët e këqia, paturpësinë dhe imoralitetin.

Lidhja dhe dashuria në mënyrë të paligjshme mes një burri dhe një gruaje fillon me “shikimin”. Për këtë arsye, është urdhëruar që burrat dhe gratë myslimane të mos e shohin njëri-tjetrin me epsh, ndërsa kur të flasin, ta mbajnë kokën të ulur përpara:

**“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (nga harami), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, sepse kjo është më e pastër për ta. Allahu i di shumë mirë atë që veprojnë ata.**

**Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre. Të mos i zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme. Le t'i vendosin shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të tyre, baballarëve të tyre ose baballarëve të burrave të tyre, djemve të tyre ose djemve të burrave të tyre, vëllezërve të tyre ose djemve të vëllezërve të tyre, apo djemve të motrave të tyre, ose grave (besimtare) dhe robërshave të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat ose fëmijët të cilët nuk e kanë arritur moshën e pubertetit. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar stolitë e tyre. O besimtarë! Pendohuni të gjithë te Allahu, në mënyrë që të shpëtoni.” (Nur, 30-31)**

Përveç se u drejtohet nënave të besimtarëve, ky ajet fisnik prek edhe çështjet ndaj të cilave duhet të kenë kujdes edhe gratë e tjera: **“O gratë e Pejgamberit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse keni frikë (Allahun), mos flisni në një mënyrë tërheqëse (përballë burrave të huaj) e të shpresojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij. Flisni fjalë të matura. Rrini në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj siç shfaqej në injorancën e hershme. Faleni namazin, jepni zekatin dhe respektojeni Allahun dhe të Dërguarin e Tij. O familje e shtëpisë (së Pejgamberit)! Allahu dëshiron t’ju largojë nga mëkatet dhe t’ju bëjë shumë të pastër.” (Ahzab, 32-33)**

Edhe në një ajet tjetër fisnik thuhet:

**“O Pejgamber! Thuaju grave të tua, bijave të tua dhe grave të besimtarëve që t’i vendosin shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre. Kjo i bën të njihen (si gra të ndershme) dhe të mos ofendohen. Allahu është falës dhe mëshirues.” (Ahzab, 59)**

Kur burrat dhe gratë e huaja të kërkojnë diçka nga njëri-tjetri ose kur t’ju thonë diçka, këtë duhet ta bëjnë pas derës apo pas perdes, sipas mundësisë që kanë.

Njerëzit nuk duhet të hyjnë në shtëpitë e njëri-tjetrit pa leje. Madje edhe pjesëtarët e familjes, kur të hyjnë në dhomat e njëri-tjetrit, duhet të hyjnë duke marrë leje dhe duke i lajmëruar, sepse Allahu njofton se sjellja e ndershme është më e mirë.

Allahu i jep shumë rëndësi faktit që robërit e Tij të jenë të ndershëm dhe këtë e shpreh në shumë ajete. Për këtë arsye, të shpifësh ndaj njerëzve të ndershëm është pranuar si mëkat i madh, ndërsa ndaj shpifësve është zbatuar "ndëshkimi i shpifjes". Allahu thotë:

**"Vërtet, ata që akuzojnë (për prostitucion) gratë e ndershme, besimtare të pafajshme, janë të mallkuar në këtë botë dhe në botën tjetër dhe ata i pret një dënim shumë i madh."** (Nur, 23)

Për këtë arsye, edhe Pejgamberi ynë i Nderuar ka thënë; *"...Mos e akuzoni për prostitucion një grua të ndershme!"* (Tirmidhi, Isti'zan, 33/2733)

Me të vërtetë, vetia dalluese e një gruaje është nderi. Edhe para-lajmërimet e mësipërme tregojnë peshën e fajit të shpifjes që bëhet ndaj nderit. Sipas kësaj, në çdo lloj situatë dëshmie, t'i përcjellësh pa i shqyrtuar ato që dëgjon, duke i lënë njerëzit nën akuzë për nderin dhe namusin, përbën nga fajet më të mëdha.

Në çështjet të tjera, veçanërisht në çështjen e të kërkuarit diçka nga njerëzit, duhet të sillemi në mënyrë të ndershme. Allahu i lavdëron kështu robërit e Tij të ndershëm:

**"(Jepni) për të varfërit që janë të angazhuar në rrugën e Allahut dhe nuk kanë mundësi të ecin për të kërkuar fitimin e tyre në tokë. Ata nuk lypin, prandaj ai që nuk e di gjendjen e tyre, mendon se ata janë të pasur. Ata i njeh nga vetë pamja e tyre (të raskapitur), por nuk kërkojnë e as nuk i mërzisin njerëzit. Pra, çfardo që të jepni nga pasuria, s'ka dyshim se All-llahu e di mirë."** (Bakara, 273)

Pejgamber ﷺ ka thënë:

*"I varfër nuk është ai që lyp një apo dy hurma, një apo dy kafshata. I varfër është ai i cili heq keq kur ka nevojë dhe nuk kërkon gjë nga askush, për shkak të nderit dhe të njerëzillëkut të tij. Nëse kërkon, lexoni ajetin; ...Nuk kërkojnë gjë nga njerëzit me këmbëngulje..."* (Bakara, 273) (Muslim, Zekat, 102)

*"Banorët e xhennetit janë tri grupe: I drejti, ai që jep në rrugë të Allahut dhe kryetari i suksesshëm i shtetit, ai që është i mëshirshëm dhe zemërbutë ndaj të afërmëve dhe myslimanëve, myslimani i ndershëm i cili edhe pse ka një familje me shumë anëtarë për të mbajtur, nuk kërkon asgjë nga askush dhe largohet nga fitimi haram."* (Muslim, Xhennet, 63)

*"Ata që nuk duan të lypin, Allahu i bën të ndershëm. Edhe ata që duan të sillen syngopur kundrejt popullit, Allahu i shpëton nga nevoja që mund të kenë për njerëzit."* (Buhari, Zekat, 18)

Ndërsa turpi, i cili është një degë e besimit, ka kuptimin e të qëndruarit larg gjërave të këqija, i të qenit i matur në sjellje dhe i të mos tepruarit në asnjë çështje. Ndjenja e turpit është themeli i të gjithë të mirave dhe është e kundërta e gjithçkaje të keqe dhe të shëmtuar.

Krenaria e Gjithësisë, i Nderuari ynë thotë kështu për turpin, i cili është një veti që Allahu e do:

*"Turpi është nga besimi!"* (Buhari, Iman, 3)

*"Turpi dhe besimi janë bashkë, kur ikën njëri, ikën edhe tjetri!"* (Sujuti, I, 53)

*"Turpi sjell vetëm të mirë."* (Muslim, Iman, 61)

*"Fjala e keqe nuk sjell asgjë përveç së keqes! Ndërsa turpi dhe edukata e zbukurojnë vendin ku hyjnë."* (Muslim, Birr, 78)

*"O Zoti im! Kërkoj nga Ti udhëzim, devotshmëri, nder dhe pasuri shpirtërore."* (Muslim, Dhikr, 72)

Njeriun vetëm virtyti i turpit mund ta ndalë nga çdo lloj gjëje e keqe dhe nga mendimet egoiste. Ndikimi i edukatës dhe i turpit në çështjen për ta ruajtur besimtarin, janë më të forta se qindra ligje dhe qindra forca të policisë. Në lidhje me çdo lloj çështjeje, një njeriu të ndershëm dhe të turpshëm është e mjaftueshme t'i thuash: "A nuk ke turp?"

Osman kishte një personalitet të lartë që përbënte shembull në aspektin e ndjenjës së turpit dhe turpërimit. I Dërguari i Allahut ka lajmëruar se edhe engjëjt bëhen turp nga Osman.

Allahu i kritikon kështu ata që nuk janë të turpshëm dhe ata të cilët duan të përhapet paturpësia:

**"Ata të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet amoraliteti, i pret një dënim i dhembshëm në këtë botë dhe në botën tjetër..."**

(Nur, 19)

Ata të cilët duan që paturpësia të shpërndahet në shoqëri, ndaj vendit dhe popullit të tyre, kanë bërë të keqen më të madhe. Ata që veprojnë kështu, edhe vetë bien në dëmet më të mëdha, sepse paturpësia, sipas lajmërimit të Pejgamberit tonë të Nderuar, është shkak për tu shkatërruar:

*"Pa dyshin se, kur Allahu i cili është Aziz dhe Xhelal, dëshiron të shkatërrtojë një rob të Tij, i merr turpin. Kur ia merr turpin, ai rob bëhet njeri agresiv. Kur bëhet agresiv, i hiqet besnikëria. Kur i hiqet besnikëria, ai bëhet vetëm tradhtar. Kur bëhet tradhtar, i hiqet mëshira. Kur t'i hiqet mëshira, ai vetëm mallkohet dhe bëhet i mallkuar. Kur të mallkohet dhe kur të bëhet i mallkuar, lidhja që kishte me Islamin, këputet!"* (Ibn Maxhe, Fiten, 27)



**30) Çfarë duhet të na kujtojë “ndjenjat e nderit” në një shoqëri ku po abuzohet çdo ditë që kalon me konceptet si “edukata, turpi dhe namusi”. Në cilat situata mund të takohen gruaja dhe burri pa qenë të martuar? Çfarë na sugjeroni në lidhje me këtë çështje?**

Nderi është një prej cilësive dalluese që e ndan njeriun nga krijesat e tjera. Allahu i Lartësuar kërkon që robi ta ruajë gjithmonë nderin. Ai kërkon nder **për veshët, nder për gjuhën, nder për sytë, nder për duart, shkurtimisht nder për të gjithë trupin...**

Përse?

Sepse mungesa e nderit në gjuhë e shpie njeriun në përgojim, gënjeshtër dhe shpifje.

Mungesa e nderit te sytë e zvarrit njeriun për të parë vitrina të gabuara, ekrane të papërshtatshme dhe skena që janë haram.

Mungesa e nderit te veshët e drejton njeriun për të dëgjuar gjëra të këqija.

Mungesa e nderit te duart e hedh njeriun në mëkat.

Edhe veshja e një rrobe të ngushtë deri në atë masë sa t'i shfaqë linjat e trupit, të një rrobe joshëse deri në atë masë sa t'i tërheqë sytë e të tjerëve dhe të një rrobe që e bën atë të cilin e shikon, të thotë: **"Eja te unë!"**, siç i tha Zulejhaja Jusufit, është privim i trupit nga nderi. Kjo gjendje e zvarrit njeriun drejt shkatërrimit shpirtëror.

Ndërsa urdhri i Zotit (xh.xh.), në lidhje me këtë çështje është veshja e rrobave të bollshme që nuk i shfaqin linjat e trupit.

**I Dërguari i Allahut** r ka thënë:

*"Turpi është prej besimit."* (Buhari, Edeb 77, Iman 16; Muslim, Iman, 57-59.)

*"Një prej gjërave që frikësohem më së shumti për ju, janë dëshirat e flakta që ju zvarrisin drejt tërbimit në lidhje me çështjen e stomakut dhe nderit. Ndërsa tjetra është egoja e cila ju lëshon në devijim."* (Ahmed, IV, 420, 423; Hejsemi, I, 188; Ebu Nuajm, Hilje, II, 32.)

Ndërsa në lidhje me përzierjen e burrave me gratë le të themi këtë:

Shoqëria e Epokës së Lumturisë (Periudhës së të Dërguarit të Allahut) ishte shumë e kujdesshme dhe e ndjeshme për sa i përket çështjes së përzierjes së burrave me gratë. Domethënë, burrat dhe gratë që ishin të huaj për njëri-tjetrin, nuk qëndronin bashkë dhe nuk përziheshin deri në atë masë, sa t'i kalonin kufijtë dhe rregullat.

Përgjatë jetës së tyre sociale kishte vazhdimisht një largësi ndërmjet burrave e grave dhe marrëdhëniet me njëri-tjetrin ishin brenda një rregulli dhe disipline të caktuar.

Sepse Islami si parim, siç i ka ndaluar të këqijat, si marrje masash në mënyrë paraprake, i ka ndaluar edhe gjendjet dhe veprimet që bëhen shkak për të keqen dhe që nxisin drejt saj. Kështu i mbyll në mënyrë të

mirëfilltë rrugët e gabuara, duke vendosur një largësi të madhe ndërmjet njerëzve dhe të këqijave.

Për fat të keq, në ditët e sotme në familje po përjetohej situata tragjike, ngaqë nuk po shfaqet kujdes ndaj këtyre rregullave.

Në ditët e sotme disa prej njerëzve thonë: “Sidoqoftë femrat dhe meshkujt janë bashkë nëpër rrugë dhe sokakë. Andaj le të jenë edhe në klasë, në dyqan, në apartament, etj. Çfarë të keqeje ka këtu?”

Të mos harrojmë se në rrugë dhe sokak rastisin në një mënyrë krejt të pacaktuar. Por edhe aty ka rregulla si ulja e shikimit dhe mbulesa.

Ndërsa kur bëhet fjalë për të njëjtën shkollë dhe për të njëjtin vend pune, dashje pa dashje ndodh një lloj afrimiteti, ndodhin biseda të panevojshme dhe shfaqen anime të zemrës. Nëpër vendet e punës mund të ndodhin situata kur lind nevoja e qëndrimit vetëm për vetëm. Siç shprehet edhe në hadithin fisnik, kur ndodh diçka e tillë, “*i treti i tyre është shejtani*”. (Ahmed bin Hanbel, I/222, III/339.)

Ne duhet të jemi të vetëdijshëm për këtë:

Rregullat e sistemit të jetës në ditët e sotme i kanë vendosur njerëz që nuk u kushtojnë rëndësi principeve fetare. Ne si myslimanë duhet t'i ndërtojmë përsëri të gjitha këto rregulla. Këtë duhet ta bëjmë sipas fesë sonë dhe me parimet sublime të Islamit.

Kur i Dërguari i Allahut ﷺ, bëri hixhret në Medine, rregulloi menjëherë tregun. Bazuar në këtë, edhe ne duhet t'i ndërtojmë përsëri dhe sipas parimeve të Islamit shkollën, tregun, industrinë, arkitekturën, qytetin dhe çdo gjë tjetër që kemi.

**31) Burri dhe gruaja, ndërtojnë një çerdhe dhe duke bashkuar jetët e tyre, vendosin të ndajnë së bashku çdo gjë që mund t'u vijë në jetë. Por, cilat janë çështjet që të dyja palët duhet të kenë kujdes njëkohësisht gjatë jetës martesore?**

Këtu, duhet bërë kujdes në dy pika:

- Në ndarjen e lumturisë dhe gëzimeve.
- Në ndarjen e barrës dhe vështirësive.

Ndarja e jetës së përbashkët, duhet të jetë e vazhdueshme në çdo gjendje të jetës, nën atmosferën e dashurisë dhe me frymë shpirtërore. Ashtu siç ndahen gëzimet dhe lumturitë, ashtu duhet të ndahen edhe vështirësitë, hallet, hidhërimet dhe fatkeqësitë. Palët duhet ta mbështesin gjithmonë njëra-tjetrën, duke u bërë si dy duar që lajnë njëra-tjetrën. Po ashtu, ata duhet të bëhen burimi më i afërt i ngushëllimit për njëri-tjetrin.

Jeta nuk vazhdon gjithmonë vetëm mbi re ngjyrë rozë. Nuk duhet harruar se, ajo ka ulje, ngritje, furtuna, kthesa dhe pengesa. Për njerëzit,

e ardhmja është e panjohur dhe plot me surpriza. Kaderi (caktimi), është një e fshehtë hyjnore. Nga kjo pikëpamje, burimi më i madh i forcës dhe i mbështetjes, në radhë të parë duhet të jetë lidhja dhe besimi në Allahun. Ndërsa mbështetja e dytë më e madhe, janë bashkëshortët e lidhur fort me njëri-tjetrin.

Duhet pasur kujdes se, nëse njerëzit e pashpresë e të lodhur, nuk e gjejnë brenda familjes mbështetjen e pritur në raste të fatkeqësive dhe vështirësive, ata mund të pësojnë rrënimë dhe shkatërrime edhe më të mëdha. Mirëpo, në çerdhet familjare të cilat përbëhen nga individë të pjekur shpirtërisht dhe të kuptueshëm, fatkeqësitë që vijnë, anashkalohen me lehtësi, në bazë të qëndrueshmërisë së familjes.

Qëndrueshmëria familjare, në mënyrë paralele me pjekurinë shpirtërore, në mënyrë të veçantë, varet edhe nga aftësia në mirë-kuptimin reciprok. Ky, është kushti më i rëndësishëm i shumë mirësive dhe sukseseve. Lidhur me këtë, Mevlana, thotë:

*“Trëndafil, aromën e këndshme, e ka fituar për shkak se ia ka kaluar bukuri me gjembin. Këtë të vërtetë, dëgjoje edhe prej vetë trëndafilin. Dëgjo se ç’thotë: «E përse të hidhërohem se jam bashkë me gjembin; përse ta fus veten në stres? Unë, që të qeshurën e fitova për shkak se durova qëndrimin bashkë me gjembin e keq. Në sajë të tij, unë arrita mundësinë t’i ofrojë botës bukuri dhe aroma të këndshme...»”*

Ky trëndafil, na thotë edhe neve:

“Edhe ju bëhuni si unë!”

Pikësëpari, lumturia në familje, është diçka që mund të realizohet në mënyrë dypalëshe. Dhe, themelin e kësaj, e përbëjnë:

1. Të kalohet mirë me njëri-tjetrin.
2. Të sillësh me mirëkuptim dhe pjekuri.
3. Të jesh sakrifikues.

Dhe këto, janë të mundura vetëm me moral, mençuri, zgjuarsi, sinqeritet dhe ndjenja reciproke. Gjithashtu, për të kaluar mirë, tek të dyja palët duhet të gjenden këto pesë cilësi:

1. Fetaria
2. Virtyti
3. Dashuria
4. Mëshira
5. Besnikëria

Është shumë e domosdoshme që këto cilësi, të gjenden edhe tek gruaja edhe tek burri. Kjo domosdoshmëri, bëhet më e qartë në sajë të fatkeqësive familjare që ndodhin përditë.

Ashtu si në shoqëri, edhe në familje, fetaria dhe virtyti janë the-meli i të gjitha cilësive të bukura. Çerdhet familjare ku feja jetohe në mënyrën më të bukur dhe ku shfaqen virtytet morale, i falin njerëzve lumturinë e të dyja botëve. Përndryshe, në rastet kur feja neglizhohet dhe si rezultat ndodh dobësi morale, siç dëmtohen individët në familje, ashtu dëmtohet rëndë edhe shoqëria.

Çështja e fetarisë të cilën po e theksojmë këtu, duhet kuptuar mirë. Njeriu nuk mund të jetë edhe fetar, edhe i ashpër, i pasjellshëm dhe i vështirë, sepse feja Islame, përbëhet e gjitha prej mirësjelljes, delikatesës dhe edukatës. Pra, feja është edukatë e bukur, edukatë e bukur, edukatë e bukur... Siç shprehet edhe poeti:

*Edukata, një kurorë ishte prej dritës hyjnore  
Vëre atë kurorë, të shpëtosh prej çdo belaje...*

Ndërsa i nderuari Mevlana, thotë:

*"Mendja iu afrua veshit të zemrës sime dhe e pyeti:  
«- Ç'është feja?»*

*Ndërsa zemra ime iu përgjigj:  
«- Feja është veç edukatë.»»*

Për sa i përket dashurisë; ajo është majaja dhe ushqimi i familjes. Kur dashuria pakësohet dhe konsumohet pa kujdes, edhe familja fillon të lëkundet. Edhe dashuria duhet të jetë reciproke, sepse ajo i përgatit zemrat të ndikohen nga njëra-tjetra. Njeriu, duhet fort aq sa dashuron. Me shtimin e dashurisë nga njëra palë, edhe sjelljet dhe fjalët e palës tjetër duhet të jenë të buta dhe të zbukurohen me mirësjellje, delikatesë dhe respekt.

Dashuria, në asnjë mënyrë nuk duhet kthehet në pakujdesi sjelljesh dhe, gjithmonë duhet ruajtur edukata brenda një kornize të caktuar. Dashuria, mëshira dhe të gjitha ndjenja e ngjashme me këto, duhet të jenë gjithmonë të ekuilibruara. Ashtu siç sjell dëme dashuria e tepruar, ashtu edhe privimi i plotë i të dashurve tanë prej dashurisë sonë, mund t'i çojë ata t'i kërkojnë këto ndjenja në ndonjë vend tjetër.

Nëse dashuria realizohet vetëm në planin epshor dhe i kalon kufijtë, ajo i hap rrugën një xhelozie dhe presioni të egër, ose mund edhe të pakësohet. Dhe këto dy gjendje, janë nga një fatkeqësi më vete për çerdhen familjare.

Në mënyrë të njëjtë, edhe mëshira duhet të jetë larg prej teprimit dhe moskujdesit. Mëshira e tepruar, e bën njeriun të dobët, duke e bërë atë tolerant edhe ndaj gabimeve të dëmshme dhe shkatërruese. Kjo, nuk është mëshirë, por vetëm një dobësi e zemrës. Nga ana tjetër, edhe mungesa e mëshirës, e ngurtëson zemrën, duke e çuar njeriun në padrejtësi dhe mizori. Ndërsa mëshira mesatare, e një niveli të ëmbël dhe të ashpër, është shumë frytdhënëse dhe sjell lumturi në çerdhen familjare.

Prindërit më të mëshirshëm, janë ata që ngrenë veten dhe fëmijët e tyre në namazin e sabahut, duke i përgatitur ata në çdo aspekt, për lumturinë e botës tjetër.

Ndërsa për sa i përket besnikërisë, edhe ajo është një çështje së cilës duhet t'i japin rëndësi të dyja palët. Siç tregon edhe vetë kuptimi i fjalës, besnikëri do të thotë të mbash premtimet, të jesh i drejtë në fjalë e në vepra dhe të mos flasësh gënjeshtër.

Padyshim se, për të siguruar shëndetin dhe vazhdimësinë e martesës, është shumë e rëndësishme që bashkëshortët të jenë të drejtë me njëri-tjetrin në çdo situatë dhe të qëndrojnë larg çdo sjelljeje që e cenon besimin ndërmjet tyre. Po ashtu, një nga kushtet e domosdoshme për shëndetin e martesës, është që burri dhe gruaja të jenë besnikë ndaj njëri-tjetrit, pra, që zemrat dhe sytë e tyre të mos rrëshqasin tek njerëzit e tjerë. Për të mos rënë në këto lloj rreziqesh, është e domosdoshme të tregohet kujdes ndaj rregullave dhe parimeve që Islami ka vendosur në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet burrave dhe grave të huaj ndaj njëri-tjetrit.

Të veprosh në një mënyrë që ngjallë dyshime, hamendje, thashe-theme dhe vesvese tek njerëzit, e cenon edhe nderin dhe respektin e personit, por vë në rrezik edhe çerdhen familjare.

Një manifestim tjetër i besnikërisë dhe përkushtimit, është edhe respekti dhe shërbimi që të dyja palët i bëjnë prindërve të njëri-tjetrit. Në këtë aspekt, nuset dhe dhëndurët tanë, duhet të tregojnë interes për vjehrrën dhe vjehrrin, ashtu siç tregojnë edhe për prindërit e tyre. Nesër, edhe ata do të jenë në të njëjtën pozitë. Nëse veprojnë keq, edhe ata do të përballen me të një ditë. Siç shprehen edhe të vjetërit: "Kush bën keq, gjen keq!", ose "Ç'të mbjellësh do të korrësh!"



## **32) Cilat janë vetitë më të rëndësishme që i japin kuptim dhe vlerë jetës?**

Vetitë më të rëndësishme që i japin kuptim dhe vlerë jetës së besimtarit janë sinqeriteti dhe devotshmëria. Sepse përmes devotshmërisë dhe sinqeritetit arrihet kulmi i adhurimit dhe robërimit ndaj Allahut, i cili është shkaku dhe qëllimi i ekzistencës së njeriut.

Devotshmëria është frenimi i epsheve dhe zhvillimi i aftësive shpirtërore. Pra, dëshira e vetme e besimtarit është fitimi i dashurisë dhe miqësisë me Allahun e Lartësuar.

Udhërrëfyesi më i rëndësishëm i besimtarit është devotshmëria. Në lidhje me këtë Allahu urdhëron në Kuran:

**“...Bëhuni të devotshëm me Allahun, në mënyrë që t’ju mësojë.”**

(Bekare, 282)

Devotshmëria është mësuesi më i mirë dhe udhërrëfyesi më i sigurt. Devotshmëria duket qartë në të drejtë dhe në të shtrembër, në të mirë dhe në të keqe. Me devotshmërinë merret rruga e miqësisë për tek Allahu. Si pasojë e kësaj devotshmërie dhe miqësie, Allahu bëhet syri i robit me të cilin shikon, veshi i tij me të cilin dëgjon dhe zemra e tij me të cilën kupton.

Ata që arrijnë këtë gjendje, gjatë gjithë jetës janë të vetëdijshëm për natyrën provokuese të jetës tokësore. Ata e konsiderojnë jetën e kësaj bote si shkollë sprovash. Zemrat e tyre janë të mbushura me dashurinë ndaj Allahut. Pasuria dhe jeta e tyre është thjesht një mjet për të arritur dashurinë e Allahut. Këta shijojnë kënaqësinë e vërtetë të besimit. Shërbimi ndaj Allahut dhe robërve të Tij shndërrohet në stil jetese dhe bëhet qëllimi dhe kënaqësia më e madhe e jetës së tyre.

Një nga personalitetet e historisë sonë, që e ka përjetuar këtë gjendje është edhe Javuz Sulltan Selimi. Sulltani i gjashtë i dinastisë osmane, Sulltan Selimi në një periudhë gjashtëvjeçare, në të cilën qëndroi në pushtet, la gjurmë të paharrueshme, jo vetëm në historinë 620 vjeçare të historisë osmane, por edhe në 1400 vjet të historisë islame në përgjithësi. Sulltan Selimi me zgjuarsinë dhe herë-herë me rreptësinë dhe ashpërsinë e tij, sikur na kujton Omer ibn Hatabin رضي الله عنه.

Ky muxhahid i madh, për të siguruar unitetin e botës islame organizoi disa ekspedita të suksesshme ushtarake, duke përfshirë brenda kufijve të perandorisë Sirinë, Jordaninë, Palestinën, Egjiptin dhe Arabinë Saudite. Në këtë mënyrë, ai fitoi titullin Kalifi i parë i historisë Osmane.

Kur imami në hutbe iu referua si sunduesi i dy vendeve të shenjta, e kundërshtoi menjëherë duke thënë:

“Jo, jo!.. Përkundrazi, unë jam shërbyesi i dy vendeve të shenjta.”  
Kështu e shprehu Sulltani nderimin e vet kundrejt vendeve të shenjta.

**“...Kush është i devotshëm ndaj Allahut, Allahu i jep rrugëzgjidhje për çdo gjë.”** (Talak, 2)

Siç kuptohet lehtësisht nga ajeti, në themel të fitoreve dhe sukseve të Sulltan Selimit qëndron devotshmëria. Si pasojë e begatisë së sinqeritetit dhe devotshmërisë ndaj Allahut, Sulltan Selimit në shumë

çështje të rëndësishme dhe jetike i është gjendur pranë ndihma dhe frymëzimi hyjnor. Ndodhia historike që do të tregojmë më poshtë është shembulli më i mirë i kësaj gjendjeje shpirtërore sublime të Sulltan Selimit.

Pas fitores që korri kundër memlukëve në betejën Merxhidabëk më 1516, Sulltan Selimi vendosi të hynte në Egjipt për të fshirë përfundimisht nga historia shtetin memluk, i cili ishte bërë qendra e intrigave në botën islame. Por, para se të nisej për në Egjipt, qëndroi 3 muaj në Zonën e Shamit. Gjatë kësaj periudhe u angazhua me riorganizimin e sistemit administrativ të zonës, me pritjen e delegacioneve nga vendet fqinje të Shamit dhe në vizitat e vendeve historike të Shamit.

Por shkaku kryesor i qëndrimit në Sham ishte krejt tjetër. Sipas një transmetimi, Ai e kishte vënë gjithë potencialin e tij në përmbushjen e një profecie të dëgjuar në Stamboll. Thelbi i kësaj profecie ishte zbulimi i varrit të Muhjiddin Arabiut, i cili rezultonte i zhdukur prej kohësh. Dijetarët në Stamboll, shprehjen në veprat e Ibn Arabiut: "Kur Sin-i të hyjë në Shin do të gjendet varri im", (kur shkronja "S" të hyjë në shkronjën "Sh" do të gjendjet varri im), shkronjën "S" e kishin interpretuar si simbol të emrit Selim, kurse shkronjën "Sh" si simbol të Shamit. Duke u bazuar te ky interpretim, e kishin informuar Sulltan Selimin se pikërisht ai do të ishte personi që do të gjente varrin e Ibn Arabiut.

Sulltan Selimi këtë e kishte mbajtur të fshehur edhe prej njerëzve më të afërt të tij. Gjatë kohës që ishte në Sham, herë pas here, duke u maskuar me rroba të vjetra hynte midis popullit për të mbledhur informacion mbi vendndodhjen e varrit. Por, megjithëse kaluan tre muaj Sulltani nuk arriti të siguronte një informacion të saktë për vendndodhjen e varrit. Kjo krijoi një gjendje të mërzitshme tek Sulltan Selimi, sepse ai dëshironte të nisej sa më parë për në Egjipt për t'i dhënë fund përfundimisht dinastisë memluke. Prandaj vendosi të dilte për herë të fundit në qytet me shpresën për të gjetur ndonjë informacion për vendndodhjen e varrit.

Ndërsa shëtiste midis njerëzve pa rënë në sy, dalloi një hamam dhe u nis drejt tij për t'u freskuar.

Kur hyri në hamam nuk gjeti askënd përveç një plaku që lahej në një qoshe të hamamit. Edhe Sulltan Selimi filloi të lahej në një cep tjetër të hamamit. Në ato momente plaku filloi të godiste tasin e hamamit në havuzin e mermerit. Ky veprim ishte një sinjal për të thirrur shërbyesit. Megjithëse plaku vazhdoi për një kohë të godiste tasin për të sinjalizuar shërbyesit, askush nuk po vinte. Sulltan Selimi mendoi t'i shkonte në ndihmë të moshuarit.

- Xhaxha! Me sa kuptoj po jep sinjal për të thirrur shërbyesit apo jo?

- Po, biri im, ata po thërras.

- Nëse më lejon, të shërbej unë.

- Shumë faleminderit.

Sulltan Selimi u ngrit dhe filloi t'i shërbente të moshuarit të panjohur.

- Xhaxha! Megjithëse për minuta të tërë u përpoqe të thërrasësh dikë për të të shërbyer, askush nuk t'u përgjigj, kjo tregon se në rini nuk ke ndihmuar dhe nuk i je gjendur askujt pranë

- Shiko! Në trupin tënd gjenden shtatë nishane. Dëshiron t'i tregoj?

Sulltan Selimi mbeti i shtangur dhe i mahnitur nga kjo. Por plaku vazhdoi më tej:

- Megjithë atë personel dhe me gjithë ato thirrje që bëra unë nuk u përgjigj askush, por vjen dhe përgjigjet gjithë ai Sulltan. A do të mund të ndodhte një gjë e tillë, po të mos i kisha shërbyer kujt në rini?

Sulltani i kërkoi ndjesë menjëherë, sepse e kuptoi gradën e lartë shpirtërore të njeriut në fjalë. Pastaj e pyeti:

- Mirë që e kuptove se unë jam Sulltan, por si e gjete që kam shtatë nishane në trup?

- Nëna juaj ishte një grua e bekuar, e cila tani po pushon përjetësisht pranë xhamisë së Trabzonit. Iu bëftë vendi xhenet. A nuk ke dëgjuar prej saj se ditën që ke lindur ka ardhur një njeri i urtë që i ka dhënë lajmin e mirë të lindjes së një djali, i cili do të ketë shtatë nishane, do të bëhet sulltan dhe do të fshijë shtatë shtete? Ndërsa njeriu i urtë jepte këtë sihariq, ti ishe duke lindur. A nuk e ke dëgjuar prej nënës këtë ngjarje?

-Po, kam dëgjuar për këtë në fëmijëri, por kisha harruar. Nëna më thoshte shpesh mëso, puno shumë, sepse ti do të marrësh përgjegjësitë e ymetit mbi vete.

Sulltan Selimi ishte i merakosur për sa i përket kalimit të shkretëtirës së Sinasë. Duke qenë se kishte pranë një njeri i cili ishte në gjendje të shikonte nga syri i zemrës, mendoi ta pyeste.

-Zotëri! Është e qartë që ju jeni njeri zemre apo ndoshta edhe vetë Hidri. Unë dëshiroj këshillën tënde në lidhje me iniciativën time për të kaluar ushtrinë mospërmas shkretëtirës së Sinasë, a do të ketë sukses?

- Do të jap dy lajme të mira në lidhje me këtë çështje. Dhe vazhdoi:

-Vazhdoni rrugën pa asnjë lloj ndrojtjeje, sepse pa hyrë në shkretëtirë do të bjerë një shi, i cili do t'ju lehtësojë udhëtimin. Ushtarët dhe topat do të kalojnë pa asnjë lloj vështirësie nëpër shkretëtirë. Sepse Pejgamberi ﷺ, së bashku me katër kalifët do të ecin para teje.

-A do të mund t'i shikoj unë Ata?

-Ti do t'i shikosh kështu siç më shikon mua tani, zbrit nga kali dhe në shenjë respekti ndiqi në këmbë. Ky ishte lajmi i parë. Ndërsa i dyti, kur të marrësh Kajron, do të të dorëzohen amanetet e shenjta të historisë islame. Dy nga këto amanete mbajnë sihariqe për ty. Njëra është një

stemë e vjetër egjiptiane, mbi të cilën shkruhet se ti do të marrësh përgjegjësinë e kalifatit. Prandaj, në Kajro do të hysh si fitimtar!.. Merre stemën dhe dërgoje në Stamboll së bashku me amanetet e tjera. Një amanet tjetër që do të të dorëzohet ty është edhe shpata e Davutit *السيف*. Kjo shpatë është një metër e gjatë dhe në njërën anë të dorezës është vizatuar një shpatë, kurse në anën tjetër një njeri që mban në dorë një kokë të prerë. Ajo figurë të simbolizon ty. Ngjitur me dorezën është një pllakëz mbi të cilën është shkruar një shprehje në gjuhën arabe, e cila profetizon qartë triumfin tënd mbi Egjiptin dhe marrjen e titullit shërbyesi i dy vendeve të shenjta, Mekës dhe Medinës.

Sulltan Selimi, i habitur nga fjalët e plakut harroi shkakun e vërtetë për të cilin doli. Por plakun nuk vonoi dhe e pyeti:

-Ti kërkon edhe diçka tjetër, por më duket se harrove. Sapo Sulltan Selimi po bëhej gati për ta pyetur për varrin, plakun i tha:

-Nuk është e nevojshme biri im, tani do të të jap përgjigje për atë që të mundon. Kthehu në rezidencë dhe jep urdhër që të priset ky hamam, sepse pikërisht këtu nën hamam gjendet varri i Ibn Arabiut.

Sulltan Selimi e kapi për dore plakun dhe filloi t'i puthte dorën, kur papritur vuri re se plakun ishte zhdukur. Sulltan Selimi nuk po e kuptonte, ishte në ëndërr apo zgjuar. Menjëherë u kthye në rezidencë dhe dha urdhër për prishjen e hamamit. Dhe pikërisht nën hamam u shfaq varri i Ibn Arabiut. Sulltan Selimi urdhëroi që në vend të hamamit të ndërtohej tyrbja e Ibn Arabiut. Pas kësaj, Sulltan Selimi dha urdhër për t'u nisur për në Egjipt. Shkuarja në Egjipt ishte një domosdoshmëri strategjike, por për të kaluar në Egjipt më parë duhej kaluar shkretëtira e egër dhe e rrezikshme e Sinasë. Por Sulltan Selimi arriti ta kalojë shkretëtirën për dhjetë ditë pa asnjë humbje jete, kurse Napoleon Bonaparti, i cili konsiderohet si një nga strategët më të mëdhenj të kohës, plot tre shekuj mbas Sulltan Selimit, nuk arriti ta kalonte këtë shkretëtirë.

Por vezirët dhe ushtarët kishin dyshime për kalimin me sukses të kësaj shkretëtire të rrezikshme. Ditën temperaturat arrinin plus 40 gradë, kurse natën midis minus 20 dhe 50 gradë.

Sulltan Selimi, i vendosur në vendimin e tij, hyri në shkretëtirë dhe pas një kohe zbriti nga kali dhe filloi të ecte në këmbë. Ushtarët u habitën dhe pyesnin njëri-tjetrin përse ecte në këmbë Sulltani.

Përbalë kësaj gjendjeje edhe ushtarët vendosën të ecnin në këmbë si komandanti i tyre. Vezirët i kërkuan Hasan Xhanit, shokut të ngushtë të Sulltanit, të pyeste Sulltan Selimin për shkakun e ecjes në këmbë në këto kushte. Kur Hasan Xhani e pyeti Sulltanin për shkakun, përgjigjja ishte:

"Hasan! A nuk e shikon se përpara nesh po ecën i Dërguari i Allahut? Ndërsa Ai ecën në këmbë, si mund të ecim ne hipur në kalë?.."

Shkretëtira u kalua me sukses dhe Egjipti u çlirua përfundimisht prej dinastisë memluke. Por Sulltan Selimin e lëndoi shumë rënia dëshmor e Sinan Pashës, i cili dha një kontribut të madh në çlirimin e Egjiptit. Humbja e Sinan Pashës e detyroi Sulltan Selimin të thoshte:

"Morëm Egjiptin, por humbëm Sinanin.."

Hyrlen e Sulltan Selimit në Egjipt historianët e përshkruajnë kështu:

"Populli kishte dalë në rrugë për të parë madhështinë e Sulltanit. Ata imagjinonin një sulltan krejt ndryshe. Mendonin se Sulltani do të hynte në qytet gjithë madhështi, por ai përkundrazi, qëndronte midis njerëzve duke ecur gjithë modesti."

Kjo është një nga tablotë e shumta të atyre që kanë arritur pjekurinë shpirtërore përmes devotshmërisë që kanë treguar ndaj Allahut. Sulltan Selimi mbërriti në lagjen periferike të Stambollit në mesditë, së

bashku me 80 mijë ushtarë. Kur i erdhi lajmi se populli ishte përgatitur për ta pritur në mënyrë madhështore urdhëroi ushtrinë të priste në hyrje të qytetit, deri sa të errësohej dhe njerëzit të shkonin nëpër shtëpi, sepse ai frikësohej se duartrokitjet e njerëzve mund t'i errësonin zemrën dhe ngjallnin egon. Një nga shembujt e fundit të gjendjes shpirtërore të këtij Sulltani është në shtratin e vdekjes, megjithëse dëshira e tij ishte të binte dëshmor në fushën e betejës. Allahu e kishte caktuar të ndahej nga kjo jetë në shtratin e vdekjes porsì Halid ibn Velidi رضي الله عنه. Kur shoku i ngushtë Hasan Xhani i tha se tani kishte ardhur koha për t'u takuar me Allahun, Sulltan Selimi iu përgjigj:

“Miku im i dashur! Me kë pandeh se isha deri tani?” Në këtë mënyrë shprehu besimin, sinqeritetin dhe devotshmërinë ndaj Allahut në çastet e fundit të jetës.

**O Zot! Na mundëso të jetojmë një jetë të sinqertë dhe të devotshme. Na bëj të mundur të adhurojmë deri në fund të jetës. Na bëj të mundur të dalim para Teje si myslimanë dhe na e lehtëso rrugën drejt Teje!**

**Amin...!**



### **33) Si duhet ta kuptojmë ekuilibrin midis frikës dhe shpresës?**

Një nga cilësitë dalluese të besimtarëve që kanë arritur përsosmërinë në besim, është frika ndaj Allahut, e cila krijohet nga madhërimi dhe dashuria që ata kanë. Në të vërtetë, frika ndaj Allahut është shqetësim dhe frikë për humbjen e kënaqësisë dhe të dashurisë së pafundme që Zoti ka për ne. Për këtë arsye, sa herë që përmendet Allahu, zemrat e besimtarëve që kanë arritur përsosmërinë në besim dridhen me një frikë të madhe, në një vigjilencë të madhështore. Kjo gjendje sjell me vete edhe gjendjet e larta si, edukata, sinqeriteti dhe devotshmëria që besimtarët duhet të kenë ndaj Allahut. Allahu thotë:

**“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata të cilëve, kur përmendet Allahu, u rrënoqethen zemrat, kur lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi dhe që janë të mbështetur vetëm te Zoti i tyre.”** (Enfal, 2)

**“...(O Pejgamber!) Përgëzoji të devotshmit dhe të sinqerit të cilëve, kur përmendet Allahu, u rrënoqethen zemrat...”** (Haxh, 34-35)

Kur dikujt i shtohet dija dhe dashuria për Allahun, i shtohet edhe frika ndaj Tij. Po ashtu, Krenaria e Gjithësisë ﷻ ka thënë:

*“Unë e besoj Allahun dhe e kam frikë Atë më shumë se ju.”* (Buhari, Edeb, 72; Muslim, Fedail, 127)

Një ditë, të Dërguarin e Allahut ﷺ e pyetën:

“Cili zë dhe cili kiraat (lexim) është më i bukur për Kur’anin?”. I Dërguari i Allahut u përgjigj:

*“Është zëri dhe kiraati i dikujt që kur e dëgjon duke lexuar, ndjen frikë nga Allahu.”* (Darimi, Fedailu’l-Kur’an, 34)

Ata që kanë frikë Allahun, nuk kanë frikë nga asnjë gjë tjetër. Frika ndaj Allahut është dritë lumturie për zemrat.

Besimtarët që kanë frikë nga Zoti, janë ata me të cilët Allahu është i kënaqur, e të cilët janë të kënaqur me Allahun. Allahu u premtun dy xhennete robërve të tillë të Tij.

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë:

*“Çdo besimtar i që nxjerr lot qoftë edhe sa koka e mizës prej frikës së Allahut, dhe ai lot i rrjedh nga faqet, Allahu ia bën haram zjarrin (e për-hershëm)!”* (Ibn Maxhe, Zuhd, 19)

*“Ai që qan për shkak të frikës që ka prej Allahut, nuk do të hyjë në xhehennem derisa të kthehet qumështi te gjiri. Pluhuri që ngrihet në rrugë të Allahut, kurrë nuk bashkohet me tymin e xhehennemit.”* (Tirmidhi, Zuhd, 8/2311)

*“Nuk ka asgjë më të dashur te Allahu, se sa dy pika dhe dy gjurmë. Këta dy pika janë lotët që rrjedhin për shkak të frikës ndaj Allahut dhe pikat e gjakut janë që derdhen në rrugë të Allahut. Ndërsa dy gjurmët janë gjurmët që lihen në rrugë të Allahut (në xhihad) dhe gjurmët që lihen kur kryhet ndonjë vepër të cilën Allahu e ka bërë farz.”* (Tirmidhi, Fedailu’l-Xhihad, 26/1669)

Lotët që derdhen besimtarët për shkak të frikës që kanë ndaj Allahut, janë zbukurimi i netëve të përkohshme, kandilat e errësirave të varrit dhe vesat e kopshteve të xhennetit. Allahu na ruajtë nga zemrat

që nuk janë të ndjeshme kundrejt urtësisë dhe fshehtësisë së Kur'anit Fisnik, dhe nga syri që nuk loton prej frikës ndaj Allahut.

Allahu Teala, duke i qortuar ata të cilët janë zemërgur dhe të privuar nga frika ndaj Tij, thotë:

**“...Pas (fakteve të qarta) zemrat tuaja u ngurtësuan, bile u bënë edhe më të forta, sepse ka nga gurët prej të cilëve gufojnë lumenj e ka disa prej tyre që çahen dhe prej tyre buron ujë, madje ka prej tyre që nga frika ndaj Zotit rrokullisen tatëpjetë (nga maja e malit). Allahu nuk është i pakujdesëm ndaj asaj që veproni ju.”** (Bekara, 74)

I Dashuri ynë ﷺ i është përgjyruar Allahut nga kjo gjendje, me këtë lutje:

*“O Allah! Kërkoj mbrojtje prej teje nga dija e padobishme, nga zemra që nuk ka frikë, nga vetja e pangopur dhe nga lutja që nuk pranohet.”* (Muslim, Dhikr, 73)

Ai që nuk ka frikë nga Allahu, është në një gradë më poshtë se sa kafshët dhe krijesat e pashpirta. Po ashtu gjyshërit tanë kanë thënë: “Ki frikë nga ai që nuk ka frika nga Allahu!” Me të vërtetë e ardhmja e tyre është një e ardhme e frikshme, sepse ngurtësia që kanë në zemra, errësira e përhumbjes dhe mosndjeshmëria e tyre nuk gjendet as te krijesat e pashpirta.

Po ashtu, sipas shumë deklarimeve hyjnore, edhe krijesat që pa-ndehen se janë të pashpirta ndryshojnë nga një gjendje në një gjendje tjetër, për shkak të frikës që kanë nga Allahu. Kjo e vërtetë shprehet kështu në ajetin fisnik:

**“Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur’an mbi ndonjë mal, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga Allahu. Këto janë shembuj që ua sjellim njerëzve që ata të mendojnë.”** (Hashr, 21)

Frika që besimtari ka në zemër se mos mbetet i privuar nga kënaqësia dhe dashuria e Allahut e frika se mos pëson zemërimin e Tij, duhet të gjendet gjithmonë bashkë me shpresën se mund të fitojë mëshirën e pafundme të Tij. Domethënë, zemra e besimtarit duhet të rrënqethet në emocionin e adhurimit ndërmjet dy poleve të frikës dhe shpresës. Ky ekuilibër që gjendet ndërmjet ndjenjave të frikës dhe shpresës, është bërë shprehje në këtë mënyrë: **“bejne’l-haafi ue’r-raxha”**. Besimtari gjithmonë duhet të jetë në gjendje lutjeje, mosqënieje dhe përgjërimi, dhe këtë harmoni shpirtërore duhet ta ruajë derisa te vdesë. Në ajetet fisnike thuhet:

**“...Luteni Allahun duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar (mëshirën). S’ka dyshim se mëshira e Allahut është pranë të mirëve.”** (A’raf, 56)

**“...Shpresojnë mëshirën e Tij dhe kanë frikë nga ndëshkimi i Tij, sepse ndëshkimi i Zotit është një ndëshkim prej të cilit duhet të kihet frikë.”** (Isra, 57)

Pejgamberi ynë i nderuar ﷺ ka thënë:

*“Sikur besimtari ta dijë ashpërsinë dhe mënyrën e ndëshkimit të Allahut, nuk do të shpresonte për xhennet. Edhe mosbesimtari, sikur ta konceptonte plotësisht mëshirën e Allahut, nuk do ta priste kurrë shpresën nga xhenneti i Tij.”* (Muslim, Teube, 23)

*“Xhenneti është më afër jush se sa lidhësa e këpucës suaj. Edhe xhennemi po ashtu.”* (Buhari, Rikak, 29)

Nga ky aspekt, rruga e lumturisë dhe e paqes së përhershme është në mbrojtjen e barabartë të frikës dhe shpresës që ndjehen në zemër ndaj Allahut, sepse ai që dashuron jeton gjithmonë me frikën se mos e lëndon atë që dashuron dhe me shqetësimin se mund ta humbasë dashurinë e tij. Edhe besimtari duhet të ketë frikë nga humbja e dashurisë së Allahut, por duhet të shpresojë edhe në mëshirën e Tij.

### **34) Në çfarë prespektive duhet t'i qaset besimtari situatave dhe ngjarjeve me të cilat përballet gjatë jetës?**

Një ditë Symbly Efendiu, i cili ishte një nga evlijatë e njohur të Stambollit, u bën këtë pyetje nxënësve të tij:

- Nëse të jepet mundësia për të ndryshuar botën çfarë do të kishe bërë?

Çdo nxënës kishte dhënë nga një përgjigje sipas horizontit dhe diapazonit të tij shpirtëror. Dikush kishte thënë:

-Do të zhdukja të gjitha të këqijat e kësaj bote.

Dikush tjetër:

- Do ta shndërroja botën në parajsë.

Dikush tjetër:

- Do të doja një botë, ku çdo problem të gjente zgjidhje dhe ku çdo sëmundje të gjente shërim, pra një botë pa probleme dhe sëmundje.

Pasi i dëgjoji të gjithë, Symbly Efendiu vuri re se njëri nga nxënësit nuk dha asnjë përgjigje dhe e pyeti për shkakun:

- Biri im, po ti si mendon? Si do kishe dëshirë ta ndryshoje botën?

Nxënësi me emër Muslihiddin u përgjigj:

- Zotëri, unë nuk jam më i ditur dhe i urtë se Krijuesi i botës, unë thjesht jam një krijesë e dobët e Tij. Njeriu, nëse njeh vetveten, njeh më mirë Krijuesin. Nuk ka dyshim se në çdo gjë që Ai ka krijuar ka një urtësi. Unë për vete e kisha lënë çdo gjë ashtu siç është, duke u kënaqur me caktimin e Allahut.

Në një skenë teatri ku luhet vetëm një skenar, është më se normale, por nëse në një skenë teatri luhen tre skenarë, atëherë rolet ngatërrohen me njëri-tjetrin. Kurse në botën përreth, ku ekziston një numër i pafund krijesash, të cilat të gjithë luajnë rolin e vet duke i përngjasuar një teatri, nuk ndodh asnjë lloj kaosi, përkundrazi, çdo gjë luan rolin e vet në një harmoni të plotë. Çdo gjë në këtë botë është rregulluar në atë mënyrë nga Allahu i gjithëdijshëm, që të jetë shkak dhe mjet për falënderim, lëvdim, dhikër dhe bindje. Në krijimin e Tij nuk ekziston asgjë që të jetë krijuar pa qëllim dhe pa urtësi. Prandaj, ngjarjet të cilave nuk u jep dot një shpjegim racional, njeriu duhet t'i pranojë me bindje.

Njeriu është krijuar në atë mënyrë që çdo gjë e kupton përmes të kundërtave. Ngjyrat dallohen më lehtë nga njëra-tjetra, kur kontrasti midis tyre rritet. Ky realitet është i vlefshëm edhe për çështje materialo-shpirtërore.

Njeriu nuk mund të perceptojë të ftohtin pa ekzistuar i nxehti apo pa ushqimet e kripura nuk mund të kuptohen ushqimet e ëmbla. Mosvlerësimi siç duhet i shëndetit para sëmundjes, i rinisë para pleqërisë, kohës së lirë para kohës së zënë me punë vjen pikërisht nga ky fakt.

Si të gjitha këto edhe vlera e së mirës dhe së drejtës dallohet më lehtë përballë së keqes dhe padrejtësisë.

Prandaj Kurani jep shembuj të këqinj, si Faraoni dhe Nemruti, për të kuptuar më mirë dhe lehtë shembujt e mirë, siç janë profetët dhe veçanërisht Pejgamberi ﷺ.

Pra, çdo gjë në këtë botë fiton kuptim përmes të kundërtave. Është e pamundur të perceptohet diçka që nuk ka të kundërtën. Dhe një nga shkaqet e mos perceptimit të qenies së Allahut është mos ekzistenca e të ngjashmit dhe të kundërtës së Tij.

Kur njeriu i qaset gjithësisë përmes urtësisë së besimit, çdo gjë në gjithësi fiton kuptim dhe vlerë, madje kupton që edhe e keqja nuk është pa vend dhe urtësi. Kur njeriu u qaset gjërave vetëm nga një këndvështrim, shumë gjëra duken të pakuptimta, por realiteti është krejt ndryshe, siç e tregon edhe Kurani në ajetin e mëposhtëm: **“Mund të urreni diçka, ndërkohë që ajo është e mirë për ju dhe mund të doni diçka, ndërkohë që ajo është e dëmshme për ju. Allahu di, kurse ju nuk dini.”** (Bekare, 216)

Prandaj, njeriu që kërkon të njohë të vërtetën nuk duhet t'u qaset gjërave vetëm sipas kritereve të veta, por edhe sipas kritereve hyjnore, sepse ka shumë gjëra të cilat kur maten me kriteret e kësaj bote duken si të pavlefshme, por në realitet janë shumë të çmuara.

Vejsel Karani e shpreh kështu ndërlidhjen dhe gërshetimin e të kundërtave në fitimin e dashurisë së Allahut:

### **Kërkova respekt, e gjeta në modesti**

Ajeti kuranor shprehet kështu: **“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë...”** (Furkan, 63)

Kurse një këshillë e vendosur në gojën e Idrizit عليه السلام, thotë: *“Kur njeriut të mençur i rritet prestigji, i rritet edhe modestia.”*

Kurse poeti i famshëm Mehmet Akif Ersoj, e shpreh kështu këtë të vërtetë:

*“Fara që nuk bie në tokë, nuk nxjerr filiz për t’u rritur, edhe mëshira e Allahut lartëson modestët, jo mendjemëdhenjtë.”*

Mendjemadhësia, mburrja, vetëpëlqimi dhe kryelartësia shfaqen më shumë tek personat e pasur dhe me pozitë. Në fakt, të gjitha të mirat që i janë dhuruar njeriut janë si një thikë me dy presa, të cilat mund të përdoren si për mirë, ashtu edhe për keq. Në të vërtetë, madhështia e pasurisë dhe pozitës qëndron në kalimin e jetës larg koprracisë, shpenzimeve të kota dhe mendjemadhësisë, duke u mbështetur tek modestia dhe bujaria.

### **Kërkova pozitë, e gjeta në bamirësi**

*“Zotëria i popullit është ai që i shërben atij.”*

Rruga për t’u bërë i pari i një populli është shërbimi dhe bamirësia ndaj tij. Bamirësia zbut zemrat e vrazhda. Njeriu është i prirur t’i bindet plotësisht mirëbërësit. Sa e bukur është kjo shprehje e Osmanit rahimullahi: *“Madhështia e pasurisë është falënderimi, kurse falënderimi është të bësh sa më shumë bamirësi.”*

Kurse ajeti kuranor, masën e shpenzimit për bamirësi e shpreh kështu: **“Të pyesin ty çfarë duhet të të japin për bamirësi. Thuaju: ‘Tepricën!..’** (Bekare, 219)

### **Kërkova fisnikërie gjeta në drejtësi**

**“Qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je urdhëruar.”**  
(Hud, 112)

**“Kjo është dita në të cilën të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre.”** (Maide, 119)

Fisnikëria dhe trimëria e vërtetë qëndron në të qenët i drejtë. E drejta dhe e vërteta në disa raste kanë çmim shumë të shtrenjtë, por ata që besojnë në botën tjetër janë të gatshëm të paguajnë çfarëdo lloj



çmimi për të mos devijuar nga e drejta dhe e vërteta. Njeriu mendon se mund të përfitojë shumë gjëra përmes gënjeshtërisë në këtë botë të përkohshme. Por nuk duhet harruar se këto në botën tjetër janë si fushë e minuar për personin.

Jeta e ndershme arrihet duke qëndruar afër të vërtetës dhe të drejtës.

### **Kërkova lavdie gjeta në mosqenie**

Pejgamberi ﷺ, e shprehte dobësinë dhe pafuqinë e vet duke u strehuar dhe kërkuar falje nga Allahu. *“O Zot! Nuk të njoha Ty siç duhet, nuk munda të të adhuroj siç duhet.”*

Edhe ne si pasues të Muhamedit ﷺ, nuk duhet ta shikojmë mjaftueshëm adhurimin dhe falënderimin tonë ndaj Allahut për mirësitë dhe begatitë e dhuruara.

Prandaj duhet të kalojmë një jetë në lutje të vazhdueshme ndaj Allahut.

### **Kërkova famë gjeta në devotshmëri**

**“...bëhuni të devotshëm, Allahu ju mëson ju...”** (Bekare, 282)

**“...Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij...”** (Huxhurat, 13)

Nuk ka asnjë dyshim se fisi më i nderuar në botë është fisi që rrjedh nga familja e Pejgamberit ﷺ, por devotshmëria është një veti që e bën njeriun pjesëtar të familjes më të fisme në botë, e bën atë pjesë të Ehli Bejtit.

Selman Farisiu ekspozoi një gjendje morali aq të vyer, sa që en-sarët dhe muhaxhirët nuk dëshironin ta ndanin midis tyre. Secili grup e pretendonte si të vetin Selman Farisiun. Përballë kësaj situatë, Pej-

gamberi ﷺ, në shenjë vlerësimi dhe komplimenti tha: *"Selmani është prej nesh, prej Ehli Bejtit."*

Përveç atyre që janë trashëgimtarë biologjikë të drejtpërdrejtë të Pejgamberit ﷺ, nderin për të qenë pjesëtarë të Ehli Bejtit e kanë edhe ata që ndjekin rrugën e të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe kapen fort pas devotshmërisë. Kushti i vetëm për të fituar këtë privilegj është "devocioni". Vlera e vërtetë e njeriut matet nga devotshmëria që ekspozon para Allahut, jo nga pasuria, pozita dhe fama në këtë botë.

Devotshmëria është arti i adhurimit ndaj Allahut dhe zbukurimit me moralin e Pejgamberit ﷺ.

### **Kërkova respekt, nderim, krenari dhe e gjeta në mjaftueshmëri**

Në hadithe thuhet:

*"Të qenët i kënaqur me atë që ke, është thesar i pashtershëm."* (Dejlemi, III, 236/4699)

*"Nëse dëshiron dashurinë e Allahut, mos e lidh zemrën me këtë botë dhe, nëse dëshiron të jesh i dashur midis njerëze, mos kërkoi gjë prej tyre."* (Ibn Maxhe, Zuhd, 1)

*"...Nderi i besimtarit është në qëndrimin natën në namaz, kurse krenaria në të mospasurit nevojë për njerëzit."* (Hakim, IV, 360-361/7921)

Shumë njerëz, megjithë pasurinë e madhe që kanë, përsëri janë të babëzitur. Sikur t'u jepet e gjithë bota, do t'i hedhin sytë nga hëna, duke thënë: "Sikur të kisha edhe një pjesë nga hëna." Pejgamberi r, njerëzit e pangopur i përshkruan kështu: *"Në qoftë se i biri i Ademit do të kishte një luginë me flori, do të dëshironte të kishte dy lugina. Mirëpo, gojën e tij nuk e mbush asgjë tjetër përveç dheut. Allahu ia pranon pendesën atij njeriu që pendohet"* (Buhari, Rikak, 10)

Pra njeriun e lartëson ndjenja e mjaftueshmërisë me atë që ka, sepse, edhe sikur t'i jepet e gjithë pasuria e kësaj bote, në Ditën e Gjykimit ajo nuk mund t'i bëjë asnjë lloj dobie atij.

### **Kërkova qetësidhe e gjeta në thjeshtësi**

Ajeti kuranor e formulon kështu sekretin e qetësisë së njeriut: **“Vërtet zemrat gjejnë qetësi vetëm përmes përmendjes së Allahut.”**

(Rad, 28)

Jeta askete konsiston në shfrytëzimin e mirësive të kësaj bote pa e lidhur zemrën me to. Nëse do shpreheshim ndryshe, asketizmi shpreh lirinë duke mos u bërë rob i pasurisë së kësaj bote. Rumi, i cili e ka krahasuar njeriun me një anije që lundron në detin e pasurisë, shprehet kështu:

*“Nëse deti është nën anije, bëhet mbështetës dhe bën të mundur lundrimin e anijes pa u mbytur, por nëse dallgët hyjnë në anije, atëherë e fundosin atë.”*

*“Lakmia pas kësaj bote është të jesh i shkujdesur ndaj Krijuesit dhe jo të heqësh dorë nga pasuria, nga familja dhe begatitë e tjera të kësaj bote.”*

Zemrat e besimtarëve nuk gjejnë kënaqësi më të madhe sesa ndjenja e pranisë së Allahut në zemrat e tyre. Zemrat e atyre që jetojnë të shkujdesur ndaj Allahut janë gjithmonë të trishtuara dhe të brengosura. Pasuria dhe kënaqësitë e kësaj bote, me të cilat përpiqen të ngushëllojnë veten, nuk u siguron atyre asnjë lloj qetësie shpirtërore dhe psikologjike. Terapia e zemrës së vrazhdë është konsiderimi i pasurive dhe begatitë të kësaj bote si mjet për të fituar dashurinë e Allahut dhe jo si qëllim në vetvete. Kjo bën të mundur pastrimin e zemrës nga dashuria për këtë botë duke e përgatitur vetëm për dashurinë e Allahut.

Lumturia është e fshehur në refuzimin e kënaqësive epshore. Abdurrahman ibn Auf e shpreh kështu këtë realitet: *“Islami ka obliguar*

*disa urdhëresa të vështira, që nuk i pëlqejnë njeriut. Ne, më të mirën e të mirave e gjetëm pikërisht në këto urdhëresa të vështira. Ne emigruam me Pejgamberin ﷺ. Largimi nga vendlindja ishte shumë i vështirë për ne, por Allahu na dhuroi fitore dhe privilegje me këtë veprim. Kurani tregon:*

**“Zoti yt të nxori nga shtëpia për të vërtetën, edhe pse kjo nuk i pëlqeu një grupi prej besimtarëve. Ata polemizojnë me ty për të vërtetën, e cila u ishte bërë e qartë, sikur të ishin duke u çuar drejt vdekjes së sigurt.”** (Enfal, 5-6) *Siç e tregoi edhe Kurani, kishim dalë me të Dërguarin e Allahut në luftën e Bedrit. Kjo ishte e vështirë për ne, por Allahu na dhuroi fitore. Mirësitë më të mëdha i kemi arritur përmes urdhëresave që njeriut i vijnë të vështira.”* (Hejthemi, VII, 26-27)

**Allahu na bëftë prej njerëzve që kërkojnë vetëm dashurinë e Allahut në këtë botë. I lutemi Allahut të na ruajë nga zhytja në plotësimin e dëshirave të nefsit, duke injoruar botën e amëshuar. O Zot, na i mbush zemrat me iman dhe dhikrullah!**

**Amin!..**

**35) Mënyra për të ndërtuar një individ dhe shoqëri të mirëfilltë është një edukim i mirëfilltë brenda ekuilibrit materialo-shpirtëror. Mirë, por si mund të edukohet një edukues i mirëfilltë që ta japë këtë edukim? Cilat attribute duhet të gjenden te një edukues ideal?**

Allahu i Lartësuar i ka dërguar peygamberët si edukuesit më të mëdhenj njerëzor. Për këtë arsye, edukimi, pra të shërbyerit si një edukues është profesion profetik.

Mësuesi i vetëm i të Dërguarit të Allahut ﷺ, është Allahu (xh.xh.). Ai nuk ka marrë mësim nga asnjë njeri. Megjithëkëtë qëndronte në pikën kulmore të çdo lloj dijeje që sot i flasin njeriut dhe që analizojnë shpirtin e tij si psikologjia, pedagogjia dhe socio-antropologjia.

Një mendimtar thotë: *"Nëse dëshiron të bëhesh mësues në tokë, atëherë behu nxënës i qiellit!.."*

Domethënë, edhe vetë duhet të jetosh përgjatë gjithë jetës si një nxënës i Kuranit dhe Sunetit, edhe për të tjerët duhet të përpiqesh që

të jetojnë në këtë mënyrë. Vetëm atë kohë do të mbledhësh shumë fryte të marrjes së dijes dhe do të bëhesh mësues i vërtetë. Objekti që e rregullon, është kartëvizita e një tekniku. Edhe cilësia e edukuesit matet me nxënësit që edukon.

Mjeshtëria e çdo artisti kuptohet nga veprat që ai nxjerr në pah. Për këtë arsye, edhe Pejgamberi ynë i Nderuar i cili edukoi brezin e sahabëve që ishin prej shoqërisë së injorancës, është edukuesi më i përsosur që ka parë njerëzimi. Siç merr njeriu nga gjendja e atij ndaj të cilit ndjen dashuri, edhe njeriu që fiton grada në dashurinë ndaj Resulullahut ﷺ, merr pjesë nga atmosfera shpirtërore e tij. Për shkak të kësaj gjendjeje bëhet më i suksesshëm në ushtrimin e detyrës prej edukuesi. Një edukues së pari duhet të ndërtojë veten, pastaj duhet të përpiqet të edukojë të tjerët, sepse një njeri që nuk mund të ndërtojë veten, nuk mund t'i ndërtojë të tjerët. Nuk mund të ketë qerasje me gotë të zbrazët. Një edukues duhet ta zhvillojë vazhdimisht veten. Në të kundërt, mund të shuhen shumë aftësi për shkak të nënvlerësimit të tij. Një edukues që e shndërron në një fidan një metër nxënësin e tij, i cili në aspektin e aftësisë është si një rrap madhështor, është përgjegjës tek Allahu (xh.xh.).

Nuk duhet të harrohet se: **“Shpërdorimi më i keq është shpërdorimi i njeriut.”**

**“Për çdo njeri që fitojmë, kemi shpërblim të madh. Për çdo njeri që humbim, kemi mëkat të madh.”** Për të qenë një edukues i mirëfilltë, duhet që ndjenjat t'i kemi të forta, sepse kur të formojmë lidhje me nxënësit, duhet t'i kuptojmë ndjenjat e tyre, t'i vlerësojmë ato dhe të veprojmë me ta sipas këtyre. Andaj edhe një mjek, para se të japë mjekimin, përpiqet të gjejë diagnozën, domethënë përpiqet të kuptojë shkakun e dhimbjes dhe shqetësimit. Të mos harrojmë se vetëm njeriu të cilit i zgjidhet problemi, mund të fitohet. Allahu i Lartësuar thotë në ajetin fisnik:

## تَعْرِفُهُمْ بِسَيِّمَاتِهِمْ

**“...Ti i njeh ata nga pamja e tyre...”** (Bekare, 273) Andaj duhet t’i kuptojmë hallet e bashkëbiseduesit dhe të gjejmë një damar që arrin deri në zemrën e tij. Përpjekja e vazhdueshme për t’i mësuar njeriut disa gjëra pa i kuptuar hallet dhe vështirësitë e tij, nuk mund të japë një rezultat pozitiv. Njerëzit, siç kanë të ndryshme aftësitë, kanë të ndryshme edhe dobësitë. Andaj edhe edukuesi duhet t’u afrohet njerëzve me përkushtimin e pothuajse një mjeku shpirtëror. Një metodë apo këshillë që është e dobishme për dikë, mund të jetë e dëmshme për dikë tjetër. Për këtë arsye, duhet t’i njohim shumë mirë karakteret e njerëzve për edukimin e të cilëve jemi përgjegjës. Duhet të marrim shembull nga **Daru’l-Erkami** dhe nga **Suffa**. Për shembull, i **Dërguari i Allahut** ﷺ, e edukoi me një mënyrë të veçantë **Ebu Bekrin** i cili e kishte zemrën të mbushur me mëshirë. Nga ana tjetër, e edukoi në një formë ndryshe **Omerin**, i cili kishte një natyrë të ashpër dhe me një edukim krejt tjetër **Muadh ibn Xhebelin**, **Enes ibn Malikun** dhe **Vahshiun** nga Abisinia. Në fund të këtyre edukimeve të ndryshme të gjithë u bënë personalitete vje. Një shoqëri ka nevojë për çdo profesion. Ai që ka prirje për matematikë, duhet të orientohet drejt matematikës. Ndërsa ai që ka prirje për poezi, duhet të orientohet drejt poezisë. E rëndësishme është që aftësive t’u jepet orientimi i duhur. T Edukuesit (mësuesit) ndërtojnë një botëkuptim duke ndikuar në organet më të rëndësishme të nxënësve, domethënë në zemrat dhe trurin e tyre. Nisur nga ky këndvështrim edukuesit mund t’i quajmë **“arkitektët e së ardhmes”**.

Bazuar në këto që thamë, edukuesi në çdo fazë të jetës së tij dhe veçanërisht në klasë duhet të veprojë në një formë që i ka hije personalitetit të tij Islam. Ai nuk duhet të harrojë se çdo vepër që bën dhe çdo fjalë që thotë është në pozicionin e një tulle që vendoset në personalitetin e nxënësit. Edukuesi duhet të mendojë edhe për faktin

se gabimet e tij mund të kopjohen nga ata që edukon. Ai duhet ta ndjejë thellë në zemër përgjegjësinë e kësaj.

Edukuesi duhet ta shohë çdo njeri që i dorëzohet atij, me vetëdijen e amanetit të Allahut Teala.

Bariu është përgjegjës për kopenë e tij. Ai është i detyruar ta mbar-të në krahë një qengj që i thyhet këmba. Pikërisht kështu edhe nxënësit janë nën përgjegjësinë e edukuesit.

Pejgamberi ynë i Nderuar ﷺ, thotë: *"Të gjithë jeni barinj. Bariu është përgjegjës për kopenë e tij..."* (Buhari, Vesaja, 9.) Të jesh përgjegjës (edukues) në kohët e sotme, do të thotë të jesh përgjegjës, jo për karakteret e buta si delet, por për karakteret e vështira dhe inatçie si dhia.

Edhe pejgamberët kanë qenë barinj, në mënyrë që të përgatiteshin për të ardhmen, sepse:

-Bariu e kupton gjendjen shpirtërore të kopesë të cilën ruan. -Bariu e kullot, e le të pushojë dhe e ushqen kopenë e tij në vende me bar. Ai nuk e çon atë në vende të thata.

-Bariu e mbron kopenë nga ujqërit.

-Bariu nuk u lë ujqërve as edhe një qengj që është i sëmurë, por e merr atë në krahë dhe e bashkon me kopenë.

-Bariu e kontrollon gjithmonë kopenë për të cilën është përgjegjës, duke ecur nganjëherë para dhe nganjëherë pas saj. Edukimi nuk është një punë që kryhet duke qëndruar ulur. Pejgamberi ﷺ, përpëlitej për t'ua predikuar Islamit njerëzve. Ai asnjëherë nuk tha:

"Le të vijnë që t'ua shpjegoj." Por mori parasysht qoftë edhe gjuajtjen me gurë dhe shkoi në Taif.

Përgjatë kthimit gjeti një skllav. Edhe atij ia predikoi menjëherë Islamit. Nuk i kaloi asnjë mundësi pa vlerësuar. Edhe besimtari duhet të kërkojë në çdo moment një mundësi për të dhënë shërbim fetar.



Nëse e kërkon, Allahu do t'ia nxjerrë përpara. Por ai që nuk e shndërron në vetëdije kërkimin e shërbimit fetar, është i shkujdesur edhe nëse përpara i dalin mundësi të pafundme shërbimi.

Çelësi i vërtetë i suksesit në edukim është durimi, qëndrueshmëria dhe sakrifica.

Asnjë përdua apo asnjë lum nuk mund të ngjitet në mal. Për ta kaluar malin duhet të ecin patjetër përreth tij. Nëse veprohet kështu, rruga që përshkohet është e gjatë, por arrihet qëllimi dhe synimi i kërkuar. Edhe edukimi i njeriut kërkon një durim, qëndrueshmëri dhe përpjekje të tillë.

Durimi i periudhës së Mekës rezultoi me zhvillimin e periudhës së Medines. Për gjashtë vjet u bënë 40 myslimanë. Për njëzet e tre vjet u bënë 150 mijë myslimanë.

Edukimi merr fund aty ku gjendet dobësia, dembelizmi, lodhja, ankesa dhe mungesa e durimit.

Kapitali i edukimit është dashuria dhe përpjekja. Edukimi është arti për të harruar ankesën kundrejt vështirësisë. Sahabët nuk u lodhën, nuk u dorëzuan dhe nuk hoqën dorë asnjëherë kur shkuan në Kinë dhe Semerkand. Të qenët një edukues i dashur është një art i madh.

Të mos harrojmë se në edukim;

1. Ndikojmë aq sa i duam nxënësit.
2. Duhemi aq sa i duam nxënësit.

Kapitali i edukimit është dashuria. Dashuria zgjidh çdo problem. Njeriu, të cilit ia zgjidhim problemin, është njeriu ynë.

Dashuria që ndjehet ndaj një edukuesi e shton edhe interesimin ndaj atyre që jep ai. Nëse edukuesi (mësuesi) i trajton nxënësit me dashuri dhe mëshirë, bën të mundur që mesazhet e tij të transmeto-

hen nëpërmjet një rruge shpirtërore më shumë se asaj racionale. Kjo është një metodë më influencuese edukimi. Edukuesi duhet të ndajë kohë për nxënësit e tij edhe jashtë orarit të punës. Ai nuk duhet të jetë si një nëpunës që shtyp kartën sa herë që hyn e del nga vendi i punës apo si një nëpunës që hedh firmën në fletoren e mungesave. Mësuesi (edukuesi) duhet të përhapë energji pozitive me fytyrën e qeshur dhe gjuhën e ëmbël. Mësimin dhe edukimin duhet ta fillojë së pari duke ua bërë të dashur nxënësve. Të mos harrojmë se çdo njeri zbutet kundrejt bukurisë së mirësisë dhe magjepset ndaj gjuhës së ëmbël dhe fytyrës së qeshur. Ekstremizmi në ashpërsi lindi urrejtje. Edhe teprimi në tolerancë e dobëson autoritetin. Suksesi arrihet duke mbajtur ekuilibrin ndërmjet këtyre të dyjave.

**Mehmet Akif Ersoji** shprehet:

*Për të thënë "jam mësues", së pari duhet të jesh besimtar; Pastaj i kulturuar, i kualifikuar dhe i ndërgjegjshëm. Pa i pasur këto katër cilësi, kjo punë nuk mund të kryhet, sepse detyra është madhore...*

Kushti i 1-rë: **Të qenët besimtar.** Domethënë, edukuesi duhet të jetë një besimtar që përhap mëshirë nga shpirti si shembull me jetën e tij në besim dhe adhurim.

Kushti i 2-të: **Të qenët i kulturuar.** Domethënë, edukuesi duhet të jetë shembull në veprat dhe sjelljet e tij.

Kushti i 3-të: **Të qenët i kualifikuar.** Ai duhet ta edukojë veten në mënyrë të mirëfilltë.

Kushti i 4-t: **Të qenët i ndërgjegjshëm.** Ai duhet të posedojë vetëdijen e përgjegjësisë. Pra, duhet ta konsiderojë veten përgjegjës për nxënësit e tij. Këto tri pika janë shumë të rëndësishme në edukim:



1. Vlerësimi që ne i bëjmë nxënësit.
2. Vlerësimi që nxënësi na bën neve. (Dashuria)
3. Vlerësimi që do të na bëjë Allahu i Lartësuar në Ditën e Kiametit.

Nuk duhet të harrojmë që ne jemi gjithmonë mësuesi dhe nxënësi i dikujt në jetë. Të gjithë jemi nxënës të jetës deri në frymën e fundit. Ashtu si studentët shpresojnë që në fund të studimit të marrin një diplomë me nota të mira edhe ne shpresojmë që me vepra të mira të marrim një diplomë të mirë nga shkolla e jetës. E lusim Allahun të na bëjë të mundur daljen në ditën e gjykimit me vepra të mira!









